

ERMIRA JORGO

8SH-32
G76

Novela



8 SH-32
G 76

ERMIRA JORGO

Hedjekovë
MARTINA KODRA

NATA E DYTË E NUKTENIT

Nata e dytë

novela



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

NATA E DYTË E NURTENIT

Gani Dana vdiq muajin e dytël të dhëndërisë. Shkonte në qytet, te xhaxhai i tij, Kasemi, hipur mbi kalin e bardhë e i veshur me rroba të reja. Të dielën do të venin bashkë në panairin e bagëtisë që bëhej në sheshin e pazari.

Gratë në kësoll thanë se djalin e kishim marrë më sysh aq i bukur dukej majë kalit, si një trim përrallash. Shkonte rrugës së fshatit ngadalë, duke vështruar rrotull e duke u folur njerëzve. Xhexheja, që e kishte shtëpinë rrëzë kodrës, tha se vështronte me mall edhe gurët e xhadesë, sikur e dinte që e kishte për të fundit herë. Kali trokiste potkonjtë në kalldrëm, ecte rëndë që të shëtiste të zotin. Kur arriten në urë, kali qëndroi, nguli këmbët dhe zuri të rrotullohej duke zgjatur qafën pas sikur kërkonte të hante bishtin e vet. Ganiu e kroi në zverk dhe i foli me të butë. Kali u bind dhe eci ngadalë mbi urë duke i hedhur këmbët me frikë. Pastaj papritur qëndroi sisi goditur nga rrufeja, u ngrit arithi dhe lëshoi një hingëllimë si vajtim. Ganiu u plas në shesh pa frymë, me kurrizin të thyer.

Në fshat zia u bë e rëndë. Plakat e qanë djalin me ligje, burrat folën për Bariun, babanë e djalit, njeri trim e esnaf, që qe vrarë në Luftën e Vlorës dhe kishte lënë të birin jetim pesë vjeç dhe nusen të ve njëzet e dy vjeçë. Nëna e Ganiut, Refoja, që e kishte rritur djalin me thonjtë e saj, ulëriu tri ditë rresht, duke ulur shallim e zi në fund, të këmbëye e duke zgjatur qafën sikur kérkonte ta këpuste. Thoshte se bota u err e dielli u shua. Qante edhe për nusen e re, që u nxi e u bë korb. Gratë e mbanin nga krahët e i férkonin duart. Nëna u fishk e u tha, s'il t'ia kishte shkulur njeri jetën nga trupi me dorë.

Ditën e tretë shkoi në varreza me nusen, rregulloi varrin e djalit dhe mbolli trëndafila, duke ia shkërmioqur dheun me gishterinj. Pastaj u shklye në shtëpi me shallin e zi të ulur mbi sy. Ditët e tjera qau çdo pasdreke, në të perënduar, që të shkarkonte shpirtin, duke folur me zë të ulët.

Kur qante plaka, nusja i rrinte karshi, e ulur në gjunjë, dhe derdhte lotët ujë, me grushtet mbledhur në prehër dhe supet të rënduara përpara, pa zë. Mbës qanë ashtu me javë, pranë njëra-tjetrës, derisa plaka më në fund qëndroi të merrte frymë dhe ngriti sytë të shikonte nusen. I theri derisa në kockë. Nusja po tretej, me lotët e mbledhur në mjekër, që i pikoni në prehër. S'ia kishte dëgjuar zërin që kur kishte vdekur Ganiu.

Nëna fshiu sytë me grusht dhe lëvizi nga vendi.

— Nuitén!... — foli me zërin e shuar.

Nusja nuk lëvizi dhe vazhdoi të qante heshtur. Dukej e bardhë, e ngrirë dhe vetëm lotët, që i rrrokulliseshin pa pushim nga sytë e hapur, tregonin që ishte në jetë. Si një nuse guri.

Plaka ë tremb.

— Nurten.... — ia mori dorën dhe ia ferkoi.

— Urdho...

— Ti do të shkosh në shtëpinë tënde!

Nusja e vështroi me çudi, me sytë e mëdhenj si të foshnjës.

— Pse, moj nënë? Ç'kam lërë?

— Do të kthehesh te babai...

Nusja uli kokën mbi gjoks,

— Unë... nuk kthehem...

— Do shkojmë bashkë, nesër.

— Jo... unë këtu e kam shtëpinë. — Nuses iu drodh mjekra dhe nuk foli më. Nëna i kishte vdekur nga «karqinua», duke e lënë jetime që dhjetë vjeçë dhe i ati që martuar prapë. Plaka solli ndër mend ata tre fëmijët e vegjël e të dobët që gëzonin në dasmë. Ajo i mbajti dorën dhe ngrohtësia e nuses i kaloi në deje. Ndjeu gjëzim në shpirt që nusja do të rrinte më të.

Nëna u ul në gurin te dera e shtëpisë dhe priti perëndimin. Qenë mbushur tre muaj që kur kishte vdekur Ganiu dhe ajo nuk qante më pasditeve. Nusja pastronte oborrin me fshesë dhe

ujiste lulet. Punonte me trupin tē përkultur e fytyrën poshtë. Nëna i pa mesin e këputur tē shtrënguar me kopsën e jekut dhe vithet e rrumbullakëta nën fundin e hollë. Nurteni, do tē kishte bërë fëmijë që t'i ngjanin Ganiut.

Një tē diel kishte ardhur i ati ta merrte. Ai kishte qarë mbi vatër kur plaka i tha se vajza donte tē rrinte me tē, po dukej se kishte ikur i lehtësuar,

Nënë Refoja kujtoi dasmën e tē birit...

Krushqit e largët kishin ardhur që tē shtrunën. Tē dielën në mëngjes gjëmonte daullja duke jehuar në shpatin e malit me dëllinjë. Thanë se qe dëgjuar edhe në fshatin përtej lumit. Kur erdhi nusja e qëndroi në krah tē Ganiut, dikush i kish pëshpëritur nënës në vesh «hyri drenusha më vathë». Njerëzit lëviznin vendit tek kalonte ajo në oborr, me trupin e njomë gjithë hir, me sytë përtokë. Tani e gjitha qe një èndërr... Nënë Refoja e përgjoi nusen tre muaj, duke i vështruar barkun fshehurazi. Ishte një bark i she-shtë, sic e kanë çupat. Dukej se emri i shtëpisë së saj do tē shuhej.

Nëna ngrihti sytë lart. Dielli ishte i kuq sa një tepsi, po qelli kishte ngjyrën e hirit. Ishte një diell që nuk skuqte.

Kali vinte rrotull në haurin në rrëzë tē oborrit. Plaka e pa përmes dërrasave tē mangëta. Nusja hyri në haur, i afroi barin dhe zuri ta kripte avash, duke e çikur në ballë. Kafsha vështronëtë në boshllëk me sytë e hapët tē butë; ku ndihej një trishtim pa mendim. Dukej sikur diçka kuptonte nga ajo që kishte bërë. Nusja e fërkoi me pëllëmbë, i foli nën zë dhe kafsha ul-

te kokën si tē bindej. Që tē dy kishin humbur tē zotin.

Nëna lëvizi vendit. Ndonjë ditë do t'i ndahej zemra më dysh. Ndjeu ftohtë në kurri e në majat e gishterinje. Stiva e druve në oborr kishte vajtur në fund dhe çatia kishte filluar tē pikonte. Do t'i thoshte Kasemit, kunatit, t'i gjente ndonjë djalë në qytet, t'i bënte punët e dimrit e t'i ndreqte shtëpinë.

Plaka trazoi zjarrin me mashë. Xixat u hapën me një kërcitje tē lehtë dhe u shuan. Deshi tē ngrihej tē merrte dru, po nuk lëvizi. I qe tharë shpirti dhe skishte zjarr që e ngrohte më.

U hap dera e drunjtë dhe rrezet e diellit ranë në murin karshi si nga një burim i fuqishëm drite. Hyri ngadalë një plak me trup tē paktë e tē drejtë, i pastër e i gëzuar, me xhaketë tē murrme dhe këmishë tē bardhë, tē kopsitur deri në grykë. Mbrapa tij vinte një djalë trupmadh, babaxhan, njëzet e pesë vjeç, me një triko tē vjetër e pantallona me arna. Plaku kishte thirrur në oborr.

Ajo u ngrit duke u mbajtur pas murit.

— Hajde, Kasem, ku e kisha mendjen?

Plaku e përqafoi ashtu siç përqafojnë pleqtë, duke mbajtur trupin e paktë larg e duke i mbështetur kokën në ballë. Pastaj u ul, vuri festen mbi shilte dhe i tregoi vendin djalit.

— Si ia shpie, — tha ai duke e parë nënën me mallëngjim,

— Si e nxirosur, — ajotundi kokën që të tregonte se çdo gjë kishte marrë fund dhe u ngrit se e mbytën plotët. Mbushi xhevzen me ujë dhe i gjeti vendin në prush.

— Kuh ke nusën?

— Pastron në odà.

Kasemi mbushi llullën me duhan, e ngjeshi me gisht dhe e ndezi me thëngjill, duke e thithur me faqet gropë.

Plaka trazoi kafen avash dhe e zbrazi në filxhanët e baltës duke e ndarë barabar çikacika.

— Ky është Aliu, djali i tretë i Ziverit, — tha plaku, duke e vështruar djalin me gëzim.

— Embaj mend, — tha i Refoja, — kur vdiq i ziu Ziver, ky ishte një pëllëmbë. Si jeni mor bir? Nëna mbahet?

— Mbahet, — tha djali.

Ai rrinte këmbëkryq, me bërrylat imbiçgjuni, dhe shihteglulet në qilimin e bivjetër. Pastaj ngriti sytë imbiçplakun, me një nënqeshje të ciltën, me rrudhativnë ballë.

— Eshtë usta i mirë, — tha i shkuari Ziverit, — në zanat, — ka në gjaku duke. Punoi nja tre muaj kur ndreqën dyshemetë e bashkisë, pastaj e hodhën në rrugë. Ku të dalë puna. Mbajeni ca t'ju ndreqë çatinë, — t'ju bëjë edhe dru përdimër, — tha Kasemi, duke e parë djalin, — në sy.

Djali i shëndetshëm e infortë, mëzit qëndronte ulur, protullonte sytë, në tavancë në mu-

re sikur donte tē shihte nga tē fillonte punë.

Një copë herë ndenjën pa folur, Filxhanët e kafes i kishin zbruzur prej kohe. Ishte herët tē çohej Kasemi, por edhe më gjatë nuk mund tē rrinte. Plaka donte tē mbetej vetëm.

Nusja rrinte në këmbë në mes tē dhomës, me flokët lëshuar dhe shihte nga dritarja. Pastaj ajo u ul në gjunjë dhe zuri tē krihej ngadalë, duke vaisur kokën. Hodhi flokët pas me një lëvizje tē shpejtë dhe vetulla iu duk më e zezë dhe buza e kuqe gjak. Ajo nuse ishte si një zjarr që digjej ngadalë. Plaka e shihte nga dera gjysmë e hapur.

Nusja u kthyte dhe qëndroi buzë shtratit e ulur në gjunjë dhe nuk lëvizi më, e qetë, e harruar, me një dritë tē fshehtë në sytë e errët, sikur rronte një jetë tjetër. Nuk kishte trishtim në sytë e saj, vetëm mall. Plaka e kishte parë edhe ditë tē tjera tē mbaronte punë shpejt në-për shtëpi e tē shkonte tē mbyllej në dhomë me orë. Jetonte një èndërr, një èndërr që do ta vazhdonte ditën tjetër dhe tjetrën prapë.

Nëna zbriti shkallët avash, duke u mbajtur me një dorë pas parmakut dhe ndjeu dhimbje në gjunjë. Pastaj dhimbja i kaloi në gjithë trupin si një valë e hidhur. Kishte dashur ta merrte nusen në dhomën e vet, tē flinin bashkë. Mbës trembej në atë shtrat tē madh vetëm. Ajo qëndroi befas. Do tē bënte atë që s'e kishte

bërë njeri, mbasë njëqind vjet e këtej. Do ta martonte nuseën prapë.

Refoja zbriti në oborr. Aliu mundohej të ndreqte dërrasat e haurit. Ai kishte punuar një javë në shtëpi. Dukej kudo dora e tij. Ajo e vështroi me sytë e rrudhur. Ishte trupmadh e vinte ca si avdall. Nuk qe si Ganiu. Ganiu i saj kishte qenë yll, jo djalë. Po Refos i pëlgente Aliu kur qeshte, duke rrudhur ballin e gjéré. Ishte i urtë dhe, kur punonte, nuk shihte tjetër vëç asaj që kishte në duar. I dridheshin duart kur merrte ndonjë gjë prej Nurtenit. Nusja nuk e shihte fare, mbasë s'ë kishte parë asnijëherë në fytyrë. Rronte në një botë tjetër.

— Ali, — foli plaka.

Ai u kthye dhe i qeshi me sytë bojë qelli.

— Urdherë, nënë Refo!

— Do shkosh nësër?

Djali ngriti supet.

— Po të mos kesh punë tjetër ti, nëno, do shkoj.

— Jo, xhan, s'kam. — Ajo u ul në gur. — Desha të na vije prapë.

— Vëj, posa s'yj, — tha djali me gjësim dhe u skuq. Ai u kthye që të fshihte turbullimin dhe zuri t'i binte dërrasës fort me sqepar.

Plakës i erdhë keq përtë. Dukej djalë i mire, e i ndershëm, nga ata që mbajnë mbi shpatulla shtëpinë. Po nuk ishte Ganiu i saj. S'mundta bënte as dhëndër, as djalë, Jo, s'ë bënte dot, pa i plasur zemra fare. Le që edhe nusja do të vente dëm. «Zot, o zot, tha plaka, ku i kisha mendtë aty më parë!»

Kur Ganiu mbushi vitin, plaka e martoи nusen prapë. Ajo e kishte thirrur Aliun në pranverë t'u lyente shtëpinë e t'u punonte arën dhe në shtator e kishte vënë ta bënte rrushin raki. Në nëntor prenë ditën e dasmës, pasi plaka e bëri Aliun djalë të saj dhe u ndreqën shkresat në komunë.

Nëna nuk bëri dasmë, po nusen e veshi prapë me të bardha dhe thirri kushërinjtë për darkë.

Djalit i gëzonin rrobat në trup. I shihte njërezit me sytë e mirë dhe ishte gati të qeshtë për çdo gjë, duke vështruar nga nusja e mbuluar me duvak.

Mund të ishte ora dy pas mesit të natës, kur Aliu hyri me nusen në dhomën e gjumit.

— Hë, Nurtén, tregohu zonjë shtëpie tanë, — tha Aliu. Ai po bënte ca lëvizje të tepërtë me duar dhe tha fjalë të tjera pa vend.

Nusja ishte ulur në karrigen pranë shtratit dhe e pa burrin përmes lotëve. Ajo vijoi të qante heshtur, ashtu si kishte bërë gjithë ditën. Po qante prej njëzet e katër orësh, duke fshirë hundët me një shami të vogël me dule të kuqe anash.

Aliu pa dyshekun e madh me jastëkët, me jorganim e kuq. Në muret, në dritaret, ngado që të ktheje sytë, ishin vënë mbulesa të qëndisura. Nuk ishin bërë për të. Iu duk sikur kish hyrë në një dhomë të ndaluar. Hija e atij të parit rrinte struktur. Aliu i kishte ardhur rro-

tull shtëpisë, po në atë dhomë s'kishte hyrë kurë. Aty rrinte vetëm Nurteni, kishte qenë dhoma e nusërisë së saj.

Ai murmuriti diçka dhe nënqeshi me kokën pak të turbullt nga lodhja e të pirët.

Nusja vijonte të qante, ngadalë e pa zë. S'ish-të parë nuse e tillë, që të shkrinte në lot, aty buzë shtratit. Aliu qeshi me zë të lartë si buda-lla, që të mposhtte druajtjen. E qeshura jehoi në dhomë si e shtënë me kobure. Ai u turpërua, u ul në karrige dhe filloi të zgjidhët këpucët duke u inatosur me veten. Duhet të hynte me nusen në shtrat, brenda jorganit të kuq e çar-çafëve të bardhë. Kjo kërkohej prej tij dhe përkëtë i rrëqet hej trupi. Por, tek e shikonte nusen pjerrtas, njëfarë ngërçi ia pushtonte gjym-tyrët, i mehej fryma dhe rrinte gojëhapët. I bëhej së do të ngjante diçka e rëndë, e pandreqshme, po ta prekte nusen me dorë. «Ki mendjen, Ali, hap sytë, mor djalë», i kishte thënë një ditë bekciu i fshatit, burrë i vjetër e i shëtitur. I zeshkët, më fytyrën rrumbullake e dhëmbët të ngrënë, ai kishte folur duke qeshur sikur mby-tej. Pastaj kish thënë duke ulur zërin. «Thonë së në brigjet e detit është një peshk gjarpër, me mishin të hatashëm, që nuk del nga uji i gjallë, po ra në grep ose në rrjetë. E bukuria e Detit i thonë. Mbyt veten duke përdredhur fillin pas kokës. Asnjë peshkatar s'mund të thotë se ka zënë një mërenë të gjallë.» Bekciu kishte qeshur mbytur, duke e vështruar me sytë e rrudhur. Ishte beqar, njeri idhniak e pijanec, dhe rrinte i vetmuar, po nganjëherë shpërthente pa-pritur, dhe merite pjesë në gjëzimin, e tjetrit

duke ia kaluar edhe njeriut vetë. Aliu qe ndarë prej tij me një ndjenje shqetësimi e duke menduar per atë të bukuren e detit që imbyt veten nën ujë.

U çua dhe shoi llambën. Dhoma rati në errësirë. Por buzë maliti ishte ngritur hëna, që zbardhte çatitë e fqinjëve. Drita e saj hyri në dhomë duke zbuluar nusen dhe shtratin.

Ai u ndie më i sigurt në gjysmerrësirë, ndjeni në këmbë para nuses dhe tha:

— Hajde, Nurten... hë, de!

Ai zuri të zhvishej me ndjenjën se po bënte një punë të kotë dhe do të donte t'i ekthente se prapthi të gjitha lëvizjet, të ulej te karrigia e ta mendonte punën prapë. Nusja qante me dënesë, me dhimbjen e njeriut që po i shkulet shpirti.

Ai mbeti me krahë varur dhe tha:

— Çdo gjë ka kufirin e vet, edhe të qarët e nuses.

Nusja ngriti kokën, e shikoi në sy dhe tha:

— Prej meje ke për të pasur vetëm lot... deri në fund të jetës.

Ajo ishte tetëmbëdhjetë vjeçë, me flokët e verdhë lidhur pas zverkut, me sytë gështenjë, me hundën pakëz të kërcyer. Ishte tepër e bardhë dhe i hipte lehtë të kuqtë në fytyrë. Por duhej t'ia shihje sytë nga afër, në dritën e diellit, dhe t'ia dëgjoje zërin e ëmbël prej fëmije, që të merrje vesh si ishte ajo. Thoshin se në fshatrat e Jugut nuk i gjendej shoqja.

Aliu eci zbatbur mbi qilim duke ardhur rrötull.

— Fol, — tha ai. Nuk po e përbante dot

dridhjen e zërit. Hija e tij e madhe u përkund në mur.

— Ti e di... — tha nusja.

Ai u zgjat të dëgjonte zërin e bukur, të mekur, drejtoi trupin dhe tha:

— Duhet të ma thuash me gojën tënde.

— Unë... s'mund të dua njeri tjetër...

Nusja u çua ngadalë, duke u mbajtur në karrige. Ajo zuri të zhvishej në hije, me lëvizjet e një të fjeturi. Aliu kishte presën e ftohtë në zemër.

Ata qëndronin në të errët, nën atë dritën e rrëme të tërthortë që viinte nga të dyja dritat. Nusja që ulur buzë shtratit, me kokën varur mbi gjoksin e bardhë. Aliu rrinte para saj, në karrige, duke dëgjuar frysma Marrjen e vet. Si i kaluan djersët e ftohta, truri i tij filloi të punonte ngadalë.

Ai e kishte ndier praninë e një armiku pa formë që kur hyri në dhomë. Tani ky armik ishte shfaqur befas e rrinte në këmbë.

Nusja nuk qante më. I kalonin pshëretima.

— Atëherë pse u martove? — e pyeti ai.

— Ashtu dëshi nëna, — tha nusja duke mangashërimi. Aliu ndjeu shtrëngim, në zemër.

— Njeriu nuk martohet më zor, — tha ai.

Nusja u ngurtësua, me kokën varur, me harkun e vetullës ngritur. I ndriste floriri që i rrinte si lak rrëth qafës. Ashtu mund të rrinte, yetëm njeriu buzë greminës, ose shpendi i rënë në rrugën e gjarprit. Aliu u fye, lëvizi dhe nën peshën e trupit të, tij kërciti karrigë.

Nusja shikonte derën e dhomës, me sytë e ngrirë.

— Kjo shtëpi u përbys prapë, — murmuriti Aliu padashur. Nusja nuk dëgjoi.

Ai e shikoi nusen gjatë, me duart e mëdha mbi gjunjë, gojëhapët. Dheu rrokullisej në sytë e tij, po më në fund qëndroi.

— Çohu e vishu... bëhu gati, — tha ai.

Nusja ngriti kokën.

— Ku do të shkojmë? — pyeti ajo.

— Vishu, — tha ai me zë të shurdhër, — do të ikim.

Nusja mendoi se s'kishin ku të shkonin, po për të ishte njëlloj.

— Po shkoj të nxjerr kalin, — tha Aliu dhe u ngrit duke u lëkundur mbi këmbë.

Nusja filloi të vishej ngadalë dhe tha me zë të fikur «si të duash ti».

— Mos ki frikë, Nurten, — tha ai pranë derës.

— S'kam frikë fare, — u përgjigj ajo duke nënqeshur. Fliste në jerm, duke u kotur. Mbasse s'kishte fjetur net me radhë.

Aliu hapi derën ngadalë dhe mbajti vesh. Pastaj doli në hajat, me këpucët në dorë.

Ora mund të ishte katër e mëngjesit kur ata dolën nga fshati. Agimi po zinte një pjesë të qiellit. Aliu tërhiqte kalin nga kapistalli. Nusja përkundej lart, duke mbajtur frymën, me sytë e frikësuar mbërthyer në figurën e tij të errët.

Mbi tokë, mbi pemët e mbi gjerdhet, ishte hapur bryma si një pluhur i argjendtë i rënë nga yjet. Nga kupa qellore, hëna e plotë derdhe dritën e bardhë. Hijet e natës tërhiqeshin në skutat. Bardhësia kishte pushtuar luginën e lumit dhe shpatet e maleve rrithet e qark.

Aliu zgjati hapin me nënqeshjen në cepat e buzëve, me rrudhat në ballë. Prej dy javësh kishte ecur rrugëve me kujdes, që ta ruante veten nga ndonjë rrezik i papritur, që të arrinte dëshmën shëndoshë e mirë, të arrinte lumturinë, për të cilën i flisnin të gjithë. Po ndërsa mblidheshin ditët, në fund të shpirtit i bënte vend gjithnjë më tepër një shqetësim se diçka nuk po ecte mirë. I dukej se lumturia shpërndahej diku larg; në ca lugina përtëj dasmës. Tani ai mund të ecte i shpenguar, s'kishte pse ta ruante veten, trupin e ndiente valë dhe mendjen të kthjellët.

Po, ecte me qafën të zgjatur përpara. Gjallësat e padukshme të dheut po rrithnin rrugët e tërheqjes, se agimi po përparonte në qiell. Poshtë, buzë lumit, ndonjë çift lepujsh brenin me ngut lëkurën e drurit para se të merrnin vrapin. Tek Arat e Hoxhës iu bë se lëvizi një hije. Ai mbajti këmbët. Hija e njeriut kaloi ultas me ngut, në anën tjetër të gardhit. Ishte Hasan Kashta që kulloste lopën në bahçen e fqinjët. Aliu pështyu anash.

Aliu e pyeti nusen tiёse kishte ftohtë, i rregulloi teshat dhe shtrëngoi rripin e kalit. Do

të zbritnin në atë përrua, të frikshëm edhe ditën, ku errësira ishte si pambuk i ngjeshur. Nusja e shikonte pa kuptuar, me sytë e zmadhuar nën hijen e shallit që kishte lidhur në kokë dhe në gjoks i ndritnin florinjtë e rremë.

— Mos ki frikë, Nurten, — tha ai. Ia kishte ëndë ta përsëriste këtë emër. Fytyra e nuses ishte e bardhë si karta.

Ata dolën me mundim nga pérroi dhe sipër në breg panë të ndriste si kurriz i peshku lumi i fuqishëm. Nuses i kaluan rrëqethje dhe i shpëtoi një rënkim. Ura e drunjtë rrinte mbi lumë si një varr prej thuprash. Ura e Ganiut. Ajo u zgjat pérpara dhe iu bë se ura kërciste e tundej nga era sikur në çastin tjetër do të këpuntej të binte në hon. Aliu hoqi rrugën drejt urës.

Nusja kishte parë të hapeshin varret aty më parë në përrua. Lëvizën gurët e mëdhenj, shpellat e shkëmbinjtë. Por ajo, e shoqëruar nga një burrë tjetër, që nuk ishte Ganiu, kaloi përmes tyre duke u mbajtur në jelet e kalit.

Nusja nuk dinte nëse kishte dremitur apo i pa vërtet gurët të lëviznin. Ajo nuk donte të kthente kokën prapa, por edhe pérpara ishte lumi i frikshëm.

Aliu hoqi udhën anës arave. Po shtohej era e ftohtë e lumbit, që rrëshqiste në kthesë si vaj i zi i ndritshëm. Nusja mendoi se pak më tej do të ishte fundi i udhëtimit. Shikoi natën e bardhë të heshtur dhe qetësia iu përhap në tërë trupin. Ajo ishte gati. Vecse donte të mendohej edhe pak.

Një muaj më parë, kur e vjehrra i tha se donte ta martonte prapë, ajo nuk bëri zë. Plaka donte nipër në shtëpi, ndryshe shtëpia e saj do të shuhej deri në themel. Tani erdhi fundi dhe ajo nuk donte tjetër veç të pushonte, të mendonte edhe pak, të pinte ujë.

Aliu kishte qëndruar si njeriu që humbet rrugën.

— A u lodhe, Ali? — pyeti ajo.

Djali u. kthye, me fytyrën në dritën e hënës, me rrudhat në ballë.

Nusja mëndoi se ky njeri s'kishte fytyrën e një vrasësi. Por kush di të shohë në shpirtin e njeriut?

Lumi rridhite poshtë urës me një zhurmë të butë tinëzare. Aty ishte vendi i ngjalës. Kali i hidhët këmbët me frikë mbi urë, kërciste potkonjtë. Aliu i ndenji afër, duke e qetësuar, duke mbledhur rrëth dorës kapistallin.

Tani ata po ecnin në anën tjetër, në rrugën e gjéré, buzë lumi. Qielli po merrte ngjyrë të çelët, kurse toka dukej e errët dhe e ftohtë. Nusja ktheu kokën pas. Poshtë, në lugine, duke shin varret si eshtrë të bardha të ngulura në dhë. Ajo e përfytyroi veten në një arkë druri dhe iu zifryma. Pati frikë nga nata, nga dhei i lagur, dhe iu ftohen duart. Ditët e para pasi vdiq Ganiu kishte dashur t'i shkonte pas. Donte të hidhej në grëminë, ose të mbytej në pus. I qe afruar nië herë pusit dhe qe varur mbi të të hidhej kokëposhtë. Pastaj qe ngritur e habitur, sikur një krah i fuqishëm ta kish tërheq fort. U gëzua që jetonte ende. Mund të kishte ndodhur diçka që s'kthehej dot më mbrapsht.

Tani ndiente ftohtë, sikur tē mos kishte rrobë nē trup. Pa burrin që e cte duke tērhequr kalin i menduar dhe iu duk i afërt, sikur tē kish tērë jetën që e njihte. Prej tij vinte jeta. Pa pér hérë tē parë shpatullat e gjera, zverkun e trashë dhe pati dëshirë t'i rrinte afër, ta prekte. Por mbasse ai nuk e donte më tani. Mund edhe ta vriste po tē donte.

— A u lodhe, Ali? — Deshi t'i shihte fytyrën. Nuk e kishte parë kurrë fytyrën e tij, që ta mbante mend. I rrinte nē sy si nē mje-gull. Ai nuk u kthye dhe tundi kokën. «Jo».

— Mbaje pak kalin, — tha nusja. Donte tē zbriste.

Ai e ndihmoi. Nurteni ia hodhi krahun rrëth qafës dhe u yar poshtë. Aliu ndjeu dridhjen e trupit tē saj.

— Dua tē eci më këmbë, — tha ajo.

— Ke ftohtë? — e pyeti ai.

— Jo. — Nusja ngriti pér hérë tē parë sytë e pikelluar ta vështronëte.

Ai shihte turbull, pér shkak tē trupit tē saj, tē gjakut që ndjeu poshtë rrobave tē nusërisë. Sytë e saj, nē dritën rremë tē natës, kishin vezullimin e qelqit. Mbasse qante. Ai zgjati kthet e dhet se çdo tē bënte Aliu me atë nënqeshjen e tij tē fshehtë, po s'mund tē pyeste.

Drita e agimit po trazohej nē qiel me e rrë-sirën e bardhë. Aliu ktheu kokën dhe vajza ia pa zbehtësinë, qështrat e dala tē fytyrës; mundimin e rendë që kishte hequr. Ndrydhja e fortë nē zemër po ia mërtte frymën Nurtenit.

Ajo foli vetëm dy herë pér agimin që po vinte òse pér freskine e mëngjesit, me mallëngjim, duke i ndenjur Aliut afër. Ai mendoi se ajo ishte një vajze e urtë. Dëgjonte zérin e saj une e miratonte me koke. Ai tha me vete se përtë nuk mbojet tjeter sinteg vëç të ikte nga ishati. Peshperitjet do ta ndiqnin prapa, do te rendnën para tij, qindra gjuhe si flakezat e kuqe; një murmuritje e vaznduar e dalë nga zgavrati e dheut. Ai u ndal të merrte fryme me nusen pranë. Në fshat po këndonin gjelat, lihte në tym një qen. Fluadi i mëngjesit kaloi mbi ballin dhe flokët e tij të verdhë.

— Ku po shkojmë, Ali? — tha nusja.

Ai uli kokën.

— Nuk e di.

Nuk e dinte vërtet. Donte të ikte nga ajo shtëpi, ku e ndiente veten te poshteruar. Kishte shëtitur me nusen nëpër nate, pa ditur ku të shkonte, sepse nuk mund të flinte me të në shtratin ku rrinte hija e një tjetri, me një nuse që nuk do të ishte kurrë e tij. Tani nusja nxitonte në krah të tij dhe dukej se donte ti rrinte pranë.

Ajo e vështronët në sy drejt. Djali ktheu kokën anash.

Nuk trembej vërtet. Kishte diçka tjetër në vështrimin e saj. Ajo mbante mjekrën lart dhe shihte rrotull me lakmi, me sytë e errët, të hapur fort, si të mos ngopej. Ashtu mund të shih-

te vetëm një i verbër, që i vijnë sytë papritur. Ishte një njeri i çliruar nga ëndrrat.

— Kthehem i në shtëpi, — tha ajo, — ne s'kemi ku të ikim. Kemi nënën.

Djali e vështroi dhe ndjeu të nxeh të në gjoks. Ajo nuk merrte frymë, mund të këpuntej e të binte.

— E pata harruar nënën, — tha ai dhe qëndroi një copë herë pa folur, me fytyrën poshtë. Mendohej. Ngriti, kokën, ia mori dorën nuses dhe e tërroqi në gjoks, pastaj e shtyu ngadalë, i trembur, u kthyte dhe shkoi me hapa të mëdhenj drejt urës së madhe, duke e tërhequr kalin nga kapistalli. Nusja nxitoi pas tij, dónte ta arrinte t'i shihte fytyrën e mirë...

KTHIMI I CUBIT

Togeri ecte përmes pyllit dhe mundohej të zgjidhte, vendin, në të errët. Dy herë qe rrëzuar duke shkarë mbi drurët e lagur mbuluar me gjethë të kalbura. Ai shkonte brinjas të pakësonte efektin therës të acarit. Dëbora që shkundej nga degët e lisave i hynte në zverk.

Para tij ecte plaku, Marka Lleshi, pas vinte një nëntoger i ri. Në krah shkonin varg figurat e errëta e të rënda të njerëzve, pa u ndier, si të mos shkelnin mbi tokë, sikur s'kishin të bënин me pyllin dhe natën. Nuk dëgjohej shkarpë të kristë e askush të kollitej. Togeri nuk ua shihte fyturat, dhe kjo e bënte nervoz.

Qëndroi mbi një trung të prerë dhe u mundua ta shihte pyllin në thellësi. Andej vinte një dritë e mekur, mbasë ishte një çeltinë që po merrte dritën e agimit. Togeri mori frymë thellë. Nuk e duronte errësirën, i bëhej gjithnjë sikur mund ta goditnin pas zverkut. Vështroi rrötull nëpërmjet trungjeve.

Prej një viti ndiqte në pyje bandën e Kolë Toskut dhe Nue Prengë Nikollës, duke u sjellë në gjurmët e tyre. Shihte me mendje si dredho-

nin ata në pyll, si trokitnin në dritaren e ndonjë shtëpie, si e brenin bukën e kapërdinin sallon, duke qenë të groposur e të mbuluar me gjethë dhe si i përpinte dheu kur ai bëhej gati t'u hidhte pallton sipër e t'i kapte. Tani informata ishte se banda ndodhej në livadhin e poshtëm. Togeri kishte marrë me vete 60 civilë ushtarë dhe tani i dukeshin shumë. Gjashtë muaj më parë do t'i kishin mjaftuar gjysmat. Do të bënte rrëthimin duke u hapur në gjysmën e pyllit rrëth livadhit, gjysmën tjetër do ta rrëthonë batalioni i ndjekjes.

Höqi kapelen dhe krehu flokët me gishtërinj. Rrobat në trup i qenë ngjitur e bërë njësh më njëra-tjetrën, dhe ai lëvizi si brenda një zhgualli. Kishte ditë që flinte veshur. Mbase tani kishte ardhur fundi. Ktheu kokën andej nga duhej të qe liridja. E kishte marrë malli për diellin. Lodhja po i mpinte trupin. Nëntogeri rrinte në këmbë.

— Ulu, — tha togeri. Plaku Mark kishte qëndruar më tej, në bisht, dhe gërmonte dëborën me shkop. Ishte i thatë, me zverkun të rruar dhe qeleshtë bardhë. Qëndronte gjithnjë larg dhe u hapte rrugën dy të tjerëve.

— Shkojmë, — tha ai pa u kthyer dhe u ngrit. Togeri mori automatikun me dëtar, e fërkoi më peç që ti fshinte ujin dhe u nis pas tij.

«Të kisha të ecurit e plakut», mendoi me lakmi.

Plaku dukej se s'flinte kurrë. Togeri, s'e kishte parë ti puliste sytë edhe kur qe zgjuar. Hante bukë nga trasta e tij dy herë në ditë dhe nuk pinte ujë.

Togeri ferkoi nofullat me dorë. I dhimbte lëkura, bëhej nêrvoz kur mbetej pa rruar. Nëntogerit i qe rritur një mjekër e dendur, e zezë, kurse plaku ishte laqji vjetërsi dukej se s'i rritej më mjekra.

Ecnim me nxitim. Qeleshja e bardhë e plakut hidhej mës gjetheve të errëta si një shpend pa krahë. Togefi mezi po e ndiqte. Tani ishte koha.

Kur dolën në afersitë e livadheve, qëndruan. Frynte erë e përzier me dëborë. Njerëzit rrinin grumbull. Togeri eci rrëth livadhit me nxitim. Çdo pesë metra u vendos një ushtar. Të gjashtë-dhjetë pushkët formonin një hark në formë potkoi.

Nxori orën e xhepitidhe e mbuloi me pëllëmbë. Po djersinte në kurriz. Plaku vështron te faqen e kodrës. Tojeri ndjeu në zverk frymën e plakut. Ai i kishte thënë ta ngrinin pritën në livadhin e sipërm. Nuk e kish dëgjuar plakun.

Po vonohen, — tha plaku, dhe i iku nofullat shtrembëringa të ftohtëtëb. Do të presim, — tha togeri dhe i qëndroi përballë që ta mbronte nga era.

Në pyllin e tejmë vetëtiu një flakë. Krisma e pushkës u përplas si një shuplakë në ajër dhe u mbyt në pyll.

— Ata janë, livadhi i sipërm, — tha plaku, Një zjarr i zgjatur automatiq preu në mes natën. Një batare pushkësh ndriçoi me ndërpërje faqen e kodrës. Togeri zgjati qafën dhe zbërtheu gjoksin. Po mundohej të merrte vesh dicta nga ajo lojë zjarresh. Dukej se çdo gjë kishte marrë fund. Banda i kishte shpëtuar pritës edhe një herë.

Ushtarët dhet civilët kaluan livadhin në heshtje. Kur u ngjitën në livadhin e sipërm, togeri qëndroi përballë kapitenit të ri, që komandonte dy kompanitë e batalionit të ndjekjes. Ata mundoheshin të shihnin sytë e njëri-tjetrit në errësirë dhet flisnin duke luajtur vetëmnofullat. Mundimi u kishte mpirë gjymtyrët.

— Banda sonte është në Vabli, se lumi nuk kalohet, — tha togeri.

Kapiteni u mendua. Ishte i ri e i nxeh të në trup e në zë.

— Smund të humbas një batalion me ushtarë për një bandë me qelbanikë, — tha ai duke u përpjekur të fliste me të qetë. Nuk ia falte togerit mundimin.

— Janë cuba mali e kriminelë që na kanë vrarë shokët, — tha togeri.

— Ushtarët nuk qëndrojnë më në këmbë, — tha kapiteni duke shikuar rrrotull pa parë asgjë. Ai nuk do të shkonte më tej atë natë, do të kthej të strehonte kompanitë.

Togeri mori njerëzit e tij dhe zbriti në Ura-
kë, te shtëpia e Haziz Farukut.

Haziz Faruku u soll një copë herë nëpër dho-
ma duke u folur grave dhe fëmijëve që s'duke-
shin gjékundi dhe u bëri vend atyre gjashtëdhje-
të burrave.

— Ku i çove fëmijët, or Haziz? — tha to-
geri.

— Mos u bëj merak, or toger Gjoni, — tha
plaku, — i kam çue mirë fort.

Te dera e dhomës po hapej një pellg me
ujë.

— Hapni arkën e konjakut, — i tha togeri
njërit prej ushtarëve.

— Ma ngadalë, or toger Gjoni, — tha plaku.
— Ke ardhë mik tek unë, apo si? — Ai törhoqi
pas derës një damixhan me raki.
Njerëzit i afroheshin, zjarrit të thaheshin,
pastaj largo heshin t'u hapnin vend të tjerëve.
Ayulli i kapotave si tym i bardhë ngruhej lart.
Dikush zuri të dremiste në sup të shokut, ndo-
një qeshte me zë të lartë. Nëntogeri i ri rrinte
me kokën mbi gjoks. Toger Gjoni bënte muha-
bet me të zotin e shtëpisë. Kërkoi me sy plakun
Marka Lleshi, po nuk e pa.

Ishte mesnatë, po nga një dritë, e tërthortë
dukej sikur nata po rrrokullisej diku.

Togeri kishte vapë. Plaku Haziz e mbante nga
dora. Po të qëndronte edhe pak, nuk do të ngruhej
dot më. Ai hodhi sytë përqark dhomës. Gju-
hët e flakëve ndriçonin fytyrat e skuqura të
njerëzve. Mbi mure luhatëshin hijet e bëra blok.
Togeri u ngrit në këmbë dhe u mbajt pas
oxhakut që të mos u binte njerëzve sipër.

— A u ngrohët, or shokë?

— U ngrohëm, — u përgjigjën disa.

— Mirë... — Ai heshti një copë herë. Po mun-
dohej të zgjidhte fjalët që kishte përgatitur. Pas-
taj filloj të fliste me tonin që i flitet një të së-
muri, buzagaz, duke gjetur kohën t'i shihte në
sy një pér një.

Sonte, o shokë, do të kalojmë në pyje
e në përrrenj, — tha togeri dhe rrotulloi vështri-
min diku mbi kokat e njerëzve. Ai shtrëngoi gju-
njët fort dhe lëkundi trupin pas e përparras si-
kur t'i bindej një trokitjeje të brendshme... — Në
pyje drurët kanë ngrirë dhe përrenjtë nuk kap-
tohen as ditën, po ne bandën do ta rrëthojmë në
agim në Vabli.

Ai priti ndonjë shenjë nga njerëzit, po nga lodhja sytë i mjegullosheshin. Dikush u kollit, pastroi fytin dhe pështyu në zjarr.

— Qenke ftohur, o dajë Ibrahim, — tha togeri duke e vështruar plakun me butësi. Ai mbërtheu kapotën.

— Kush e ndien veten të fortë, të bëhet gati. Të tjerët të qëndrojnë këtu. Me urdhrin tim të qëndrojnë këtu dajë Ibrahimini dhe Marka Lleshi.

Ibrahimini u çua në këmbë dhe shtrëngoi rrinpin e palltos.

— Jo, or toger Gjoni. — tha. Deshi të fliste prapë, po kapérceu mbi këmbët e njerëzve dhe u gjend pranë derës.

Marka Lleshi po shikonte togerin që poshtë vetullave. Ai dje përbledhur sikur do të kercente nga vendi.

«Eh, moj ketra plakë, tha me vete togeri, të kisha pasur një dhjetë veta si ti.»

Njerëzit po shpinin këmbët dhe ngjishnin çizmet. Togeri nënqeshi, me fytyrën mbi zjarr. E dinte se ashtu do të ndodhë. Askush nuk do të ndahej prej çetës. U kot edhe pak, gjithnjë duke buzëqeshur. Po i dukej se tashmë, çfarëdo që të ndodhë në pyll, banda nuk do t'i dilte edhe një herë nga duart.

Doli në oborr. Të ftohtët e mbajti mbërthyer në vend. Hodhi sytë përreth në natën që dukej sikur s'kish të sosur. Plaku qe nisur përpëra, njerëzit i përpjui pylli.

Çeta e rrethoi Vablinë në agim. Banda ishte aty, por ajo nuk arriti ta kapte në befasi. Banda çau nga ana e lumit, andej nga nuk duhej të çante, gjë që e habiti fort togerin dhe Marka

Lleshin. Togeriu vu ta ndiqte me ngulm nēpēr mjegullēn therēse tē agimit. Kjo bandē, e regjur nē pyll, kurrsesi s'mund tē ngjitej shpateve, ajo mund tē ndiqte veç pērroin e Gricēs, qē tē conte nē vaun e lumit. Çeta ecte nē ag nē tē dy anēt e pērroit, kurse gjurmēt shkonin vetēm nē krahun e djathtē. Plaku Mark ecte sipēr tyre pa i shkelur.

Togeri po djersinte tek rrokullisej me nxitim nēpēr shteg. Poshtē dēgjohej uturima e lumit dhe njē erē e lagēsht tē hynte nē lēkure.

Plaku qēndroi buzē ujit. Profili i tij dukej i errēt. Togeri i nguli sytē lumit qē fryhej e hidhej sikur mezi mbahej nē atē shtrat tē ngushtē. Nēntogeri i qēndroi nē krah. Nuk i kishin pritur me pushkē. Mbase ata ishing kthyer mbrapsht duke ecur mbi gjurmēt e tyre. Plaku sikur kalléronte mbi lumē. Qeleshja i kishte rēnē pas zverkut. Ai eci njē copē herē buzē ujit, pastaj u ul nē gjunjē dhe zuri tē zbulonte dēborēn me duar, me shpejtēsi, si ketēr, duke parē hērē pas here lumin.

— Ushtar! — foli plaku nēn zē. Nēntogeri rrēshqiti nēpēr shteg.

— Hap kētu! — tha plaku duke treguar me gisht pērgjatē bregut. Togeri u afra. Çfarë shihte plaku?

Ai ngriti kokēn dhe mori frysme thellē duke vēshtruar atē rrip qielli qē zgjatej mbi lumē si njē shteg i hapur nga koha. Lumi vraponte si njē lajmēs i lashtē. Vetēm zogjtē e erēs mund ta kalonin atē lumē. Togeri mendoi pēr lēvizjen rrethore tē natyrēs.

— Kētu janē, — tha plaku duke treguar me

gisht tokën nën këmbët e tij, — nuk janë kthyer mbrapsht.

Togeri e vështroi me mosbesim.

— Ose kanë hedhur lumin, — tha plaku duke e parë ngultas me sytë e thellë të errët.

Togerit iu nxehën duart siç i ndodhë gjithnjë kur ndeshët në gjurmë. Kish thënë me vete në fillim se do ta kapte bandën brenda dy javësh dhe po bëheshin gjashtë muaj që endeshin nëpër pyje. Férkoi zverkun me dorë dhe u soll rrotull vetes. Pylli i errët në të dy krahët e lumi dukej njësh, sikur mund ta çaje vetëm me sëpatë.

— Si e kanë hedhur lumin? — foli togeri gati me vete.

— Nuk e di. Këtu e kanë hedhur.

Togeri shkoi përpara dhe u kthye mbrapsht, duke krahasuar të ecurën e tij me gjurmët e kriminelëve. I mati me spango duke i ardhur rrotull konturit me gishtin tregues. Rrinte në gjunië dhe përkulte ballin gjer në tokë. Në fund u bind se ata nuk qenë kthyer mbrapsht.

Një çerek ore më pas çeta i zuri tre veta të bandës tek mundoheshin të mbaheshin në rrënjet e një peme, të zhytur në ujë deri në fyt.

Të nesërmen në drekë u gjendën në afërsitë e Urës së Matit dy njerëz të mbytur. Ishin Kolë Tosku dhe Nue Prengë Nikolla.

Toger Gjon Leka kaloi përmes rrugës së pazarit me ndjenjën se dikush po e ndiqte. Ishte

një ndjekës i largët, që nuk i dëgjohej hapi. Mbasse e cte në një hap me të. Ai ktheu kokën, i sigurt se do të përplasej në fytyrën e ndjekësit, po përveç zanatçinje e shitësye, që hapnin dyqanet, në rrugë nuk dukej njeri. U ngjit në trotuar dhe eci me ngut, duke u vështruar herë pas here në xhamat e veshur të vitrinave. Gati, e kishtë harruar fytyrën e tij. Kur ndiqte pyjeve bandën e Kolë Toskut, kish thënë me vete se, si të mbaronte punë, do të flinte tri ditë rresht dhe pastaj do të shkonte për darkë te një mikja e tij. Por, kishte fjetur vetëm tri orë, siç kishte bërë tërë atë dimër, dhe atë punën e mikes do ta mendonte më pas.

Para tij, në krahun tjetër të rrugës, shkonte me një dosje; nën sqetull Zef Rroku, nëpunësi i lokalitetit, i veshur me një xhup ushtarak të therur me tegela për së gjati. Kokën e verdhë gjatoshe; si ata kungujt që thajnë në kunjtë e gjerdheve për ujë, e mbante shtrënguar në mes të supeve të ngritura; sikur e ruante të mos i rrokullisej. Togeri mbajti këmbët derisa nëpunësi u kthyesh në rrugën e komitetit, ekzekutiv. Që mbasë i vëmri njeri, në Burrel që i prishtë gjakun kur e shihte.

Te dyqani i berberit qëndroi një gast. Era e parfumit të sillte të fikëtit. Që përtej xhamllëkut me avull u sul të hapte portën, berberi i vjetër. Me flokët e lagur të krehur pas kokës dhe fytyrën e kuqe si të njomë, i imët e i pastër si një peshk i qëruar, të bënë të të dukej vetja i palarë. Ishte i gatshëm t'i hiqte një brisk kujtdo që kalonte rrugës, i vendosur të forconte higjenën e qytetarëve me çdo kusht.

— Urdhno! A don me u qethë, a? — Ai hapi

portën kanat dhe qeshi duke zbuluar ca dhëmbë té vegjël me majucë.

Togeri ndërroi mendje:

— Do vij më pas, — tha. Ai vështroi një çast në murin përballë pasqyrën e madhe me anët e rrumbullakosura, që dukej si porta e një bote tjetër. Një hije e njojur lëvizi në të, aq e njojur dhe e afërt, sa togerit i rrahu zemra. Ktheu kokën me rrëmbim, po rruga ishte krejt e heshtur, e ngirë nga acari i mëngjesit.

— Shëndet, — tha ai, ngriti dorën dhe nxitoi të ikte. Në zyrën e tij pastruesja kishte ndezur zjarrin që herët. Togeri qëndroi një copë herë ulur në karrige, me fytyrën kthyer nga muri, duke vështruar hartën e rrethit. Nuk kishte asnë shenjë mbi të, por ai e merrte me mend se ku duhej të ishin në hartën e gjeneralit në ministri, dy vendet e shënuara me laps të trashë blu.

Oficeri i rojës hyri dhe qëndroi gatitu në derë. Një grua e re, me shaminë lidhur rreth ballit, mbylli derën dhe zgjati kokën mbi supin e oficerit.

— Na lër vetëm, — tha togeri. Kish qenë hija e saj që e ndiqte atë mëngjes apo ashtu i qe dukur?

Si doli oficeri, gruaja lidhi duart mbi gjoks dhe shikoi togerin duke buzëqeshur me dhembshuri.

— Si është puna, Marie? — foli ai. Në krye u gëzua që e pa dhe kjo nuk i shpëtoi gruas së re, pastaj u kujtua që ajo nuk duhej të paraqitej në Degë, sidomos ditën.

— Gjithnjë do bësh marrëzira, moj Marie?
— tha togeri.

Gruaja e shihte ngultas dhe buzëqeshte, çmallej me fytyrën e tij. Ai rrudhi vetullat mbi ballë, siç bënte kur donte të zemërohej e nuk mundej.

— Qyqja, Gjon, — tha më në fund gruaja.
— Ke shpëtuar kot, përfat tonë, shpëtovë edhe kësaj here. — Ajo lëvizi sytë shpejt që të mos qante.

Fytyra e togerit u shkreh. Ai buzëqeshi, eci përpara dhe e përqafoi. Nuk donte të dinte nga se kishte shpëtuar. I luftoi zemra në kraharor dhe zëri i gruas së re iu përhap në deje si këngë malli. Po të vritej diku në përpjekje, përtë do të qanin disa njerëz, po do të qante deri në fund të jetës ajo vajzë që fërgëllonte në gjoksin e tij.

E uli pranë dhe ajo filloj të tregonte se si kishte shpëtuar nga një vdekje e sigurt tri net më parë. Gruaja fliste dhe tmerrohej nga ato që mund të kishin ngjarë dhe e prekte me dorë sikur donte të sigurohej që ishte aty.

— Mos ki frikë, Marie, — i tha ai. — Nuk do të më ndodhë gjë kurrë.

Ajo buzëqeshi e lehtësuar. Ai vuri re rrudhat e imta rrëth syve dhe i erdhi keq. Maria po u afrohej të tridhjetave dhe ishte më e bukur se më parë, po ngjyrat e rinisë po i zbeheshin.

Togeri e dëgjoi pa luajtur vendit. Ajo tregoi me radhë, pa lënë asgjë pas dore dhe pa shtuar gjë të tepërt. Togeri e njihte atë të folur, që i shkonte gjithnjë në zemër. Ishin rritur bashkë. I ati i Maries, fqinj dhe probatin i atit të Gjonit, shkoi të merrte gjakun e vëllait të vetëm dhe nuk u kthyte më, atëherë kur Maria

ishte ende pësë vjeçë. Leka, i ati i Gjonit, i mori e i rriti të tre fëmijët, bashkë me gjashtë të tjtë, duke e nxjerrë ushqimin nga guri. Kur Maria mbushij njëzet vjeç, babai kish dashur ta fejonte në një fshat tjetër. Ishte dasma e parë dhes plaku gëzonte. Vajza filloi t'u vidhej njerëzve. Pastaj, një ditë i kish dalë Gjonit në rrugë, mbase e kish pritur me orë, e fshehur pas gurit, se i qe mavjosur buza nga të ftohtët. Ajo kish thënë me një frymë se mund të martohej vetëm me një njeri në botë e, meqë s'mund të martohej më atë njeri, më mirë të rrinte qyqe. Gjoni nuk e kishte pyetur. Veçse i qenë ngulitur në tru dy sytë e Maries kur ajo e pa nga afër në të errët, ku i tha për njeriun e vetëm në botë.

Pastaj ajo kish ikur me vrap dhe nuk qe kthyer më në shtëpi. Rronte te një hallë e saj.

Maria po thoshte se, kur togeri po ndiqte bandën e Kolë Toskës nëpër pyje, kishte ndeshur padashur me bandën e Dedë Gjon Nikollës. Dikush kish ngritur automatikun mbi togerin, po Dedë Gjon Nikolla i qe hedhur sipër e i kish mbajtur duart.

Togeri vari kokën mbi gjoks dhe ra në mendime. Vjeshtën e kaluar ishte bërë mbledhja e bandave në kreshtën e Mirditës, aty ku ndahet kufiri me Rrethin e Pukës. Të deleguarit e ardhur nga jashtë u thanë atyre gjashtëdhjetë burrave të ulur në shesh se duhej të kapërcenin kufirin gjersa të kalonte dimri e të çelte gjethi prapë, se kryengritja do të bëhej shpejt dhe ata i kishin gëlltitur fjalët e tyre nga e keqja. Dedë Gjon Nikolla qe ngritur e kishte thënë

se nuk do tē bëhej vegël e tē huajit. Pastaj kishte marrë djemtë dhenkishtë ikur i qetë majë gurëye.

Togeriu ngrit. Ai nixori nga kasaforta në mur një fotografi tē vogël; tē zverdhur dhe e vështroi një copë herë, si tē kërkonte një përgjigjenë heshfje. Dedë Gjon Nikolla ishte një burrë shtatgjatë, i zeshkëtë e i thâtë. Kish një pale mustaqe memaja tē ngritura përpjetë, që dukeshin si një gojëz e hekurt dhe sy tē shpejtë e hundë tē kërcyerë si sqep zogu. I gjithë shtati i tij iu lakueshëm dukej si një lëkurë e regjur që s'mund tē pijë më luje.

Togeri nixori një letër tē bardhë dhë u ul tē shkruante duke e varur kokën anash. Dukej se hiqte zor në tē shkruar dhe pas çdo fjalë ngrinte penën tē shihte letrën. Kur mbaroi, lexoi edhe një herë atë që kishte shkruar duke lëvizuri buzet në heshfje.

Dedë Gjon Nikollës,

Ku tē jetë.

Ti nuk je armik i pushtetit. Mbështetem edhe në burrerinë tënde, tē ftoj tē takohemi ku tē duash, më sa veta tē duash. Unë do tē vij vetë i dytë. Qëllimi im është tē kthehesh në shtëpi me bijtë e nipat, tē dorëzohesh në besë!

Tofer Gjon Leka

Maria ndiqte me zemër tē celur mimikën e fytyrës së tij. Mori letrën dhe e futi në gjit.

Do t'ia conte në dorë Dedë Nikollës nëpërmjet po asaj baze që sillte lajme.

— Do të vij ndonjë natë të shoh hallën, — tha togeri.

— Edhe Marien, — tha ajo.

— Të më bësh një darkë të mirë, — tha ai. Maria e vështroi me sytë e ndritur.

— Të fala babës, — tha dhe u zhduk pas derës.

Togeri mbeti duke shikuar derën e myllur. Qenë rritur si motër e vëlla dhe dukej se ashtu do të mbeteshin tërë jetën, pa qenë vëlla e motër, njëra qyqer e tjetri Gjon.

* * *

Dedë Nikolla me tre djemtë dhe dy nipërit dëgjoi leximin e letrës së togerit. Po e lexonte nipi më i vogël, Gjeta.

— Të takohemi, o babë, — tha djali i madh. Të tjerët ndenjën kokulur, duke pritur.

— Nuk dimë a i zihet besë, — tha Deda.

Plaku po kujtonte atë ditën kur e burgosën me disa njerëz të dyshimtë, kur kriminelët vranë sekretarin. Në hetuesi kapteri i yjetë e kapi Dedën nga mustaqeta. Atëherë toger Gjon Leka çua dhe e bëri kapterin t'i shkonin djersë. Nga ajo ditë kapteri s'u pa më dhe javën tjetër Dedën e liruan. Toger Gjon Leka s'mund të qe pra një burrë i pabesë.

Plaku shikoi djemtë me radhë, ata mezi përbaheshin. Kishini në fshat nuset e reja. Po

egërsoheshin gjithnjë më fort, grindeshin me njéri-tjetrin.

Rrudhi sytë dhe ndenji gati përbys. Kishte dalë komit në kohën e Zogut se kishte vrarë pér punë nderi, të atin e atij Gjetës së njomë, që rrinte shtrirë brinjazi dhe shihte rrrotull me sytë e zez. Atë e kish më besnikun e të gjithëve. Pastaj kishte qenë i arratisur në kohën e Italisë pér një vrasje në Mirditë dhe mori pushkën e doli në bjeshkë edhe në këtë qeverinë tjetër. Shtatembëdhjtë vjet në male. Ai vështroi në sytë e shkruar të Gjetës dhe lexoi ato që djali nuk do t'i thoshte me gojë kurrë.

— Shkruaj, pra, të vijë, — tha Deda. — Të vijë në Lufaj, mbas pyllit, te shtëpia e Preng Brucit.

Toheri e kaloi natën pa gjumë. Ai kishte qenë një partizan trim, por pak i zhvilluar. Me vështirësi arriti të bëhej komandant kompanie. Pastaj punoi në Armën e Sigurimit. Po u afrohej të dyzetave dhei kishin filluar t'i binin flokët. Si punonjës i Sigurimit kishte një zemër të zjarrtë, po jo një kokë të ftohtë. Toherit i dukej se s'mund t'i vinte bashkë këto dy cilësi. Shumë herë vëpronte vetëm më zemër. I kishte shkruar Dedë Nikollës pa i thënë njeriu, dhe tanë mëndohëj. Pse qe arratisur plaku? Toheri ishte i sigurt sé, po ta takonte, ai nuk do t'ja tregonte punën krejt. Mund të

ngjante edhe të mos fliste fare. Por a do të vinte Deda në takim dhe a do t'i dörëzonte armët? Togeri mendoi se ishte ngutur me letrën pa e biseduar punën. Udhëzimet ishin të qarta, askush s'mund të hynte në bisedime me armikun pa qenë i autorizuar. Si do të bëhej, po të mos pranonte kryetari? Togeri liroi jakën te gryka. Në të njëjtën kohë ndiente një nxitje të papërmbajtur ta çonte punën përpara, sido të bëhej. Atëherë u vu të mendonte hollësitë, të kërkonte mbështetje për të arsyetuar ngutjen e vet. Qëndrimi në arrati i Dedë Gjon Nikollës, vetë arratisja e tij, përbante një të fshehtë, kërkonte një lidhje. Çdo hollësi duhej peshuar, kishte ardhur koha. Tani po i kujtohej se ditën që ishte arratisur Dedë Nikolla, kishte qenë herët në lokalitet. Ai kujtoi kokën e qethur të nëpunësit të lokalitetit, Zef Rrokut, që shkonte e vinte si pjepër mbi regjistrin e trashë. Lyente gishtin me pështymë dhe shfletonte fletët e mëdha, të zverdhura, që në qoshet kishin marrë ngjyrën e ndyrë të pështymës. Nëpunësi qe ngritur me bërrylat të hapur anash e trupin të përkultur dyfish dhe kish thënë, duke vërtitur ata sytë pa ngjyrë si t'i qenë këputur damarët: «A more vesh? Dedë Nikolla vetë i gjashtë na la hijen.» Togerit i qe dukur sikur kishte njëfarë gjëzimi në ata sytë e rrumbullakët. Kur të shkonte të takonte plakun, do ta merrete me vete, pikërisht atë, Zef Rrokun.

Të nesërmen togeri dhe kryetari i Degës shkuan te Sekretari i Parë i Rrethit. Pas tri ditëve ai u nis për Lufaj. E shoqëronte nëntogeri i ri, nëpunësi i lokalitetit dhe një fshatar. Një

gjysmë ore më pas u nis pas tyre një kompani me dyzet ushtarë, që do të zinin pritën në pyllin e Tharrit.

Togeri ecte me nxitim pas fshatarit. Atë ditë në zyrën e sekretarit kishte ndier gjësim në shpirt kur ai i kishte thënë: «Mbase kështu është më mirë.» Po tanë, tek ndiente një hap më pas gullçimin e nëpunësit të lokalitetit, kjo i dukej një fitore shumë e lëhtë për t'u besuar. Kishte ftohtë në zverk, si t'i frynte fryma e tij e akullt. Mbase s'duhej ta kish marrë me vete. Togeri u ngjit në majë, prej nga dukej pylli, dhe qëndroi. Vështroi faqen e bardhë e të pjerrët të kodrës dhe ndjeu nën këmbë dëborën e butë. Tej, mbi kurorën e errët të pyllit, dëbora dukej si shkumë e prerë. Po i merreshin mendtë nga lodhja dhe u zgjat me shpresë që të shihte ndonjë lëvizje në mes të trungjeve. Nxori dy gurë të vegjël nga xhepi dhe zuri të trokiste. Mbajti vesh. Të njëjtat trokitje u përgjigjen nga brëgu në majë. Ai bëri përpara dhe, kur doli në një lëndinë të vogël, u gjend ballë për ballë me bandën e Dedës. U panë në sy një copë herë. Togeri dhe zëvendësi i tij lëshuan armët përdhe dhe ecën në lëndinë. Deda shpejtoi të ultë armët si i zënë në faj dhe eci me djemtë në krah.

— Tungjatjeta, o Dedë Nikolla, — tha togeri.

— Tungjatjeta, o kapedan Gjoni!

Togeri qeshi dhe i zgjati dorën:

— Ti nuk jé vra më ne, — tha ai. — Rroke dorën!

Deda ia shtrëngoi dorën. Vuri buzën në gaz,

pastaj u zmbraps dhe qëndroi para djemve të tij...

— A u lodhe në këto bjeshkë, o Dedë Nikolla?

— tha togeri.

— Nga pak, — tha plaku. Ai e vështroi pjertas, të kuptione në tallej, pastaj foli prapë, me kryet lart:

— Kam shtatëmbëdhetë vjet në këto bjeshkë.

Togeri e çmoi fjalën e tij të hapët.

— Partia don t'ju shpëtojë, — tha togeri.

— Ka dashë zoti e nuk jemi vra, — u përgjigj ngadalë plaku.

— Cilat janë konditat e tua? — tha togeri.

— Të njof për burrë, or kapedan Gjoni, — u përgjigj plaku. — Nuset nuk m'i ke internue dhe gja e mall nuk m'i ke prekë. Edhe mustaqet nuk ke lanë të m'i rrallojnë. — Ai heshti një copë herë duke fërkuar më gishtérinj mustaqet.

Togeri mendoi se kishte punuar me mend kur kish propozuar një plan të veçantë për të arratisurin Dedë Gjon Nikolla.

— Kërkoj të më kthesh plakën në shtëpi, të mos më pyesësh se ku më kanë dhanë bukë dhe të mos hyj ditën në qytet.

— Punë që bëhen, — u përgjigj togeri, duke përbajtur gëzimin.

— Kërkoj edhe diçka tjetër.

Plaku lëvizi përpara me kokën ülur. Dukej se ajo që do të kërkonte tani, kishte më shumë rëndësi për të. Ia nguli sytë nëpunësit të lokalitetit dhe doli duke ngritur gishtin mbi të:

— Të japë fjalën edhe ky.

Nëpunësi i lokalitetit bëri një lëvizje të lehtë;

sikur donte të ikte mbrapsht dhe togeri pa si i bëri shenjë Dedë Nikollës duke ngritur vetullat lart. «Mos u dorëzoh!

— Ky vërtet ka ardhur si përfaqësues i pushitetët, po nuk besoj se të duhet garancia e tij, — tha togeri. — Ka ardhur më fort për të hequr rrugën. — Në zërin e tij ndihej kujdesi.

— Jo, — tha plaku dhe ndenji si gur. — Rrugën e ka hapur ky miku, — dhe tregoi fshatarin.

Togeri pa sytë e qëlltë të plakut, gati në ngjyrën e dëborës, dhe mendoi se diçka po thyhej e prishej brenda tij. Donte të kthehej e të shihte fytyrën e nëpunësit të lokalitetit, po këtë s'mund ta bënte. Tani ishte i bindur pér atë që kishte dyshuar më parë. Dedë Nikolla ishte hedhur në arrati më dredhinë e thjeshtë të këtij nëpunësi.

I regjistroi 80 krerë bagëti më pak, pastaj i tha të dilte në bjeshkë se puna qe zbuluar dhe do të kalbeshin në burg me gjithë djemtë. Prandaj e kishte marrë me vete nëpunësin që të sqaronte dyshimin. Tani mendonte çastin kur do të kthehej në Degë, dhe ta ulte në karrigen përbalilë, t'ia shihte sytë dhe të hetonte shpirtin e tij.

— Të flas pak më çunat, or kapedan, — tha Deda.

Ndërsa Deda u hoq mënjanë, togeri zuri zë-vendësin pér krahu.

— Punën e ke në vijë, — tha me gjësim nëntogeri.

— Më duket se puna u prish. Rri gati, se këtu mund ta dojë puna të vritemi, — tha togeri.

Nëntogeri i ri ktheu kokën të shihte vendin ku kishin lënë armët dhe ndenji i qetë. Togeri e

vështroi buzagaz. Qëndruan me duart prapa të prisnin Dedën.

— Banditi u kthye, i ngrysur e i errët.

— Kérkoj shtatë ditë të mendohem, — tha, me zërin të ftohtë ashtu si edhe sytë.

Togeri ndjeu nxëhtë prapa kokës. Tani e dinte që nuk do të përmbahej më dhe kjo e bënte nervoz.

— Po të jap tri ditë, — tha togeri. — Pas tri ditësh, as ujë nuk do të të lë të pish në rrëthin tonë.

Djali i madh i Dedës kishte dalë një hap përpara dhe hapi krahët sikur donte të ruante njerëzit e vet.

— Mos e prish me babën, or kapedan, — tha. Ishte i zbehtë dhe në zërin e tij ndihej lutja, po vetullat e zeza i kishte mbledhur mbi ballë me kërcënëm. Plaku ktheu kokën me vrull dhe luajti vendit. Gjeta i ri rrinte kthyer mënjanë dhe s'jepte shenjë, si një i shurdhër.

— Për ju, o çuna, kam ardhur këtu, — tha togeri.

— Ke ardhë të mbjellësh grindje, për këtë ke ardhë, — tha me vrer plaku.

— Kam ardhur t'ju tregoj ato që i dini, po nuk doni t'i pranoni. Ulni armët e shkoni në shtëpitë tuaja. Po u bëtë tradhtarë, ne do t'ju shfarosim, jo tani, po javën tjetër.

Togeri e pa se fjalët po kalonin caqet e urtësisë. Tani do të shkonte duke ngritur zërin e do të bënte marrëzira.

— A kujton se jemi gra e don me na tutë?

— pyeti Deda duke qeshur me të keq. Tani ai ndihej i sigurt. Çunat e tij mund t'i bindje

me të butë, por nuk duhej të gaboj duke i frikësuar. Fytyra e banditit kishte marrë një ngjyrë të përhime ngarkënaqësi. Ai e shihte togërin ngultas, si të donte t'i provonte nervat. Nxori kutinë e duhanit dhe drodhi një cigare me një rrötullim të gishtërinjve, pa ia ndarë sytë.

Togeri e humbi mendjen.

Lëreni or qunë, ikni, të shpëtoni prej tij! — thirri ai, i cili është shpëtoni?

Djemtë e panë togerin me armiqësi të hapur. Plaku u kthye tek armët dhe hodhi pushkën në sup. Djemtë i shkuan pas një nga një, morën armët dhe filluan të ngjitnin kodrën.

Plaku u kthye papritmas, sikur të kish dëgjuar fërshëlli mënë e një nepërke.

Aruhua po nra pret në besë, or toger? — Ne tradhtarët i godásim më plumb ballit, jo pas shpine! — thirri togeri.

Deda u kthye dhe u nis përpjetë bregut duke kërcyer në majë të gurëve si dhi e egër.

— Dëgjo edhe një fjalë, or Dedë Nikolla — thirri togeri.

Tani plaku kishtë dalë taman në majë. Trupi i tij i laqueshëm dukej sikur valëvitej në erë. Aiktheu vetëm kokën.

— Moshkalo nga pylli i Tharrit, se aty do të lini kokat.

Plaku u hodh nga guri poshtë.

Togeri u ul mbi trungun e një lisi të rrëzuar dhe ferkoi ballin me pëllëmbën e dorës. Zë-vendësi i printor gati. I dha cigaren, ia ndezi dhe përpiquej t'i bënte ndonjë shërbim. Nëpunësi i lokalitetit thoshte diçka kundër, banditëve nën

zë, duke u munduar të përhiqte vëmendjen e togerit.

Qielli rëndonte mbi tokë si një kopolë ngjyrë plumbi. Ishte e pamundur të çmoje kohën. Togeri lëkundej me duart lidhur në gju dhe përtonte të nxirrte orën.

Ai ndenji ashtu gjatë. Ku duhej të shkonte tani e me cilin të fliste? Të gjitha rrodhën së prapthi, ashtu si kish thënë kryetari i Degës kur po shkonin te sekretari. Ai e kishte humbur mendjen, qe kacafytyr me fjalë si bakejtë që shahen pa dalë nga dyqani. Rrudhi sytë dhe u mundua të shihte fytyrën e nëpunësit. Deshi të ngrihej, ta zinte për fytin, t'ia shtypte atë kokën si kungull, por u përbajt.

— Ju falem nderit shumë, o shokë, — tha më në fund togeri dhe u ngrit. — Ju të dy shkoni në shtëpi, se për sot e kryet shërbimin. Unë dhe Niku do shkojmë gjetiu.

Ai priti gjersa këmbët e tyre nuk u ndien më në pyll, pastaj tha:

— Mbaje mend, or çun, se sot u turpërua toger Gjon Leka, por ai akoma nuk i ka dorëzuar armët.

Djali i ri nuk foli, uli kokën dhe psherëtiu.

Togeri hodhi automatikun në krahë dhe u nis përpara. Kur zbriti në lokalitet, dërgoi korrerin të njoftonte në Degë dhe bëri ca punë të tjera.

Ato tri ditë do ta ndiqte bandën nga larg, në rrëth, pa u ndier, pa i lënë shteg të hapur. Nuk i hiqeshin nga mendja sytë e atij djalit të vogël, nipit, që rrinte mënjanë. Kishte vë-

shtrimin e njeriut qe mbytet. dhe s'kerkon ndihmë, sido qe te vijë puna.

Në darkë toger Gjoni e mori Nikun me vete në shtëpinë e Maries. Plaka i priti miqtë në kullën e vjetër, ku ishin ende varur nëpër mure armët e burrave dhe çiftelia. Në kullën e saj burrat e djemtë kishin vdekur të gjithë para kohë, prej plumbit, po hija e tyre zotëronte. Ajo u bëri miqve dritë dhe zjarr, shtroi sofrën pa u ndier, pastaj u ul të pinte raki me ta, duke i nxitur të hanin mezet.

Maria qëndronte téré kohën në këmbë duke shërbyer, dhe Gjonit i rrinte turbull në sy xibuni i saj, me vijën e bardhë të lakuar në fund, qe vërtitej rreth dhomës. Ajo via e bardhë e ftohtë i vinte qark, si t'i lidhte trurin, i ngatërronte mendjen. Kur do të qëndronte Maria?

Plaka i tregonte Nikut për burrat e fisit dhe Maria mbante zjarrin ndezur. Gjoni mendoi se ajo nuk ishte më vajza e atij mëngjesi, që e ndiqte në acar. Ishte e zonja dhe e bija e zjarrit. Zotëronte kullën dhe sofrën me hijen e saj. Tani ajo i qëndronte larg duke i ardhur qark me një lloj mërie të verbër, me një fuqi të fshehtë si njériu që është në tokën e tij. Psé i mbante mëri ajo?

Gjoni lëvizi nga vendi. Nuk do të rrinte atë natë në kullë. U ngrit dhe u afrua në vatër të ndizte duhanin.

— Plaku do të kthehet, — tha Maria pa u kthyer, duke tražuar zjarrin. — Nuset dalin për tijë ditën me diell.

— Nuk e di më, — tha Gjoni dhe ferkoi

sytë duke i mbledhur me gishtërinj. — I kam dhënë tri ditë afat.

— Je i lodhur, — tha Maria. Zëri i saj i thellë, i butë, të ftonte në prehje.

— Po, — tha Gjoni. Mbësë puna do kish vajtur mirë, po të mos e kisha marrë me vete Zef Rrokun.

Maria mendohej, pastaj u kthye dhe e vështroi drejt. Njëri sy, i ndezur ngan flaka, i dukej i kuq.

— Ai Zef Rroku pret nga një dash më javë, — tha ajo dhe fytyra iu errësua.

— E di.

— A don me i çue fjalë tjetër plakut?

— Jo.

— Kushedi kur do na sjellësh miq herë tjetër! Ajo foli gati me vete, me fytyrën nga vatra.

Gjoni u kthye në sofër dhe ndjeu ftohtë në shpatullë. Afër mesnatës ai u ngrit. Do të flinin në lokalitetin Nikule ndoqi me pahir.

Gjeta ia kishte ngulur sytë ujtit të gjelbër të liqenit. Kodra në bregun tjetër, si një gjigant i qfjetur, luhatej në ujë. Djali dëgjonte më dhimbje goditjen e rregullt që i vinte riga thellësia e gjoksit dhe habitej si njeriu i parë që nuk e dinte se kjo vinte nga zemra. Pse t'i rrihte zemra aq fort?

Ata kishin kaluar të pardjeshmen në pyllin e Tharrit dhe kishin rënë në pritë. Djali i

madh i Dedës kishte dalë përpara në këmbë, duke përfshirë me automatik rrëzët e pemëve, si të donte të rrëzonte pyllin. Dukej i kapur nga një ethe e marrë, si një njeri që i ka bërë gjyqin vetes. Qenë ngritur Nikolla, vëllai i dytë, e i që hedhur sipër t'i ultë armën, pastaj qenë shembur të dy në shesh, njëri mbi tjetrin.

Atëherë Dedë Nikolla qenë ngritur në këmbë dhe kish thënë me zë të lartë se ishte në besë të toger Gjonit dhe kërkonte t'i hapej rrugë. I kishin imbjtur aty një orë, pastaj i kishin hapur rrugë. Ata qenë kthyer mbrapsht duke ngritur të vrarin. Në mbrëmje e varrosën djalin neri një lis dhe për herë të parë Deda me dy djemtë e vegjël dhe dy nipërit nuk kërkuan strehë për natën.

Togerik u kish dhënë tri ditë afat dhe kjo ishte dita e tretë. Kishte qenë e bukur liria ato tri ditë, gjatë të cilave plaku duhej të mendohej. Tanimë s'kishte çfarë të mendonte. Një natë i qenë afuar qytetit dhe Gjeta qe mahnitur me dritat e tij. Deshi të hynte në qytet t'i shihte nga afër, po plaku nuk e kishte lënë.

Gjeta ktheu kokën të vështronë plakun dhe i erdhi keq për të. I kishte vrarë babanë, po s'mund ta dënonte për këtë. Ai kishte qenë nip para se Gjeta të ishte bir. Plaku dukej i lodhur dhe nuk qe më trupmadh si përpara. Mbështetur në trung dhe e shihte me një sy, tjetri, që e mbante të pulitur, i

lotonte pa pushim. Që kur vartosi djalin në pyllin e Tharrit, nuk kish folur më. Ruante tërë kohën. Gjetën me syrin e bardhë të rrullëmbullakët dhe dukej se e pyeste. Po djali nuk jepte shenjë.

Tre të tjerët rrinë kokë më kokë. Gjeta pa së largu ndërtesën e bardhë të hidrocentralit. Kish dëgjuar se aty uji bëhej drithë. Po të mos shkonte atë natë, mbasë s'do ta shihte më kurrë. Do të fillonin përsëri endjet nëpër pyje.

Ai u ngrit dhe qëndroi në këmbë para plakut. Plaku ia bëri me dorë, si të donte të largonte hijen nga sytë. Gjeta u hoq mënjanë dhe i tha me zë të ulët se donte të shkonte të shihte hidrocentralin. Plaku mbeti gojëhapët. Qe hera e parrë që djali kërkonte gjë prej tij. I ndritnin sytë.

— Jo, — tha plaku. — Dëgjave, — tha plaku. — Djali nuk foli më. Qëndroi pranë tij, më armën midis gjunjëve. Plaku pinte duhaninë heshtje. — Dy sahat me shkuë, dy më ardhë, — tha ai. — Asnji dekik ma tepër! — Ai nxori sahatin me qostek dhënja zgjati.

Djali u hodhi në këmbë, bëri një hap përra para sikur donte ta përqafonte dhe vuri dorën në gjoks. Plaku i bëri shenjë të nisej. Djali u zhduk nëpër gjethë sikur e përpiu pylli.

Plaku mendohet. Ai toger Gjon Leka i kish thënë të pardjeshmët të mos kalonte në pyllin e Tharrit, po s'e kishte dëgjuar. E kish vrarë djalin më dorën e vet. Qe i vetmi mendim që i rrithë në trurin e nxehur prej tri ditësh dhe s'e linte të mendonte gjë tjetër. Ndiente

mall pér shtëpinë, po s'kishte si të kthehej pa djalin. Lodhja po e vinte poshtë si në një gjumë parkhim. Atëherë e zuri një merak i papritur pér Gjetën. Do të mendohej prapë në mbrëmje.

Çohuni! u tha plaku të tjerëve, dhe u
ngrit i pari. U nis andej nga iku Gjeta. Do ti
ruanin shpinën, se gjoksinq djali dinte ta mbronte
vetë.

Djali hodhi armën hë sup dhe eci pyllit me
háp ushtari; duke ruajtür anën e lumi. I mbë-
teshin edhe katër orë të ngrysej ajo ditë dhe
donte të jetonte çdo minutë! Ro tëlecte kështu,
do të arrinte në hidrocentral për një orë. Dë-
gjonte hapid rëvet, të kërciste në dëborë dhe
ndiente gjëzim. Pylli ishte i tij. Kështu duhej
të kish qenë edhe ajo Vajza e Hirit, që shkonte
në gësti te mbreti dhe humbi këpucën.

Në një sop iu bë se pa' qeleshen' e një njeriu.
+ Ej, 'ti! + foli' Pylli iu përgjigj me c' pësh-
përima të zgjatura.

Ej, ti... — thalaprapë djali dhe u gëzua që dëgjoi zérin e vet! Zakonisht nuk flisnin as me njëri-tjetrin. Vetëm në të rrallë ndonjë fjalë nepër dhëmbë. Deshi të këndonte, po s'i kujtohej ndonjë këngë. I kishin thënë se baba i tij këndonte me cifteli. Mbësë prandaj e kish vrarë Deda. Kish ikur menjë kushërirë që u marros pas ciftelisë së tij.

Djali u ngjit në kodër.

I pëlgente ai toger Gjon Leka. Ishte burrë. Kishte dashur t'i fliste atë ditë, t'i thoshte ta merrte me të mirë plakun. Por i dukej se kishte harruar gjuhën. Po të vinte puna të dorëzoheshin, do të shkonte në shërbim të tij. Mbësë togeri nuk do ta merrte.

Ai qëndroi një çast të shihte orën. Nuk ndiente lodhje dhe s'ngopej së pari pyllin. Nuk e kish parë kurrë si atë ditë, gjithë ato vite. Mbësë ishin orët e fundit. E mendoi këtë me qetësi, pastaj një çast u drodh i téri. Nuk donte të vdiste. Të iknin fshehur nëpër pyll, larg botës, ishte prapë një lloj vdekjeje.

Gjetë futi orën në xhep dhe eci gati me të rendur. U kthyte të shihte pas. I dukej se dikush e ndiqte. Atë ditë që qenë takuar me togerin, nuk i kish pëlqyer ajo ftyra e Zef Rrokut, nëpunësit të lokalitetit, që skuqte nën qeleshen e bardhë nga një siklet që mundohej ta fshihte.

Ai doli në majë. Roja e cte poshtë e lart në anë të digës me pushkën në sup. Uji varej i bardhë në murin e lëmuar dhe shkumëzohej poshtë, sa dukej si avull. Faqja e ndritur e liqenit rrinte pezull mbi luginë. Iu duk se ajo masë uji mund të përmbysej njëherësh dhe u tremb. Roja u kthyte dhe hyri në barakë. Atëherë djali kaloi me nxitim në urën mbi digë, pastaj qëndroi në mes të saj, me krahët hapët, me liqenin në kurriz dhe ujvarën nën këmbë. Ajri i lagësht i hyri në hundë e në gojë. Kishte etje. Nxori sahatin ta shihte dhe u habit. Koha kishte mbetur në vend. Brodhi sytë përreth dhe iu duk se majat e maleve erdhën rrotull tij. Atëherë

sokëlliu fort, me gjithë grykën, për gjithë vitet që kish ndrydhur zërin në gjoks dhe qëndroi të dëgjonte si rrökullisej 'sokëllima e tij nëpër luginë.

Një kësimë e thatë ndau digën më dysh! Ai ndjeu gjithë peshën e malit në kurriz t'i thyente kockat dhe ujin t'i rrëshqiste nën këmbë. Ra krahëhapët, me kokën në gur... Uji i likenit po rrökullisej mbi të... «Sa kish qenë ora?...» që mendimi i fundit që jingriu në kokë.

Plakur qëndroi me frymën pezull. Ishte një kësimë e vetme, e thatë, tëke, si e shtëna e një gjuëtarë. Ai priti të dëgjonte krisma të tjera, po nuk pati. Dukej se kishin mbaruar punë. Ishte një pushkë trädhtari.

Toger Gjon Leka e zuri Zef Rrokun tek përpiquejutë që shihej në një vrimë. Fytyra e nëpunësit në engjyrë të qiririt, e tejpashme, si një qull i ngrirë, që më tepër fytyra e një të avdekuri se është një të gjallë. Në rrudhat e imta, rrreth kapakëve të syve, që vulosur ai gëzimi i lig, që kish provuar aty, më parë. Një vijë djerse e verdhë, si gjurma e një kërmilli, i rrëshqiti anës veshit.

Togerit iu ngrit stomaku, në fyt. — Ma hiqni sysh qenin, — i tha zëvendësit, — qojeni poshtë. — Ai u ul dhe priti. — Dedë Gjon Nikolla me nipi dha dy djemtë

e varrosën Gjetën buzë liqenit. Ashtu deshi plaku. Gjysmë ore më pas ata erdhën ia dorëzuan armët toger Gjon Lekës, pastaj u nisën ngadalë anës lumit. Në të ngrysur duhej të hynin në Burrel.

卷之三

and the first in the world. It has been
the most successful and the most
widely used of all the methods of
teaching English as a second language.
It is based on the principle that
language is learned best through
immersion in a language environment.
The teacher's role is to provide
the necessary support and guidance
to help the students learn the
language naturally and effectively.
This method has been used in many
countries around the world, and it has
been found to be very effective in
teaching English as a second language.

and the author of the book, and the title of the book.
J.M.C.

U D H E K R Y Q I

Jona mblodhi rrobat shuk në çantë dhe u nis ngadalë në rrugën me pluhur të kantierit. Ishte koha e pushimit të drekës dhe rrotull nuk shihej njeri. Në atë orë të ditës gjithmonë e pushtonte vëtmia... Koha shtrihej rrëth saj dhe hapësira ndrydhej sa i mbante frymën. Filloi të numëronte hapat duke ndjekur hijen e saj. I dukej tërë kohën sikur i mungonte diçka.

Tutje, në mes të rrugës, gazi i vogël i drejtorisë vinte rrotull vetes duke u munduar të kthehej dhe ngrinte pluhur si një dem i verbër. Shkonte me rrotat e pasme deri në buzë të kanalit, sa të ngrinte gjakun, pastaj i turrej krahut tjetër të rrugës. Në fund ai qëndroi si të që shuar një herë e mirë.

Jona nxitoi. Mbase e çonin deri në stacionin e trenit.

— Hajde, Jona, do vish në Tiranë!?

Në ndenjësen e parë rrinte kryeinxhinieri, Agroni, dhe e vështronë vajzën ngultas, sikur kishte kohë që e priste. Jona u habit. Ai nuk

prioste kurrë njeri, ikte ose vinte gjithnjë përparrë.

— Po, — tha vajza. Nuk do ta kuptonte kurrë se ç'mendonte ai njeri.

Ai zbriti t'i lironte vendin. Në ndenjësen e pasme ishte një burrë që s'ënnihi, me buzët e holla aq të shtrënguara, sa dukej sikur i kishte humbur dhëmbët e parë.

Jona përshëndeti lehtë me kokë, u ngjit dhe tërhoqi derën.

— Tani do të na shkojë rruga vaj, — tha shoferi, duke fërkuar duart.

Makina u shkund një copë herë pa lëvizur vendit. Shoferi doli ta ndizte me manivelë, pastaj kërceu në kabinë dhe, kur doli të mbyllte kapakun, motori iu shua prapë. Më në fund makina kërceu përpjetë një herë dhe u nis me shpejtësi, sa dukej se s'do të ndalonte më, vetëm po të shkërmohet e tëra.

— E sheh, raketë është fare! Përdy orë e kap Tiranën.

Vajza rrinte drejt, duke u mbajtur fort me të dyja duart, aq pa lëvizur, si të ishte prej guri dhe dukej sikur do të rrökullisej në çdo kthesë.

Shoferit s'i pushonte goja. Kthehej nga Jona dhe i qështe duke zbuluar ca dhëmbë të zverdhur nga duhani, tregonte qyfye dhë i jepte makinës pa duar. Dukej se vajzës s'i bënte përshtypje asgjë.

— Avash, mor djalë, — tha ai me buzët e qepura, — s'kemi ndër mend të vdesim sot.

— Ashtu është. Nuk e kemi në plan vdekjen tanë. Kemi punë të tjera. Mos ki frikë, xhaxha.

Kjo makinë është llogaritur kundër përbysjes.

Ai u kthyesh nga vajza:

— Ke frikë, inxhiniere?

Jona qeshi me pahir. I rrinte në sy ai burri i panjohur. Pamja e tij i kishte sjellë një shqetësim të pakuptuar, si diçka që lëviz në mje-gullën e trurit. Shoferi i dha gazit më shumë. Një fshatar me biçikletë u hodh në kanalin e rrugës. Shoferi qeshi me zë të lartë dhe bëri një lëvizje të papritur të shtypte një pulë që kaloi rrugën e trembur.

— E zura, — tha, — po s'e marr dot.

— Ik, se na fute në sherr, or shejtan, — tha Agroni.

Një grua, pas gardhit, bërtiste duke kërcënuar me dorë.

— Deri nesër do t'ia qajë puplat, — tha shoferi.

Në të përpjetë makina mezi ngjitej. Bënte më shumë zhurmë dhe dukej sikur do të rrëshqiste mbrapsht. Jona lëshoi trupin në ndenjëse dhe iu duk vetja e rëndë. Në xhamin e përparmë dukej qielli i ndritur, gati i bardhë. Ish-te një dritë që i shkaktonte dhimbje në sy, një dritë e pafund, pa imazhe, pa figura. Ajo mbylli sytë dhe provoi të luante si në vogëli, duke kérkuar në errësirë (që nuk ishte kurrë errësirë) lëvizjen e ngjyrave. Qëndroi ashtu, me sytë mbyllur, si një njeri që baret në kufirin midis gjumit dhe realitetit dhe ndjeu njëherësh lodhjen dhe mundimin e atyre ditëve. Donte të kthehej të shihte Agronin. Kishte kérkuar më kot një shenjë në vështrimin e tij. Asgjë. Ajo

e ndjeu gjoksin bosh si tē kish lëshuar një thirrje pa zë. Askush deri atëherë s'kishte pasur fuqi t'ia pushtonte mendjen dhe shpirtin deri aty, sa tē humbiste gjykimin, si ky njeri. Tani ato simpatitë e saj tē shkollës ishin ca kujtime tē vakëta.

Ajo hapi dritaren dhe u kthyte anash. Era e benzinës po i ngrinte tē vjellat.

— Do tē ndalojmë, Jona? — Agroni e preku lehtë me gishtérinj në sup. Vajza ndjeu fryshtë e tij tē nxehjtë në zverk dhe u drodh.

— Ah, po.po, si tē doni.

— Mbaje lart, te çezma, — tha burri me buzët e qepura. — Të freskohemi pak.

Jona u kthyte përgjysmë. Ku e kishte parë atë njeri?

— Atje do ta mbaj, — tha shoferi. — Kjo makinë s'i ka zënë kurrë gratë. Vetëm burrat.

Dy burrat pinë ujë në çezmë dhe ndezën cigaret. Shoferi qe shtrirë me kurriz përtokë në bark tē makinës dhe vërvshëllente.

Jona vështroi rrugën larg. Asfalti i nxehjtë avullonte vlagën e ditës dhe dukej sikur fryhej para saj. Ajo u ul në gurin e kilometrazhit dhe ndjeu erën e freskët që ngrihej nga lugina, duke fërshëlyer lehtë nëpër thepa, me ca zëra tē largët që vinin e holloheshin sa këputeshin. U zgjat tē dëgjonte dhe iu duk se njerëzit ishin në krahun tjetër tē botës. Poshtë rridhete lumi, i hollë, si një gjurmë e gjallë, e ndritur, duke hapur rrugën pa zhurmë midis gurëve tē bardhë. Faqja e zhveshur e malit i kthente dritën kupës së qillit. Ca xhufka tē errëta pylli dukeshin si tē qethura me gërvshërë dhish.

— Jona u ngrit dhe u afroa tek ata.

— Ku punon? — pyeti burri me buzët e qepura. dhe vështroi rrötull sikur nuk priste përgjigje. Pinte duhan duke e nxjerrë tymin si pufkë rrötull pipës.

I ngjeshur, me shpatulla të gjera e këmbë të shkurtra, të kujtonte një lojtar në fushën e shahut. Po kishte çuditërisht një fytyrë të mprehtë, me hundën më samar. Rinte ulur, me thonjtë të ngulur mbi gjunjë dhe kthente kokën me lëvizje të prera, si një shpend në përgjim. Dukej nervoz.

— Po të jesh më mirë, nisemi, — tha Agroni.

— Po, po. — Vajza u ngjit e para në ndenjëse dhë iu përzie prapë.

Agroni shihte shpatullat e rrumbullakëta të vajzës me lugun e thelluar të kurrizit në mes dhe nyjën e bukur të qafës me flokët, të mbledhur në zverk. Kishte njëfarë butësie në të gjitha kurbat e trupit të saj. Qafa e gjatë i qe holuar sa mund ta përmblidhje me dy gishtérinj. I erdhë keq. Dy muajt e fundit kishin qenë të rëndë përtë.

Makina zbriste me shpejtësi. Shoferi u kthyen nga Jona.

— E, mori veten, e sheh? — tha ai.

— Të shohim kur të ngjitet përpjetë, — tha burri me buzët e qepura.

— Atë të metë e ka, s'e mohoj, i mbahet pak fryma në të përpjetë.

Ata shkonin drejt perëndimit dhe dukej sikur i afroheshin diellit të kuq, që sa vinte e rritej. Një re e bardhë merrte forma të habitshme me një lëvizje gati të pakapshme, pastaj u bë ngjyrë trëndafili. Agroni ndoqi lojën e resë. Silueta e vajzës, që i rrinte në sy si njollë e errët, iu duk e largët sikur diçka po 'e rrëmbente. Ai u trondit.

— Do qëndrojmë pesë minuta tek ai fshati buzë rrugës, se kam një porosi për një mik, si thua, inxhinier? — Shoferi që kthyer i téri dhe kishte lëshuar timonin.

— Ndalo ku të duash, — vetëm shih përpara, — tha Agroni.

Në të hyrë të fshatit ishte një pus i mbuluar përgjysmë me një kapak druri. Burri me buzet e qepura deshi të pinte ujë prapë. Hodhi kovën brenda dhe u mundua ta mbushte, po litari i përdridhej në duar dhe kova vinte rrötull mbi ujë pa u përmbysur.

— Nëma mua, — tha një vajzë e vogël duke hequr nga supi enën prej balte. Fliste dhe nuk i ngrinte sytë. Ishte nja dhjetë vjeçë, e imët, me kokën e vogël si zog. Një gërshet i rëndë ngjyrë mjalti i binte përgjatë kurrizit deri në bel. Ajo u var në grykën e pusit, drodhi litarin rrëth grushtit të vogël dhe e përmbysi kovën me një lëvizje të shkathët. Gulçimi i dobët i vajzës kthehej lart si një frymëmarrje e asaj gryke të tokës.

— Do pish ujë? — tha pa vështruar njeri. I dridhej kova në duar.

— Si tē quajnë? — e pyeti Jona.

— Myrvete.

— Emrin e gjyshes tē kanë vënë?

— Ajo ngriti supet.

— Jo. Gjyshen e quanin Tete. — Nxítonte tē mbushte ujë e tē ikte. Nuk kishte qejf ta pyesnin.

— Ku e ke shtëpinë?

Vajza tregoi me gisht një shtëpi tē vetmuar në kodrën matanë lomit. Një shtëpi e vogël, me çatinë tē kuqe aq tē madhe, sa dukej si kërpudhë. Jona e kishte parë shumë herë atë shtëpi, tē shtunave e tē hënave. Shpesh një grua pastronte xhamat në dritaret e rrëthuara me kornizë tē bardhë dhe dukej si një figurë që po zbrishte nga një kuadër.

— Nëna jote është ajo që pastron xhamat tē shtunave?

— Po. Nëna.

— Pse kishte aq shumë njerëz te ju dy javë më parë?

Vajza e pa poshtë vetullave dhe uli sytë. Dukej që nuk do t'i tregonë gjërat e shtëpisë së sasaj. Bëri një lëvizje tē kokës si për tē hedhur gërshetin pas dhe ngriti shtambën e ujit.

U largua me enën mbi sup. Kishte marrë tē ecurën e grave tē fshatit, me bustin drejt, dhe tundej lehtë nga mesi e poshtë, sikur shkarkonte peshën e trupit duke lënë dëgka në çdo hap. Gërsheti i përdridhej në kurriz si i gjallë. Pasarela e ngushtë mbi lumë tundej si djep, po vajza shkonte pa u mbajtur gjékundi. Të ngrinte gjakun ai fëmijë i varur mbi lumë që luannte me erën.

Jona u kthye te makina. Shoferi po zbriste me dy trasta.

— Kush kërkon, s'mbëtet pa gjë, — tha ai.
— Është fjalë e urtë popullore.

— Dhë aq e urtë jo, — foli Agroni i nxehur. — Ec e mos e kthe më kokën gjékundi, more vesh?

Shoferi nuk foli më. Makina po merrte përpjetë.

Jona mbështeti kokën në ndenjëse dhe mati me mend rrugën që kishin bërë. Nuk dönte të mbaronte ai udhëtim. Ajo dridhej lehtë në shpatulla sikuri frynte erë në kurriz. Deshi të kthehej të shihte Agronin dhe ndjeu një mall të papritur që po i merrte frymën. Dëgjonte me habi e turp atë goditjen e fortë që i vinte nga thëllësia e gjoksit dhe ndjeu se po skuqeji. Mbase e dëgjoni edhe të tjerët. Si atë ditën e parë në kantier...

.. Ky është kryeinxhinieri, Agroni... e kishte paraqitur drejtori. Agroni i kishte zgjatur dorën pa i buzëqeshur.

— Mirë se erdhët, — tha duke vështruar diçka përtetj saj, më sytë e mprehtë, bojë qielli, që i ndritnin në hien e strehës së kapeles. Ishte i zeshkët, me një lëkurë ngjyrë ebaniti, si një njeri që ka jetuar fushave, me flokët të verdhë.

— Jona është ajo inxhinierja që do të punojet te ne, — tha prapë drejtori. — Tregojti se ç'duhet të bëjë.

Agroni e vështroi ftohtë.

— Shumë mirë, — tha ai, — le të njihet pak më kantierin. Më mirë do bisedojmë në zyre. Ja çelësin.

Ai qe larguar me këmbët gjithë muskuj që i dukeshin nën pantallonat kadife të rrjepura. Ishte me trup mesatar, po dukej i gjatë, mbasse ngaqë ekte me hapa të mëdhenj.

Jona kishte pritur gjithë atë ditë. Të nesërmen qe sjellë nëpër objektet e kantierit duke shtrënguar çelësin në grusht dhe nuk guxon te të pyeste, me shpresën se do të shihte diku kapelen blu me strehë dhe këmishën bezhë me kopsa të zeza. Ai i kishte lënë çelësin e zyrës, mbasse si një shenjë miqësie. Nga dreka, në mënsë, drëjtori e kishte pyetur së largu si i shkonin punët dhe ajo kishte tundur kokën «mirë». Ditën tjetër Jona kaloi para zyrave të kantierit dhe pa derën e dhomës së tij të hapur kanat. Kish mbajtur çelësat e një dere të hapur. E ndjeu veten të fyter, deshi të ikte me vrap, por u kthye dhe e cili vendosur drejt zyrës së tij. Ai rrinte në krye, te tryeza, pa lëvizur, me sytë të ulur mbi dosje. Mund ta merrje për një të fjetur po të mos i shihje dorën që i bridhët me nxitim mbi letër. Jona i pa hijen e errët rrëth mjekrës dhe buzët e zbardhura, si të një njeriu që ka humbur gjumin. Ndjeu t'i lëngëzohej diçka në gjoks, po poshtërimi që provoi aty më parë s'e linte të mendohëj. Aja hyri ngadalë, lëshoi çelësin mbi tryezë, pastaj u largua që të mos i linte kohë të fliste. Ai nuk e kishte thirrur. Dy ditët e shkuara Jona kishte vuajtur sikur mbante mbi kurri zjarr peshë. Tani që liruar parpritur dhe vuante njësoj.

Agroni e kishte thirrur pasdreke për t'i thënë se kishin pasur një avari të rëndë dhe ende nuk dinte si do të mbyllej. Kaq për të kërkuar

ndjesë për ato dy ditë. Pastaj ai i kish treguar objektin, duke ia shpjeguar në detaje. Asnjë buzëqeshje, asnjë fjalë e tepërt. Më mirë që ai s'ë ngrinte kokën, vajza mund t'ia shkrepë të qarit.

— Po të kesh nevojë për ndonjë gjë, më thuaj. Për çdo gjë. — Kishte folur me atë tonin e parë, njësoj si të kish thënë «Mos më thuaj për asgjë».

Jona kishte ikur pa e përshëndetur. Zbrazëtira rrëth saj hapej dhe nuk i vinte më as përtë qarë! Ishte mësuar t'i shihte njerëzit rrëth saj të gëzoheshin kur e shihnin. «Mendoje një herë me atë kokën tënde të zgjuar... i thoshte gjithnjë i ati, ... ti nuk je si të tjerat...»

Një javë më pas Agroni u largua nga kanti. Thanë se kishte shkuar me pushime. Jona e priste duke kërkuar me sy në çdo qoshe, duke u shtirur mospërfillëse, duke u turpëruar nga vetja. Kjo pritje po zgjatej tej durimit. Ditët e para i qenë dukur pa fund, pastaj kalonin duke ndjekur njëra-tjetrën shpejt. Shpresë e së nesërmes ia bënte pritjen të ëmbël. Ai qe kthyer më në fund, pas dy javësh, dhe më orën shtatë të mëngjesit e kishte kërkuar.

Jona e pa së largu tek priste kokulur në buzë të kanalit, me kapelen mbi sy e duart në mes. Pranë tij rrinte në bisht brigadieri, sikur do të hidhej kokëposhtë në kanal dhe nja tre punëtorë të brigadës së hidraulikëve.

Ajor u afroa dhe qëndroi duke parë e tronditur kanalin, të mbushur përgjysmë me ujë të turbullt ngjyrë dheu. Një shkumë e verdhë si lëtyrë lëpihej në anët. Të djeshtmen brigada e

saç kishte gërmuar kanalin, duke hequr ujin me pompe téré kohën. Pasdite hidraulikët do të shtronin tubat.

— E ke parë si është katranosur këtu? — Agroni foli pa i hequr sytë nga kanali, me nofullat shtrënguár. — Pëmpa prishet, elektricisti nuk gjendet dhe brigada rri pa punë.

Vajza nuk u përgjigj. Deshi që ai të ngrinte sytë ta shihe. Ai lëvizi duart me nervozizëm, ca duar téré kocka e nyja me damarë blu, që dukej se i fryheshin kur zemërohej. I shtrëngët me njera-tjétrën duke hapur e mbyllur grushtet, sa iu zbardhën, sikur shitypte në to inatin që i vlonë brenda.

— Pse nuk flisni? — Ai ktheu kokën me shpejtësi. Flökët pas zverkut i rrinë përpjetë.

Jona ngriti fytyrën dhe uli kapakët e syve përgjysmë. Nuk do të pajtohej kurrë më atë njeri.

Agroni e vështronët me fytyrën e rrudhur, sikur gëlltiste parështur diçka të hidhur.

— Sot tubat duhej të ishin të shtruari. S'e merr vesh sâ punë na ke prishur? — tha ai.

— Deri në orën tre pëmpa ka qenë në rregull. Kanali ishte i thatë, — tha Jona.

— Po pastaj, pas orës tre, ku shët përgjigjet?

— Unë jó. Mbase përgjigjeni ju nga ord tre e mbrapa. — Ajo shihtë brigadierin që s'kishte lëvizur vendit.

Kryeinxhinierit iu drodh trupi dhe foli duke i nxjerrë fjalët midis dhëmbëvë si fërshëllimë.

— Ti, shoqja inxhiniere, bën mirë të ikësh në shtëpi... — Ai dëshi të fliste prapë, po vështroi anash dhe u ul në bisht.

— Azbi, vishu çizmet punëtorëve të pastrojnë gropën dhe vini pompat! — i foli hidraulikut.

Jona vazhdoi, ta mbante fytyrën lart, por jo nga krenaria, donte të mbante lotët. Piste që ai të fliste prapë, po dukej që e harroi krejt. Rrinte në bisht, në buzë të kanalit, dhe jepte udhëzime. Punëtorët nxitonin. Vetëm Burhani, brigadieri, fuste ngadalë pantallonat në çizme, duke i shtrirë me pëllëmbë dhe e shihte Jonën pa ia ndarë systë. Po vajza shihte turbull. Nuk kuptonte nëse ai i thoshte mirë apo keq.

U kthye të ikte pa folur, duke kafshuar bulçitë, po nuk i mbajti döt lotët. Era e asfaltit të posashtruar i zuri frymën. I fundoseshin këmbët në rrugën e butë. Tha me vete se nuk do të kthehet më në punë, do të ikte në shtëpi, pastaj hyri në zyrën e saj dhe qau gjatë, po nuk e shkarkoi dot dhimbjen. I vinte keq për veten.

U bë e heshtur dhe rrinte në kantier deri nattën duke punuar. Kur kalonte para Agronit, shtirej e qetë e mospërfillëse, po nuk i ndalonte dot rrahjet e zemrës dhe ndiente që skuqej.

Ai i fliste qetë, pothuaj rëndë, siç bënte me të gjithë, pa asnjë shenjë miqësie. Vajza ndiente fyérjen t'i depërtonte gjithnjë më thellë dhe prapë e çonin këmbët aty ku mund të ishte ai. Nuk po e kuptonte më veten. Ngutej të bënte atë që s'do ta kishte bërë kurrë më parë, kërkonte me ngulm një mënyrë që ta kthente Agronin nga vetja,

qoftë edhe duke u poshtëruar. Donte t'i shkaktonte dhimbje vetes pér dobësinë e saj dhe ndiente se po hqyte gjithnjë më thellë, si në një batë. Endiqte më kokëförtësi, i kalonte pranë pa e ngritur kokën ose e shihte gjatë duke u shtirur sikur s'e kishte mendjen. Do të vinte koha që ai do të kthehet, atëherë Jona do të merrite hak.

Burri me hundën si zog pinte duhan pa pu-shim. Fliste rrallë, pér të ngacmuar shoferin ose pér të treguar pér veten, Quhej Arif. Kishte tre fëmijë, të shkëlqyer, vetë punonte në një kantier sharrash dhe mbante me rrogën e tij vjehrrën pa pension. Ai i kishte thënë këto duke lëshuar nga një fjalë në çdo të latëpjetë e duke heshtur në të përpjetë.

— Do të na jepni dërrasë pishe pér rezervaret? — tha Agroni.

— Pishë nuk kemi. Do ta shikosh vetë. Vetëm ah. Jona ishte e sigurt se njihte atë burrë. E kishte parë nëndonjë gazetë ose në rrugë. Kjo gjë po e mundonte sikur të kishte shumë rëndësi pér të. Kishte dicë prej druri, në tërë qënien e tij.

... Ishte mbasë 4-5 vjeç... Mysafiri rrinte në kolltuk dhe nxirrte tym me një llullë të gjatë, të madhë. Nxirrte shumë tym dhe i bënte rrathë në tavan që të qeshte vajza. Ajo i qe ulur në prehër dhe e vështronë drejt në sy. Mbante mend se të mëdhenjtë kishin qeshur, pse qeshnin ata? E di si

e ke emrin ti, xhaxhi? Ti e ke emrin... Nuk i kujtohej se ç'emér kish thënë, vetëm se të mëdhenjtë nuk kishin qeshur më, nëna kish thënë uah! dhe mysafiri kishte thënë se vajza do të bëhej... Nuk mbante mend ç'kish thënë mysafiri, po me siguri nuk qe bërë si kish thënë ai.)

Jona u kthyte të shihte Arifin. Nuk ishte mysafiri. Ai i qe dukur mik. Arifi e shihte ftohtë, ose s'e shihte fare me sytë rrumbullakë prej shpendi, që dukej se s'i qëndronin gjékundi.

— Sido që të jetë, do të më gjesh pak dërrasë pishe, vetëm për rezervuaret, — tha prapë Agroni.

— Kur s'kam, ç'të të jap?

— Do ta gjejë se s'bën, — tha shoferi, — ndryshe e zbrita këtu në majë të malit.

— Do kthehemë këtu te sharrat, të lëmë këtë shokun e të shohim pak lëndën, — i tha Agroni Jonës. — Nuk vonohemi.

Ata u kthyen në një rrugë të ngushtë, që ngjitej me mundim në faqen e kodrës, humbiste nëpër pyll dhe dilte prapë më tutje, si një e prerë e hollë me majën, e thikës.

Në një çeltinë ishin ngritur barakat e punëtorëve të sharrave, të ndërtuara me anje, që dukeshin të ulëta sikur në to mund të rrije vetëm ndenjur. Drutë e sharruara qenë vënë në stivë aq të rregullt, sa pandehje se s'do të prisheshin më. Toka ishte gjithë trungje të prera. Bari i imët kishte mbirë edhe nëpër zgavrat e trungjeve, një bar jeshil, i errët, i ndritshëm si i njomur e i ftohtë. Jona preku me dorë myshkun në një lëvore. Ishte i ngrohtë e i butë. Ajo vështroi me vëmendje rrathët e trungjeve që ngush-

toheshin në një krah. U kthye andej nga duhej tē qe veriu dhe ndjeu fresk. Edhe drurët i tku-rreshin kësaj ane tē qjellit. Agroni kishtë hyrë në pyll pas Arifit. Afër derës së barakës, mbi një stufë tē sajuar me tulla, një burrë po gatuante ashtu siç dinë tē gatuajnë burrat, duke trazuar kazanin me një luhare druri në krahun e kundërt tē grave. Burri vinte rrotull edhe vëtë sikur voziste.

— Uluni, — tha ai dhe tregoi me dorë një stol druri që duhej ta kishin për mysafirë. Dukej sikur i priste.

— Unë jam kuzhinieri i sharrave. Dikur kam qenë kuzhinier në hotel «Dajti». Di tē gatuaj edhe për francezë. — Ai qeshi. Fliste me hundë, sikur tē ishte me rrufë dhe thoshte «b» në vend të «m»-së.

Jona ndiente prehje. Era e mishit tē zier e bënte tē gjelltitej. Nuk kishte ngrënë gjithë ditën. Kuzhinieri e shihte.

— Do tē hani gjë? — tha ai.

— Po tē kesh, — tha shoferi.

Kuzhinieri solli dy pjata alumini dhe hodhi në to mish.

— Hani, éshtë mish i butë, i zier me avash.

— Ai i vështronëtë në sy, gëzohej që hanin dhe vërvhellente tërë kohën pa marrë frysë, sikur që kaçup.

— Éshtë i mirë mishi? — Kërkonte përgjigje sikur e kishte bërë mishin vetë. Pastaj nxori nga prushi misra tē pjekur dhe i vuri në lepushka.

— Falemnderit, — tha shoferi, — na kënaqe!

Jona hëngri duke djegur duart. Afronte fy-

tyrën te zjarri, po në kurriz ndiente erën e freskët që ngrihej nga lugina. Përgjoi zërin e Agronit që përhapej në pyll. Ai fliste gjithnjë me zë të lartë.

«Ti duhet të ma japësh si pas kontratës...»

«I kam për pallatin e madh, s'mund ta lë pallatin, është dru i staxhionuar, s'të fal njeri.» Zëri i Arifit vinte i mprehtë.

Ata dolën pas drurëve dhe qëndruan në kufirin e çeltinës.

— Mirë, o vëlla, do piqemi prapë. — Agroni eci me hapa të mëdha pa i dhënë as dorën.

Arifi nuk lëvizi vendit. Vuri këmbën mbi një dru të rrëzuar dhe mbështeti bërrylin mbi gju, duke vështruar poshtë në tokë, duke i buzëqeshur diçkaje nën këmbët e tij. Pastaj u kthyte e hyri në pyll.

— Ikim, — tha Agroni dhe u hodh në makinë.

Jonës i mbetën në sy ato dy vijat e thella, si të prera me brisk, në anët e hundës, të ngritura me përcimim si presje. E kishte parë atë buzëqeshje edhe herë tjetër...

... *Kur ishte e vogël, priste me gëzim druvarin që vinte t'u sharronte drutë, me opingat prej gome të lidhura me spango, me majat e kthyera lart. «Kush ka dru me pre!» Ajo ulej në një stol të vogël druri dhe shihte si mbidhej mielli i sharrës nën opingat e tij. Pse nuk e merrnin miellin ta bënин petulla? Ai bënte hëhh, hëhh, sa herë i conte krahët poshtë dhe vajzës i dukej sikur ai zë dilte nga druri. Mbase ishin drutë e Pinokut. Burri nuk e kthente kokën ta shihte, nuk shihte gjë tjetër veç sharrës së tij.*

Ishte gjithnjë po ai burrë, me hundën si sqep zogu. Nuk fliste fare, vetëm punonte dhe hante çdo gjë që i jepte nëna dhe nuk gëzohej kur e shihte vajzën, siç bënин njerëzit e tjerë rrotull saj. Tani e kuptonte pse rrinte me orë të tëra pas «drumepresë». Ai nuk e përkëdhelte kurrrë.

Një ditë ai po i binte një trungu të madh me sëpatë. Hëhh, hëhh, hëhh. Jona u mërzit së ndenjuri dhe thirri «ej», pastaj u hodh mbi një këmbë, pastaj këndoi, po druvari i binte trungut sikur fëmija të mos qe aty. Atëherë vajzë ulériu fort dhe ai u kthye e i ra këmbës së tij me sëpatë. I shpërtheu gjaku. Ai u mundua ta ndalonte me duar, pastaj eci çalë drejt kuzhinës ku gatuante nëna dhe kërkoi pak ujë. Nëna i dha ujë duke iu dridhur duart dhe ai piu pak, vuri dorën mbi zemër dhe tha «falemnerës». Nëna vrapoi të gjente fasho dhe duhan, kurse babai qe hedhur të largonte vajzën që qante e trembur. Burri i kish parë një çast të vetëm duke zvogëluar sytë dhe në të dy anët e hundës i ishin bërrë dy vija të thella. Pastaj kishte ulur kokën dhe kishte qëndruar me sytë ngulur në dhë. Jona nuk i harronte ato dy vijat e thella, të ngritura në anë të hundës...

I kish parë edhe pak më parë në fytyrën e Arifit, kur përgjonte Agronin tek largohej me hapa të mëdhenj. Por ai vështrim i rrudhur nuk kishte qenë për Agronin, kishte qenë për të. Jona ishte e sigurt tani, ai e kishte vështruar në çastin e fundit me përcëmim, me armiqësi, si atë ditë, para njëzet vjetësh. Pse e përcmonin njerëzit?

Makina nuk e ngjiti dot tē përpjetën e fundit. U shtrëngua duke kërkëllitur në tē gjitha te neqetë dhe pushoi njëherësh. Shoferi zbriti, përshtyu rrotat dhe hyri nën tē.

— Ka rrezik që sonte tē flemë te ndonjë fshatar, — tha ai dhe deshi tē queshte.

— Edhe ajo mund tē ngjasë, — tha Agroni, po nesër tē mos kthehesh më në kantier. Ë ke bërë makinën si qerre.

Frynte erë, po një re ngjyrë plumbi rrinte varur mbi luginë, e ngurtë, me një formë tē lëmuar, e rëndë si një anije. Qielli ishte i kthjellët, me një kaltërsi që tē sillte lotët në sy. Reja në luginë po zgjatej me një lëvizje gati tē padukshme, duke pështjellë nën vete lumin.

Agroni iu afrua vajzës.

— Mbase dō tē vonohemi shumë këtu.

— S'ka gjë, — tha Jona. Nuk mund t'i thoshte se ajo donte tē vonoheshin këtu.

— Mund tē gjejmë ndonjë makinë tē shkosh ti. — Ai ktheu kokën anash dhe foli ashtu siç

nuk e kish zakon, me tē përshpëritur me vete:

— Apo më mirë tē mos vijë.

Ajo vështroi poshtë e turbulluar, mbase s'kish dëgjuar mirë.

— Shkojmë poshtë, te Kafja e Xhafës, — tha ai me zë tē lartë, sikur tē mos kish folur një çast më parë. — Duhet tē jetë nja një orë prej këtej.

Agroni u nis përpara dhe mundohej tē ecte ngadalë, që tē priste vajzën. Shkuani një copë herë pa folur.

— Do kthehesh nesër? — pyeti ai ngadalë.
— Po.

— Të shtunën në mëngjes do vij të kontrolloj hekurat e trarëve të objektit 31. Do t'i shohim bashkë.

Ajo deshi t'i thoshte se i kishte kontrolluar, po nuk foli. Nuk mund të ishte më e sigurt për asgjë, pas asaj që kishte ndodhur nga e hëna tek e enjtja.

Jona qëndronte në zyrën e saj dhe vështron-te nga dritarja pa mundur të bënte asgjë. E hë-na qe një ditë e mërzitshme dhe i flihej tërë kohën. Pë ditét e tjera e rrëmbente puna dhe nuk kishte kohë të mërzitej. Ajo vështron-te kalendarin e vogël nën xhamin e tryezës dhe numëroi muajt deri në gusht. Në gusht mbushte vitin në kantier dhe ndiente që diçka kishte ndryshuar tek ajo. U ngrit të shihte veten në pasqyrën e vogël të varur në mur dhe ndjeu kënaqësi duke kërkuar diçka tjetër pas asaj ninëzës së bardhë, veten e saj. Një herë, kur kish shkuar në floktore, qe ulur në një kolltuk të priste. Përbalë saj qe një pasqyrë e madhe dhe në kurriz një tjetër. Ajo kishte parë veten të pasqyruar disa herë njëra pas tjetrës dhe kishte filluar të luante me vajzën e dytë, të tretën, të katërtën, derisa nuk arrinte t'ia shquante më tiparet. Do ta zbulonte ndonjëherë veten e saj? Pamja i mje-gullohej si në vajzën e pestë dhe ajo kthehej në anën tjetër.

Tani qëndronte para asaj pasqyre të gërvish-tur dhe nuk kërkonte të shihte gjë tjetër veç asaj vajzës me sy të ndritur e lëkurë të nxirë që bu-

zëqeshte lehtë. Në cepat e syve kishte ca rrudha të vogla dhe ajo u gëzua. Kishte rrudha në sy, si të nënës.

Zbriti në rrugën që të çonte te magazina e re. Atë ditë duhej të fillonin soletën e katit të dytë. U hodh në hekurudhë dhe zuri të numëronte shinat. Po të betononin sot soletën e katit të dytë, për një javë ngrinin të tretën dhe atë muaj do ta shihte objektin në këmbë. Do ta lavdëronin në drejtori dhe mbasë Agroni do të mësohej t'i fliste ndryshe.

Shinat hapeshin e mylleshin më tej si gërshtë. Ajo kapërceu tombinon dhe qëndroi në krye të shkallëve që zbritnin në rrugë. Poshtë, dy punëtorë rendnin njëri pas tjetrit në pikë të vrapit. Bërtiten diçka që s'u mor vesh, pastaj njëri ndaloj dhe u kthye mbrapsht pa qëndruar, si të kishte harruar diçka. Nga magazina e re dolën me nxitim dy punëtorë, që mbanin një tezgë, me trupin e përkulur nga pesha. Jonës iu duk sikur njohu mbi tezgë Adrin, punëtorin e vogël, që rrinte gjithnjë pas topografit. Pas tyre dolën katër veta, që mbanin Pandin e shëndoshë e të thinjur, korçarin. Iu duk sikur pa njolla gjaku në këmishën e tij.

Deshi të mbahej diku dhe hodhi hapin drejt shkallës në zbrazëtirë. U rrrokullis deri në fund, po nuk ndjeu dhimbje, vetëm në thellësi të veshit iu duk sikur i rridhte diçka si ujë i ngrohtë. U ngrit të shihte rrotull, po nuk dalloj asgjë. Bota qe zbrazur dhe ajo hapi gojën si e shurdhër. Në kapanonin e ri qe bërë hataja. Eci kuturu në drejtim të tij duke rrotulluar kokën. I bëhej se dëgjonte rënkime në çdo krah. U mundua të

ecte shpejt, duke u përpjekur nëpër gurë, me gjunjët që i dridheshin. Një burrë po vinte drejt saj duke gulçuar. Ishte Selmani, «shqarthi». Atëqëndroi dhe e shikoi rrëshqitas.

— Kush është vrarë? — foli Jona, po nuk dëgjoi të dilte zë. Mbësë që shurdhuar krejt. Dëgjoi vetëm zërin e burrit, të hollë, si zë gruaje, të mprehtë, që i hyri drejt në kokë si fërshëllimë!

— Ehu, janë vrarë shumë! — dhe rrotulloi dorën dy-tri herë në ajër.

— Ka vdekur njeri?

— Jo, — tha ai dhe e pa me djallëzi, — deri tanj, jo, por edhe mund, të vdesë. — Ai u kthye në brinjën tjetër si të donte t'i priste rrugën vajzës, se kishte akoma për të folur.

— Ra soleta, ajo e volga e ndërkatit, që betonuam atë ditë... që ishte edhe ti...

Së Jona, u lëkund përpara sikun e goditi njeri pas kokës. Mbësë ai Selmani kishte ardhur me një frymë t'i thoshte vetëm këtë. Ishte gjithnjë i pari që jepte lajmet, ngarkonte e shkarkonte gojën me sytë e kuq sikur i kishte kapakët të përveshur.

Jona i kaloi përpara pa i folur dhe nxitoi e lehtësuar. Tani i dukej se mund të shpëtonte dicëka. Nuk kishte vdekur njeri. Përballë saj vinte, duke tërhequr këmbën zvarrë, Astriti, një punëtor i ri, që qe martuar javën e shkuar dhe kishte fituar në dasmë gjithë kantierin. Ai pa Jonën, dhe qëndroi ta priste. Ishte i zbehtë dhe mezi mbahej në një këmbë.

— Je vrarë shumë? — pyeti Jona.

— Jo, pak fare, unë pak fare. Vetëm Bur-

hani është vrarë shumë. Të tjerët janë lehtë; si unë. — Ai e shihte me keqardhje. —Dëgjo, mos u tremb, vetëm se na shkoi puna kot, po s'ka gjë, edhe Burhani do shpëtojë, mos u tremb... Ai fliste pa pushim dhe kishte harruar dhimbjen e tij duke menduar dhimbjen e vajzës. U kthye çalë dhe eci në krah të saj.

— Si ndodhi, Astrit?

— Si të them, soleta u këput në mes, s'di dhe unë pse, mbasë i hoqëm skelat shpejt. Vëtëm Burhani ishte poshtë, ne qemë lart, te muri. Edhe Burhani shpëtoi mirë, se nienë fuçitë e ujit poshtë; është vrarë në shpatull, po koka i shpëtoi... mos u tremb, ja, do ta shohësh vëtë... nuk e lëvizëm se kishim frikë, lajmëruam edhe spitalin...

Burhanin e kishin shtrirë mbi dy tezga të vëna ngjitur dhe e kishin mbuluar me një beze nga ato cië izolonin tubat. Nië niollë e madhe qajaku kishte filluar të hapej mbi bezen e bardhë.

Jona u ul në gjunjë vranë tij, deshi ta prekje, po sytë iu veshën dhe shihte turbull.

— Burhan... — foli ajo dhe nxori në atë emër një pshërëtimë të thellë. Ai burrë, që rrinte përdhe si lis i prerë, rënkonte mbytur, me sytë mbyllur dhe djersinte në rrëzë të flokëve e mbi buzë.

— Burhan, — tha ajo prapë.

Ai hapi cepallat e rënduara dhe u mundua të filksonte sytë, pastaj rrudhi mjekrën sikur donte t'i thoshte se dicka nuk ishte bërë mirë, po nuk i shqiti dot buzët e thara t'i fliste.

Ajo pa rrotull këmbët e punëtorëve që rrinin

ngjitur dhe uli kokën pranë veshit të tij, po foli me zë të lartë, që ta dëgjonin të gjithë:

— ... Kjo ... kjo është përfajin tim...

Burhani *ngriti* vetullat që t'i thoshte «*jo*» dhe rënroi si nga një dhimbje që shkonte më thellë se plagët.

Vajza rrinte në gjunjë dhe ai nuk ia shqiste sytë e mirë, me bebëzat të zeza e të bardhat gati bojë qielli si të fëmijëve. Ata e kishin kontrolluar soletën bashkë, armaturën, hekurin, detajet. Ai kishte qenë specialist ndërtimi 30 vjet dëhe dinte të thoshte, duke matur me sy, sa hekur e beton donte një soletë apo një tra. Kish mësuar siç mësohet gjuha. Atë natë ata i qenë kthyer soletës dy herë me fletët e projektit në dorë dhe kishin betonuar gjithë natën. Tani shihnin njëri-tjetrin duke kërkuar të kuptionin ku ishte gabimi.

— Po vjen drejtori me kryeinxhinierin. Është edhe sekretari i partisë... — Selmani qe përku-lur mbi vajzën dhe i fliste duke ia futur zërin tejpërtej veshëve si fërshëllimë. Vajza ndjeu dhimbje diku pas kokës. Vështroi andej nga po vinn atë të tre. Drejtori ecte përpara duke tundur fort kokën tullace dhe ulte e ngrinte duart duke hapur e myllur gishtërinjtë. Sekretari mundo-hej ta mbante duke e prekur në krah.

— I ke bërë procesverbalet e punimeve të maskuara? Nganjëherë ato të shpëtojnë kokën... — Selmani i kishte afruar fyturën pranë. Vajza u drodh dhe një fshikull e ftohtë si gjarpër i pështolli trupin. Ajo i na ballin e rrudhur dhe sytë e frikësuar... Pse kishte frikë ai? S'kishte parë kurrë ballë aq të zhurosur, një mijë rru-

dha bashkë si një rrjetë, një ballë i lig, me një mijë mendime.

Drejtori iu afrua Burhanit dhe u zverdh.

— Mbahu, Burhan, hë, burrë! Tani vjen urgjencia. — Ai u lëkund pas e përpara. Sekretari e zuri nga bërryli dhe e shtyu jashtë rrethit. Dikush tha nën zë se drejtorin e zinte gjaku.

Kryeinxhinieri u ul me njërin gju përtokë dhe e vështroi ngultas, duke fshehur sytë nga të tjerët, sikur me atë vështrim të donte ta mbante gjallë. Burhani shqiti qepallat me zor dhe qeshi me një cep të buzës. Një punëtor i lagte ballin me pëllëmbë.

Nga larg u dëgjua boria e zgjatur e ambulancës. Dy infermieri dhe një çupë e vogël, që duhej të qe mjekja, zbritën me vrap, duke përpjekur dyert e makinës. Mjekja dukej e trembur. Kur iu afrua Burhanit dhe i zbuloi shpatullën, u zverdh sikur do t'i binte të fikët. Katter punëtorë dhe dy infermieret e ngritën Burhanin me kujdes dhe vetëm atëherë njerëzit panë sa peshonte ai burrë zeshkan, me flokët të qethur në zverk e të ngritur qiri në majë të kokës, trupmadh si div, aq sa nuk gjendej kurri një kostum pune që t'i rinte. Me mëngët gjithnjë të shkurtra e pantallonat deri në kyçin e këmbës, Jonës i dukej sikur ai rritej përditë.

Mjekja vështroi Jonën me sytë e vegjël të shkruar me të zi, po nuk i buzëqeshi. Mbase qenë moshatare, mund të kishin qenë në aksione bashkë. Ajo u kthye të hipte në makinë dhe vazhdoi të shihte përmes xhamit, me kokëfortësinë e një fëmije, Jonën, që rrëmonte në xhepat e fundit diçka të paqenë. Mbase donte t'i thoshte

se ishin tē dyja njësoj, përpara një pçrtë tē hapur papritur.

Ajo vajzë e vogël, e burdhëj kishte ardhur e kishte ikur si një vezullim gjithë dritë, duke marrë me vete Burhanin.

Në anë tē rrugës një gomar e cte zdrënkti, duke u munduar tē rrëzonët tē zotin që mezi mbahet mbi samar. Fshatari u hodh e u penguanë këmbët e tij. U qeshi atyre tē dyve dhe i shkuli veshin gomarit.

Po iu mbush mendjanëtë tē rrëzojë, tē rrëzon se s'bën, — tha duke shkundur pantallonaqat kadife dhe shkoi pas gomarit, që kishte marrë vrapin në mes tē rrugës.

Agroni u kthyte tē shihte Jonën dhe qeshëns tē dy njëherësh, sikur kërkonin një shkak t'i gëzoheshin njëri-tjetrit.

Vajza u ngazëllye. I dukej sikur në atë copë rrugë do tē arrinte tē kuptonte diçka që i rrëshqiste për vite me radhë. Ngriti sytë lart. Ajo reja e errët mbi lugine ikte drejt një anë tē qitellit me shpejtësi, sikur aty tē qe një grykë e hapur!

— Ai u kthyte dhe ndaloj? — pyeti.
— U lodhe? — pyeti.

— Pak.
— Ulemi po tē duash. Klubi është pas kthesës...

— Ata qëndruan në gurët e kilometrazhit në të dy anët e rrugës, karshi njëri-tjetrit.

Agroni ndezi cigaren dhë e piu duke e thi-

thur pa pushim, duke ngritur sytë herë pas he-re tē shinte vajzën. Ulte kokën dhe mendohej, pastaj e shihte prapë, sikur i vinte rrrotull, si tē donte tē merrte vesh pak nga pak si ishte ajo. Vajza u mblodh e u përkul mbi vete, I du-kej sikur ishte zhveshur. I skuqnin faqet dhe i ndritnin sytë si tē kish ethe. Ai i pa` buzët e pjekura dhe mendoi se vajza qe sëmurë.

— Ajo që ndodhi është për fajin tim më shumë se për tëndin, — tha Agroni.

Jona tundi kokën. Donte ta mbante tē gjithë peshën mbi vete. Mbase për herë tē parë në jetën e saj po ndiente peshën e dhimbjes për tē tjerët e tē përcmimit për veten e saj. Gji-thë atë ditë kishte menduar me habi se gjërat mund tē kishin qenë ndryshe po t'i kishte ngjarë nënës. S'e kish shkuar në mend më parë. Dhe ishte kaq e thjeshtë. Do tē donte tē kishte fytyrën e saj tē rëndë, gati tē shëmtuar, me no-fullat e forta pa mish, me sytë e egër, me një mirësi pa fund. Shkoi pëllëmbën lehtë mbi fa-qe. Kishte fytyrën e vogël, tē lëmuar, tē qetë tē atit. Kishte lexuar diku se njeriu pas një-farë moshe është përgjegjës për fytyrën e tij. Mbase ishte e vërietëtë.

— Nuk dua tē tē lehtësoj ty kur them se ish-te për fajin tim. — Ai heshti një copë herë, pastaj qëndroi dhe u kthyte nga vajza:

— Të kujtohet dita e parë që u takuam? Të dukej sikur tē gjithë duhej tē ishin tē gëzuar që kishe ardhur ti në kantier.

— Po, — tha Jona dhe ndjeu se po skuqej.

— Kur tē shërohet Burhani, do tē bëjmë një festë, ne tē tre.

— Po, — tha vajza. Do të pranonte çdo gjë që t'i thoshte, edhe sikur të ishin dy të kundërtë njëra pas tjetrës. (Nuk bënte kështu i ati me të?)

Ai e vështroi me hidhërim.

— Ikim, — tha, — mbase gjejmë ndonjë gjë të ngrohtë te klubit.

— Mirë, — tha Jona dhe u ngrit duke fërgëlluar e tëra. Kishte ftohtë.

Ç'ishte ky njeri që kishte fuqi t'i mpinte mendjen dhe trupin? Vajza ndiente një dridhje të lehtë në gjunjë, siç i ndodhë kur inatosej. Deshi të dinte çdo gjë për të. Ishte xhelozë për jetën e tij. Në një libër të Gollsuorthit kishtë lexuar se njeriu fillon të dashurojë që në moshën pesë vjeç. Si ishte vajza që kishte dashur ai? Donte ta shihte. Jona kishte dëgjuar se qe rritur jetim, tek një xhaxha i tij. Punëtorët e donin, por edhe ruheshin të mos i kthenin fjalë. Në kantier tregonin se qe hedhur në lumë të shpëtonte xhaxhanë kur kishte qenë dhjetë vjeç. Ai flinte në një zyrë të vogël dhe hante në mensa, në këmbë, ku ta zinte dreka. Vajzës i rrihte zemra kudo që e shihte.

Ai po ikte përpëra dhe Jona qëndroi të merrte frymë. Qe lodhur së ndjekuri atë njeri. Eci ngadalë anës rrugës, e vetmuar, po ndiente se një numër i pambaruar qeniesh të gjalla, që bënin muzikën e heshtur të perëndimit, prapseshin para hapit të saj e shkonin me të bashkë. Ndjeu gëzim. Kur të arrinte në shtëpi, gjërat do të ishin ndryshe. Mbase tanë i ati kishte dalë për shëtitjen e mbrëmjes dhe ecë mbi urën me gurë, siç bënin gjithnjë kur dilnin bashkë. Kur

mendonte për babanë, Jona kishte gjithnjë një ndjenjë rehatie, gjë që nuk i ndodhët me në-nën. Babai ishte i butë e zemërgjerë, sa, kur duhej të zgjidhët midis dy kushtave, kruante tëmthin me gishtin tregues dhe thoshte se bë-hej edhe njëra edhe tjetra, dhe të linte ta zgjidhje vetë. Jona që mësuar që për së vogli t'i tregonte çdo gjë dhe fytyra e tij kishte gjithnjë po atë shprehje paqeje e mirësie që të bën-te të flisje pa pushim, duke treguar edhe ato që s'do të doje të tregoje. Ajo shihte edhe njerëz të tjerë që vinin e tregonin, nganjëherë i vinte rëndë për ta. Dhe babai thoshte gjithnjë: bëhet edhe kështu, edhe ashtu, duke i lënë po aq të hutuar, sikur t'u thoshte se këto që tregonin s'kishin asnjë rëndësi. Po çfarë kishte rëndësi për babanë e saj? Nuk do ta kuptonte kurrë.

Nëna ishte shtatlartë, me flokë të zez, fytyrë-gjatë, me nofulla të forta. Në sytë e mëdhenj, të rreptë, me vetulla të trasha e qerpiqë të den-dur, kishte njëfarë trishtimi sikur të vuante për hallet e njerëzve. Rrathët e fryrë poshtë syve tregonin se flinte pak dhe bënte gjumë të shqetësuar. Jonës i pëlqente zëri i nënës, i trashë, i ngrohtë. Ishte më e gjatë se babai. E priste vajzën të shtunën në krye të shkallëve dhe e përqafonte duke e ngritur peshë. Tani Jona duhej t'u tregonte atyre për Burhanin, që e kishte lënë në spital, do t'i tregonte babait, kur të mbeshtën vetëm, dhe ai do t'i thoshte: «Ç'mund të bësh ti për të? Janë doktorët...» Me siguri kështu do t'i thoshte.

Klubi qe ndërtuar në një shesh të vogël që zgjerohej në krah të rrugës automobilistike si një nyje ku kryqëzoheshin edhe dy rrugë të tjera. Njëra, e hapur rishmë, vinte nga poshtë, e bardhë, nazike, e ngushtë, kaptonte lumin me një urë të vogël si një lodër fëmijësh, duke dalë nga qafa midis dy maleve. Tjetra ngjitej në kodër me mundim, duke ndjekur pjerrësitë e shpatave e duke i ardhur rrotull qafës së spirales. Dukej një rrugë e vjetër, e shruar me kalldrëm të ndritur.

Në verandën e klubit nja dy fshatarë dëgjonin sportin në radio duke afruar kokën te njëri-tjetri. Një burrë i gjatë, që rrinte me duar në xhepa, mbështetur pas murit, i hapte e i mbyllte diellit syrin, duke përveshur njérën anë të buzës. Kur pa Jonën dhe Agronin, qeshi dhe atëherë goja i llamburiti e tëra, e veshur me metal të bardhë.

— Po ku je, o inxhinier, aman, or, më qafsh! Ai e mbështolli Agronin në krahë dhe e shtyu nga dera e klubit duke e mbajtur nga shpatullat.

— Hajde, motër, urdhëro, — i foli Jonës duke i hapur rrugën në derë. Atëherë ajo pa dy qen të mëdhenj gjahu më mëgojëza metalike që shtyheshin te këmbët e tij. I mbante të lidhur me zinxhir në brez.

— Mos u tremb, — i tha vajzës, — janë të mitë. — Hajde, hop këtu! hop këtu! i tregoi me gisht ku të rrinin, dhë qentë u ulën në dy kë-

mbët e pasme duke vështruar të zotin me sytë e mallëngjyer.

— Nxirri qentë jashtë, — tha banakieri, — o Thoma, të thashë njëherë!

— Hajde, nxirri po ishe i zoti, — tha Thomai dhe i ra Agronit në shpatull.

— E lashë pikturën, hapa një ekspozitë në maj dhe me aq i dhashë fund. Edhe kanarinat më ngordhën, seç u ra një sëmundje, më mbetën kafazët bosh. Ti i kishe parë kanarinat e mia? Tani merrem me gjah. S'ta merr mendja si është gjahu, si dashuria e parë.... Iki të shtunave, kthehem të hënave. Mezi e nxora lejen e çiftes.

— Në spital si iaçon?

— Eh? Në spital? Bëra specializimin për radiolog. Ka ca të mira radiologjia, pensionin, ushqimin. Rojë s'bëj. Jam rregulluar mirë me një fjalë.

— Po Vera si është?

— Vera? Hëm, e kush e di? U ndamë. Dëgjo, vëlla, s'jam unë për t'u martuar. Apo jo, ja, si thua ti, motër, të dukem tip për t'u martuar unë? Unë s'rri dot dy ditë në një vend, ja, Agroni më niëh, kemi aenë në konvikt. Mbata vitin e parë në inxhinieri, matematika, motër tmerri i botës. U bëra miek, po merrem me cdo gjë. E di si them? Të jetoja nja shtatë a tetë herë do isha më i qetë, po me nië jetë c'të bëjë rieri u përoara? Jeta është nië film aë luhet vetëm një herë dhe e keqja është se nuk ka mundësi të provosh si do të qe po të luhej ndryshe. Ja, të them, unëndava me Verën, unë e doja, e doja shumë. Po mund edhe ta mbaja. Di të më

thuash ti, vëlla Agron, do të qe më mirë ta mba-ja Verën?

— Po, do qe më mirë.

— Pse? Di të më thuash pse? Unë u njoha me Verën rastësisht. Po të mos kish qenë sëmu-rë nëna e saj dhe po të mos kisha qenë unë mjek rojë atë natë, nuk do ta kisha parë kurrë dhe nuk do të kisha rënë në dashuri. Mund ta zgjedhë njeriu shoqen e jetës nga kombinimi i dy rastësive? Si thua ti, vëlla? Tani merrem me gjah; kafshët, vëlla, janë gati të bëhen fli për ty dhe nuk kërkojnë shpërblim për kënaqësinë që të japid. Femrat të japid dashurinë, po do ta paguash me lirinë.

Ai heshti pak sa të merrte frymë. Kur s'kishte ç'të thoshte më, kthehej nga e para, duke derdhur një lumë fjalësh me të njëjtën energji, e ngiste Agronin me duar, i binte me bërryl në ije që ta bënte të dëgjonte.

Dy qentë qenë ngritur dhe haheshin me një-ri-tjetrin duke tërhequr të zotin. Ai doli duke u mbajtur me zor pas zinxhirëve.

— Do vij, prapë, inxhinier, sa t'i rregulloj pak... Oh, ah, ç'më dërrmuat, or të uruar...

Në klub u bë qetësi. Jona hodhi sytë rrötull. Drita vinte nga lart, nga një baxhë e madhe me kornizë të errët të gdhendur në dru arre, një dritë e bardhë, që nuk bënte hije gjëkundi. Sendet rrötull dukeshin të gjalla sikur të shtatëngjyrat e dritës së bardhë të kishin gjetur se-cila vendin e vet. Ishte një vend i pastër e i dëlirë, si i larë nga dora e një vajze, ku njeriu duhej ta mbante mendjen në vend, të pushonte, të gëzohej e të ikte.

Kamerieri, i ri, i pastër, solli kafe me xhez-
ve bakri dhe biskota të pluhurosura me sheqer,
I buzëqeshi Jonës.

— Të mërziti Thomai? — pyeti Agroni duke
e parë Jonën në sy.

— Jo. Ishte njeri gazmor.

— Është njeriu më i çuditshëm. Mund të he-
që rrobat e trupit t'ia japë një miku, pastaj e
lë dhe ikën se ka gjetur një mik tjetër. Dhe
mund të kthehet prapë tek i pari. Nuk është
djalë i keq. Ka një si etje për gjëra të reja.

Jona po mendonte të atin. «Bëhet edhe kështu,
edhe ashtu» Thomai do t'i provonte të dyja, të
bënte njérën, pastaj të kthehej ta bënte ndryshe,
që të shihte si qe më mirë dhe prapë nuk do
të qëndronte tek asnijëra, kurse i ati nuk do të
provonte në asnijë formë.

Agroni po e vështronte me vëmendje.

— E di? Babai im ngjan me Thomanë, vetëm
se nuk ka etje kurrë, mund të mos pijë ujë të-
rë jetën. Kupton? Prandaj nuk ngjan fare.

Ai uli vetullat si të donte ta shihte mirë.
Mbase vajza kishte ethe.

— Do të dalim pak jashtë?

— Jo, jam mirë këtu.

— Unë po dal të shoh për ndonjë makinë.

Jona u mbështet në shpinën e kolktukut dhe
vështroi nga dritarja majën e malit, ku blerimi
kishte marrë një ngjyrë të hirtë. Ktheu kryet
padashur nga tryeza pranë derës dhe vuri re
se dikush i kishte ngjitur sytë. U shikuan drejt-
përdrejt. Burri u përmend i pari, i tha diçka
shokut pranë dhe bëri një lëvizje të lehtë me
kokë si ta përshëndeste. Ishte i thyer në moshë,

me kokën katrore. Fytyra e mbushur i skuqte nga shëndeti, sytë e vegjël i mbante përgjysme të mbyllur. Ai mbështeti mjekrën mbi duart e mbledhura grusht dhe filloj të shikonte sallën duke luajtuar vetëm sytë, sikur ishte në pritë.

Jona u drodh. Ishte mjeku që kishte operuar Burhanin. E kishte parë në pavion me përparëse e kapuç të bardhë të rrasur deri te sytë dhe tani s'e kish njojur. Jona u ngrit, u afroa ngadalë dhe foli me zërin e dridhur:

— Më falni... ju jeni doktori?

— Po!

— Desha të pyes si është Burhani, ai punëtori që u aksidentua ditën e hënë.

Doktori lëvizi sytë e vegjël që i rrëshqitnin si zare. Dukej që e kishte të vështirë t'i mbante të fiksuar në një vend.

— Nuk e di. Nuk kam qenë në spital sot, — tha duke hapur krahët anash.

— Desha të di si është kështu... do të ketë ndonjë pasojë... më vonë?

— Vetëm krahun. Por duhet ta shoh prapë që të them ndonjë gjë të saktë.

— Si vetëm krahun?

— E ka mbajtur gjithë peshën në shpatullën e djathtë. Ky shoku është nga Tirana, specialist për kockat. E kemi thirrur të shohë atë punëtorin tuaj.

— Ah, vërtet?

Ai tjetri ishte një njeri i vogël, që mbante tërë kohën sytë përdhe, si të mendonte punët e tij. Foli ngadalë, duke fërkuar mjekrën pa pushim sikur kërkonte të shtronte fjalët.

— Dostë bëjmë një konsultë këtu... pastaj të shohim mund ta marrim në Tiranë... gjëra që ndodhin... s'duhet ta lëmë pa krah një specialist... spacialist ndërtimi thatë?

— ... Specialisti më i mirë... i ndërtimit...

— Vajza e vështronë doktorin nga Tirana me shpresë, por ai i vidhej vështrimit të saj.

— Ju ku po shkon? — foli papritur mjeku që kishte operuar Burhanin.

— Unë?... unë... në shtëpi, kthehem çdo të shtunë, — tha, por u kujtua papritmas që ishte e enjte.

— Aha. Keni pasur ca telashe me hetuesinë, — tha mjeku dhe u rrudh, po s'mundi t'i zvogëlonë sytë më shumë nga ç'i kish.

— Po, — tha Jona, — po s'ka rëndësi. Rëndësi ka Burhani.

— Po të shpëtojë Burhani, edhe faji juaj lehtësohet.

— Për mua është njësoj. Më falni. — tha ajo dhe u tërroq në tavolinën e saj, duke menduar se do kish qenë më mirë të mos kish luajtur vendit. Mjeku i qe dukur tjetër njeri. U ul dhe zuri të shkruante me një fije shkrepëse pa kokë kutitë në mbulesën e tavolinës. E hëna pashkë qenë dita më e nxehë...

Gruaja dukej e vogël, aq e vogël, sa nuk të besohej të ishte e shoqja e Burhanit. Rrinte në fund të korridorit të mermertë, aty ku duhej të

ishte salsa e operacionit dhe dukej e errët. Jona i vajti pranë, po nuk i foli, u ul në stol dhe ia nguli sytë murit të lyer me bojë vaji të bardhë, ku dukeshin si njollë e vogël pa formë pasqyrimi i saj dhe i gruas.

Gruaja mërmëriti diçka duke shtrënguar rrobat në gjoks me grushtin e vogël, sikur kërkonte t'i mbyllte rrugën një ngashërimi. I kishte flokët të kuq si një shpirt i shqetësuar. Në korridorin e ftohtë, me dritë të bardhë, flokët e saj dukeshin si zjarr. Donte të çohej se shikonte dendur nga punëtorët që rrinin më tej, në grup, po prapë mbetej me duart mbi gjunjë, me majat e këpucëve të bashkuara, siç rrinë fshatarët, si të qe kujtar befas se lëvizjet e saj nuk duheshin për asgjë.

Jona iu afrua.

— Unë punoj me Burhanin, — tha ngadëlë. — Jam inxhiniere (kish thënë «jam inxhiniere», si të merrte një faj përsipër).

Gruaja u ngrit, i mbështolli dorën me dy pëllëmbët dhe u zgjat në majë të gishtave ta puthëtë në faqe. Do të përqafonte çdo njeri të Burhanit.

— Qofsh me jetë, o xhan, — tha ajo me zë të butë. — Faleminderit që erdhe, ma bëtë borxh të gjithë. Ulu, o xhan, mos u lodh.

Ajo u ul vetë dhe ndenji pranë, me duart mbi gjunjë. Dukej se e harroi vajzën. Kishte buzë të holla dhe lëkurë ngjyrë karote, me quka bojëkafe, që i shtoheshin në të dy anët e hundës së hollë e të kërcyer, gati të tejdukshme, si fletë kauçuku. Po sytë i kishte të zez e të tèrhequr.

Mund tē kish qenë e bukur po tē mos ishte aq e kuqe.

Jona u ngrit. Nuk i duronte mē kēto korridore tē lēmuara, qē sikur rrëshqitnin. Donte tē shkelte nē tokë. Punëtorët kishin dalë jashtë nē oborr dhe pinin duhan grumbull. Jona kérkoi me sy midis tyre dhe zbriti shkallët duke têrhequr parmakun, qē i rrëshqiste nē duar.

— Hajde, inxhiniere, — ata i hapën vend.

— Po dal njëherë.

— Mirë bën, — tha Idrizi. — Po deshe, vij edhe unë me ty.

— Jo, — tha Jona, — do kthehem shpejt, — dhe u pendua që s'e la Idrizin tē vente me tē. Ishte mësuar tē ecte me ta nëpër kantier dhe ta ndiente veten mirë. Ata i thoshin gjithnjë «hajde, inxhiniere», kur ishin tē gjithë bashkë ose kur hynte nē objekt, dhe asaj i dukej sikur e ftonin nē një strehë dhe hapnin për tē një derë.

Atë ditë i rrëshqiste gjithçka.

U end një copë herë nëpër qytet, pastaj kaloi urën dhe zuri tē ecte ngadalë. Era, që frynte rrafsh me tokën, fshinte kokrrat e imta tē pluhurit e i rrokulliste me shpejtësi. Ajo vështroi qiellin mbi majat e maleve që po merrte një ngjyrë blu tē qelqtë. Dukej se nata do tē ishte e freskët. Nga toka buronte ende një dritë e rreme.

Ajo eci ngadalë nē asfalt, duke rënduar nē thembra, sikur do tē ngjiste një tē përpjetë. Ish-te e lodhur.

A e kishte kuptuar gruaja e Burhanit që ajo ishte inxhinierja e asaj hataje? Dukej se jo, për-

ndryshe nuk do ta kish përqafuar. Në kantier kishin ardhur ata të hetuesisë. Mbase do të zbulonin diçkal që vajza dhe të tjerët nuk arrinin ta kuptonin.

Ajo qëndroi dhe u kthye. Do të shkonte në shtëpinë e Burhanit. Gruaja me siguri do të ishte aty.

Gruaja e priti vajzën duke u munduar të ishte buzagaze, e futi në odën e vogël të shtruar me qilim dhe e gostiti me llokum e reçel kajsie. E kishte lidhur shaminë nën zverk dhe nuk i dukeshin flokët e kuq. Jona tha me vete se kështu që më mirë. E shqetësonin flokët e saj të kuq. Ajo ishte e qetë, por sytë i kishte të enjtur, si një njeri që ka qarë gjatë.

Një vajzë nja dymbëdhjetë vjeçë, me përparrëse me pika dhe me fjongo të madhe rrëth kokës, vinte rrotull nëpër shtëpi duke bërë punë si zonjë e vogël, sikur luante me kukulla. Ajo e pa Jonën me ftohtësi dhe i zgjati dorën si e rritur. Kishte sytë dhe fytyrën e nënës dhe ngjyrat e të atit.

Jona s'e ndjeu veten mirë. Gruaja e shihte me mirësi, po vajza i hidhët vështrime fshehurazi, me sytë si të nënës. Ai fëmijë nuk dinte të fshihet dhe kishte në sy atë që mundohej ta mbulonte gruaja.

Dy djem të vegjël, që dukeshin moshatarë, rrinët ngjitur me njëri-tjetrin mbi një revistë.

Gruaja nuk e pyeti për asgjë.

— Si është Burhani? — tha Jona, duke kthy-

er kokën nga dera e hapur e dhomës. Vajza dë-
gjohej që pastronte në sallon.

— Ja ashtu, o xhan, na thonë që është mirë.
Erdha sa të rregulloj fëmijët dhe do vete prapë.

— Ajo mblodhi buzët që të mos qante, po mje-
kra zuri t'i dridhëj. Nuk e shihte vajzën në sy,
u mblodh një grusht dhe uli kokën.

— Ku punoni? — pyeti Jona.

— Në kombinatin e drurit, jam në repartin
e lustrës. (Jona mendoi se prandaj e kishte atë
ngjyrë të kuqe.)

— Unë jam inxhiniere, punoj me Burhanin
bashkë.

— Po, e di, ma the edhe në spital.

— Burhani është punëtori më i zotit.
Gruas i ndritën sytë. Ungrit të kërkonte di-
çka në raft dhe u kthye me një fotografi në
dorë që e shihte me mallëngjim. Deshi të flis-
te, por e mbytën lotët dhe ia zgjati Jonës. Qe
një fotografi e bërë nja dhjetë vjet më parë.
Burhani me gruan dhe tre fëmijët e vegjël, të
mbledhur si zogj, dukeshin të rinj, të lëmuar
nga dritat. Jona ndjeu dhembje në mes të gjo-
ksit.

— Unë e kam fajin që u plagos Burhani, —
tha.

Gruaja mbeti më këmbë, e ngrirë, ktheu ko-
kën ngadalë nga vajza, sikur kjo t'i shkaktonte
një vuajtje të padurueshme, dhe e vështroi me
sytë me bisht, me habi, me dhimbje.

— Jo, o xhan!

— Po, — tha Jona, — Unë nuk e di pse
ndodhi kjo dhe duhet ta dija.

Gruaja u ul dhe i mori dorën. E vështroi me
habi e dyshim.

— Se mos deshe ti! — tha. Tani ajo nuk e shihte më në sy dhe Jona ndiente se nuk i fliste me gjithë zemër. Mbësë mendonte se, po të kishte qenë një njeri tjetër në vend të saj, nuk do të kish ndodhur.

— Unë përgjigjëm për çdo gjë që ndodh në objekt, — tha Jona dhe nuk dinte nëse ishte e singertë tek e dënonë veten. Vajza e vogël kishte qëndruar në derë dhe e shihte gati me armiqësi.

— Mbësë shpëton krahu... thanë doktorët::: — gruaja foli me sytë përdhe.

Jona mendoi se ajo donte të rrinte vetëm dhe u ngrit. Dy djemtë e vegjël e shihnin gojëhapët.

Gruaja e përcollë dori jashtë te shkallët duke e mbajtur nga krahu dhe tha me zë të këputur:

— Bëju të fala nga shtëpia dhe na hajde prapë.

Jona zbriti shkallët pa e kthyer kokën, por e dinte që gruaja, vajza dhe dy djemtë rrin në derë e shihnin, si në atë fotografinë e vjetër. U mungonte babai.

«Xhafa» (kështu quhej çdo banakier që vinte të punonte te Kafja e Xhafës, edhe sikur ta kish emrin Spiro) fshiu duart me cepin e bluzës dhe i bëri shenjë djalit që shërbente. Pastaj vajti në një tavolinë me dy burra të vjetër dhe mori edhe vetë një gotë raki.

Doktor Thomai hyri me vrull duke i hapur rru-

gën një orkestre të vogël kurbatësh dhe u ul në tavolinën e Agronit.

— I rregullova, — tha, — i lashë te kuzhiniieri.

Ai u kthye të shihte «orkestrën», që u rregullua dy tavolina më tej dhe tregoi me dorë duke qeshur:

— I njeh ata? Ai me violinë është Cikja, violinë e parë e Shqipërisë së Mesme. Janë nisur për dasmë.

Vuri gishtin në tëmtha siç bëjnë fëmijët kur duan të mendohen dhe tha sikur të kujtohej atë çast:

— Ju... të fejuar jeni? — dhe i lidhi me një lëvizje të gishtit tregues.

— Jo. Jona punon në kantierin tonë. Është inxhiniere.

— Po si kështu? Nëpër rrugë, vetëm...

— Na u prish makina lart te çezma.

— Ah. Mos u fejoni, vëlla, mos u fejoni!

Ai u kthye edhe një herë nga kurbatët, që kishin filluar të hanin.

— Cike, o Cike, merrja njëherë asaj së bahçevanit, se na plase shpirtin.

Cikja, kurbati me violinë, zbardhi dhëmbët duke u mbillaçitur dhe tundi kokën.

Një grup njerëzish po hynin në derë njëri pas tjetrit duke tërhequr plaçkat e valixhet. Kafexhiu ktheu gotën me një frymë dhe u ngrit në këmbë.

— Erdhi autobusi, Safet! Gati furnizimin!

— tha.

— Gati, usta!

Në tavolinën e parë u ul një çift që kishte

vetëm një valixhe të madhe. Gruaja qe e vogël, gati e shëmtuar dhe fliste pa pushim, si në ethë, duke i mbështjellë vazhdimisht rrëth gjoksit një triko të madhe. Burri ishte i qetë, me trup mesatar dhe mjaft i pashëm. Gruaja tra-zonte me duart nervozë, gjithë nyja, gotat mbi tavolinë. Unazat i vezullonin si zjarre të vogla. Një tavolinë më tej, nja tre fëmijë s'po prishin sa të hanin, duke i ndukur krahët një gruaje të shëndoshë, që nuk kuptohej në qe nëna apot gjyshja.

Pas pak në sallë dëgjohej vëtëm trokitja e filxhanëve, dhe ajo gruaja e vogël, e shëmtuar, që fliste me një zë të trashë e të lartë duke parë rrötull.

Cikja qe ngritur në këmbë. Mbushja edhe një herë, usta, se do ujë bretkosa të këndoje, — tha njéri nga orkestra.

E tillë brekosë këndon edhe në të thate, — qeshi kafexhiundhesi rá Cikes në mes të shpatullave, sa desh e rrëzoi poshtë.

Cikja dërdhi fundin e gotës në gojë dhe mori violinën. Dy kurbatët e tjere, njéri më gërmëtë e tjetri më kitarë, ngritën veglat, po Cikja u bëri shenjë të urinimi. Nuk do ta merrte këngën e bëhçevanit.

Ai iu afriti një tavoline kurrinte një tënë me dy çupatë të rritura, qeshi dhe uli kokën lehtë. Pastaj mbështeti faqen në violinë dhë uli sytë mbi telai. Së ç'këngë qe ajo, vëtëm Cikja e dinte.

Mbase i binte për herë të parë aty, mbase as ai vëtë s'edinte, se qe një muzikë që dilte nga shpirti.

Ajo ngjitej lart si vërvshëllimë nepërke, dhe Cikja ngrihej në majë të gishtave takarrinte, pas-

taj ulej poshtë sikur têrhiqeje zvarrë e, kur fillopte tê zbriste poshtë, Cikja e fuste veglën në gjoks, dridhej mbi tê me telin bashkë dhe përkulej sa i çikte balli në tavolinë. Pastaj ai ngrihej dhe përkundej në dy krahët duke lëshuar ca tinguj që sikur bridhnin tê fshiheshin e mblidheshin prapë togje-togje. Cikja queshte, luante. Vazja e vogël queshte me tê bashkë, e madhja dukej e mallengjyer dhe mundohej tê mbante lotët. Në fund violinë ulériu dhe pushoi befas, kur s'e prishte njeri.

Cikja mbeti një copë herë në këmbë, me violinën poshtë. Ishte i shkurtër e i plotë, me flokët tê zez pis, më tê zez se sytë, tê dredhur e tê pleksur si rrënjet e krisjes.

Një mesoburrë, me xhaketën zbërthyer, u ngrit me vrull, duke u penguar nëpër këmbët e karrigeve, arriti te Cikja, i puthi violinën, pastaj i ngjiti buzët në ballë.

— Lëre evgjinjin, ç'e ngët! — tha banakieri i përlotur.

Njerëzit nuk lëvizën dhe përvç fëmijëve asnjeri nuk hëngri më.

Gruaja e shëmtuar, që kishte heshtur një copë herë, fshiu sytë dhe filloi tê fliste prapë, duke iu qepur tê shoqit. Dukej se trembej, doante tê mbushte patjetër diçka që ishte e mangët në lidhjen e tyre. Burri rrinte i heshtur dhe e shihte gjithë kohën në sy, sikur kërkonte ta qetësonte. Gruaja sillej rrötull tij si grerëz, që tê mos i linte kohë tê merrej me gjë tjetër, as tê mendohej dhe vështronë rrötull me sytë e shqetësuar. Vuante dhe harxhonte gjithë energjitetë në një xhelozë pa fund.

Doktori bëri lehtë me kokë nga ata, ndoshta që të tregonte se kishte pasur të drejtë që e kishte lënë Verën.

Jona shtriu këmbët nën tavolinë dhe ndjeu t'i dhimbnin gjunjët.

— Ku shkon ky autobus? — pyeti ajo.

— Në E., — tha Agroni.

— Të gjithë shkojnë në E., — foli vajza me zë të ulët. Ajo vështroi nga tavolina ku kishte qenë mjeku i Burhanit. S'i kishte parë të iknin ata të dy.

Jashtë kishte filluar të errej, po në klubin e vogël kishte mbetur ende drita e ditës. Vajza u ngrit, po i zihej fryma.

— Po dal pak jashtë, — tha dhe nxitoi nga dera.

Qëndroi në verandë dhe iu rrënqeth trupi. Bënte fresk. Nga lugina ngrihej një masë ajri e lagësht, aq ngadalë, sa nuk lëviznin as gjethet.

Vajza kishte mbetur në mesin e rrugës. Kishë dashur të shkonte në shtëpi, po sa më shumë i afrohej qytetit, aq më tepër dëshironte të kthehej mbrapa. I dukej se rrëshqiste pa kthim dhe mundohej të mbahej diku. Nuk mund të kthehej mbrapa dhe nuk donte të shkonte përrapa.

Një plak rrinte në këmbë në anë të rrugës, me trupin drejt dhe pothuaj nuk mbështetej në bastunin e drunjëtë me dorezë të trashë, që e trokiste në asfalt me një ritëm të rregullt, sikur ndante kohën në një masë që e njihte vetëm ai, që kishë të bënte me mendimet e tij. Kishë flokë të bardhë e të gjatë që i binin mbi zverk dhe hiqte e vinte pareshtur «republikën», duke e rrëshqitur

mbi ballë si të shtronte flokët. Dukej i pastër, i hekurosur, i lustuar deri në majat e këpucëve të zeza. Një vijë e hollë tymi ngrihej drejt nga llulla e tij në ajrin e palëvizshëm, aq drejt, sa dukej sikur plaku s'merrete frysë.

Ai u kthyte, eci ngadalë drejt autobusit, dhe i ra me gisht xhamit të parë, ku rrinte kru-spull një plakë.

— Dil të freskohesh, se të bën mirë. Ka një çezmë më tej.

Plaka u bind. Ai e ndihmoi të zbriste, gati e ngriti në krahhë. Plaka ishte e thatë, e veshur me të zeza, e vogël si grusht, me shaminë të lidhur sipër kokës. Ata ecën ngadalë, plaku përpara, plaka një hap më pas; pinë ujë në çezmë dhe qëndruan në anë të rrugës, me kurrizin të kthyer nga klubi.

Jona bëri përpara, iu duk sikur i kishte parë ata dy pleq. Në një fotografi të varur në mur në shtëpinë e Burhanit. Plaka nuk njihej, po plaka ishte nga ata njerëz që nuk ndryshojnë. Vajza deshi të kthehej në klub që të mos e shihnin, por i erdhi turp. Po të kishte pasur babanë aty, do të kishin ikur bashkë. Plaku nuk do ta falte kurrë, sido që të qe puna, edhe sikur Jona të dilte e pafajshme. Kurse plaka do të nënshtrohej dhe do të duronte siç dinë të durojnë vetëm nënët. Mbase nuk qenë ata. Burhani ishte nga Jugu

Jona lëvizi poshtë e lart në verandë. Ishte vërtet pa faj, apo i gjithë faji ishte i saj? Të martën e kishin thirrur në hetuesi dhe vajza qe munduar të kuptonte diçka. Kishte bërë ca pyetje, po s'i qe përgjigjur njeri. I kishin thënë se

pyetjet i bënni ata, jo ajo, dhe vajza kishte mbe-tur e hutuar.

Jona u ngjit në katin e tretë të hetuesisë dhe qëndroi në korridor të priste. Agroni doli nga dhoma e hetuesit duke tërhequr derën fort pas vetes dhe preku gjoksin me duar sikur kërkonte diçka që kishte fshehur. Nxori paketën dhe kaloi para vajzës pa i folur, pastaj qëndroi në fund të korridorit, karshi dritares. U kthye, pleksi duart dhe e vështroi ngultas vajzën, që rrinte në cep të stolit aq e palëvizur, sa mund të këpuntej e të rrëzohej nga çasti në çast.

— Jona...

Ajo u drodh. Zëri i tij rrëshqiti anës mureve të lëmuara përgjatë korridorit.

— Jona... — qe hera e parë që i fliste në emër. Zakonisht ai fliste duke u penguar, sikur e zinte diçka në fyt dhe duhej të kruante zérin vazhdimisht. Mbase nga duhani që pinte pareshtur.

Jona u kthye dhe u mundua ta shihte drejt në sy. I qe mpirë zverku nga të ndenjurit përmbyss. Agroni dukej më trupvogël pa kapelen me strehë. I kishte ulur vetullat mbi sy duke i puqur në rrëzë të hundës, siç bënte kur e vri-ste dielli.

— Tani do të të thérresim ty... — foli ai pa u afruar. Ajo pohoi me kokë.

— Mos u tremb dhe mos fshih asgjë. — Dukej që e kishte të vështirë të fliste me zë të ulët.

Jona nuk foli. Donte t'i thoshte se s'kishte gënjer kurrë, as kur kishte qenë fëmijë. U ngrit

dhe eci ngadalë në korridor duke u munduar ta madhte hapin drejt.

Hetuesi ishte një djale i ri, me këmishën zërthyer mbi gjoks. Ajo mori fryshtë thellë. Mund të kishin një moshë, mbase ai do ta ndihmonte. Tani kuptonte që kish pasur frikë.

Hetuesi e vështroi stohtë, si të donte t'i thoshte se ai do të bënte vetëm detyrën dhe se do ta bënte mirë.

Ai nisi ta pyeste me një zë monoton, me hollësi, për çdo gjë, dhe u ngrit e vinte rrötull nëpër dhomë, sikur kërkonte t'ia thurte fijet që të mos kishte nga të luante.

Ajo po egërsohej. Nuk kishte më frikë. Endiente veten të fyter që duhej të përgjigjej për çdo gjë. Nuk qe mësuar të përgjigjej. Por ai e pyeste prapë me durim, me zërin monoton. Një burri tjetër, që shkruante téré kohën, trupvogël e i shogët, i bënte ca shenja të pakuptueshme, sa herë që ajo duhej të përgjigjej. Në fillim Jona u kthye ta shihte dhe i tha «urdhëro», por ai mori një pamje të ngrirë, të shurdhërt dhe vazhdoi të shtypte në makinë duke lëvizur vetëm dhjetë gishtat me shpejtësi si një gasorre e tërbuar. Jona filloi të nxehet. Mbase pandehnin se kishte frikë. Po frika që e kish ndjekur pas si hije gjithë ditën që zhdukur, vetëm një dhimbje e thellë, në fund të stomaqut, po i zinte fryshtë.

Hetuesi i ri më në fund që ulur në karrige, përballe saj dhe vajza mundi të fiksonte sytë e turbullt.

Ai kishte flokë të verdhë, të dredhur, të ndritur e të butë si mëndafshi, si diçka e çmuar

që mund ta shohësh vetëm në pikturat e shekullit XIX. Po kishte veshë të mëdhenj, të hapur anash, të hollë, ngjyrë trëndafili, gati të tejdukshëm dhe Jona mendoi se mund t'i lëvizte si të donte. Kish pasur një shok fëmijnie që i lëvizte veshët ashtu.

— Mbaruar për sot, — tha ai me zërin e trashë monoton.

Jona rrinte e gozhduar në karrigen e veshur me mëshin të kuq. S'mund të kishin mbaruar kështu.

Ai u ngrit, i erdhi rrotull tavolinës dhe qëndroi me duart në xhepa e këmbë mbi këmbë në cep të saj.

— Mos u tremb, — tha ai.

Jona ngriti kokën. Iu duk sikur ai buzëqeshët, po tanë shihet turbull dhe foli me zë të shuar.

— Nuk trembam. — Ishte gati të qante, sic i ndodhë gjithnjë kur dikush donte ta merrte me të mirë.

— Ne do të mundohemi t'i shohim gjërat sic janë. — Zëri i tij kishte ndryshuar.

Jona u ngrit. Deshi t'i thoshte se edhe ajo atë kërkonte, po kishte frikë se mos i dridhej zëri dhe ngriti supet.

— Ditën e mirë, — tha dhe u drejtua nga dera.

Ajo shkeli në gjurmën e dritës që rëflektohej nga dyshemeja me kujdes, sikur trembej mos rrëshqiste dhe e ndjeu veten të lehtë. Mbësëvërtet do ta ndihmonte. U qe përgjigjur pyjetjeve turbull, tanë ndiente t'i kthjellohej koka dhe të shihet qartë sikur po dilte nga mijegulla.

Po të shkonte në shtëpi, babai do të gjente njeri ta ndihmonte. Po nuk do të ikte para së shtunës dhe u gëzua kur e mendoi. Do të rrjinte të priste Burhanin në korridorin e spitalit, mbase do të shkonte prapë në shtëpinë e gruas dhe prapë në hetuesi të nesërmen, dhe në kantier të ndreqte atë që qe prishur. Ajo qëndroi dhe u mbush me frymë, si një njeri që do t'i bëjë ballë detit.

Nuk donte të shkonte as në konvikt. Shoqet do të fillonin ta pyesnin. Vetëm Arjana do ta shihte me sytë e mëdhenj, me keqardhje dhe nuk do ta pyeste për asgjë, po do t'i bënte dëçka për të ngrënë dhe do t'i ndreqte krevatin. Arjana, me duart e këmbët e holla, me qafën e gjatë e buzët e trasha, si të kaprolles. Mbase e njihte Agronin. Po ta shihte ai, do të binte në dashuri me të. Patjetër.

Agroni priste poshtë në oborr.

— Si kaloi? — pyeti ai.

Vajza ngriti supet.

— S'besoj të të thérresin herë tjetër.

— Nuk e di.

Ata dolën në rrugë dhe ecën në krah të njëri-tjetrit. Jona ruante hijen e tij me bisht të syrit dhe ndiente gëzim që e kishte pranë. Po i zihej fytì dhe nuk do të ishte e zonja të fliste.

— Unë do të shkoj në spital, te Burhani,

— tha Agroni kur arritën në kryqëzim.

— Edhe unë. — Ndjeu se po skuqeji.

Ata ecën një copë herë pa folur. Në dy krahët e rrugës plepat e lartë të drejtë krijonin një perde që fëshfërinte me një mijë zëra. Vajza u ngazëllye. Hijet e trungjeve në rrugë afro-

heshin shjeki pas jetrit te kembet e saj. Mbase
ai i thoshtedit fejhe heshin. E mendpi dhe u tremb,
nuk donte foa thoshte tani.

I thoshehetuesit saunti je stazhiere,
foli Agroni issi. Më duket se ka ca ligje te tiera.
Ah! Për një çast Jona ndjeu t'i liron
kuptuar. Pastaj mendoi se qe njelloj si ata fe-
mijet qe bëjnë krimet dhe nuk mund t'i dënojnë
se pëse nuki jazë ligji. Ajo ishte më i padëmshëm
krimi pën këtë? Do të dojat të mos i shigë këto ligje. Kujt
dhia ngarkojnë fajin që duhej të mbaja unë?
Ty? Ajo fali me lidhërim.
Unë nuk jam pa faj, kam pjesën time,
sidonqë të vendosin për ty.
Atëherë do të mbash fajin për të dy dijet

Ai heshti dhe e vështroi me ngulm.

Jona deshi ta falenderonte por sic i ndodhte
shpesh, tha të kundertën e asaj që deshi!

— Nuk duroj kur më marrin në mbrojtje.
(Dhe nuk ishte e vërtetë.)

Ai mbajti kembet dhe e vështroi me dhimbje. I pa rrudhën e lehtë në mes të ballit. Ish-
te qesharake ajo rrudha në ballin e lëmuar si
një vijë en shkruar me laps. Nuk ne bëj pën ty, otha, e bëj për
veten time. Tiferdhi keq qët po e gjunjente
vajzen.

Ajo ngrihet syltë zgashti, po nuk kishte
egësi në vështrinimin e saj. Agroni pa lodhjen
në rrathët e nxirë poshtë syve. Lëkurë e kishte
humbur shkelqimin. Ishte zhgënjimi. Ai e kishte
mbajtur tërë kohën lidhur pas vetes. E afro-

nte me vrull, me ndonjë fjalë ku mundohej të vinte shpirtin, me shpresë që vajza ta shihte siç ishtë, pastaj e shtynte prapë. I dukej se ajo s'kuptonte kurrë gjë. Tani ajo e shihte me hidhërim, me dyshim. Nuk besonte apo besantë në ato që thoshte ai? Mbësë po largohej prej tij pa kthim.

— Sigurisht që nuk e bën për mua, — tha vajza ngadalë. — Ti do të bëje çdo gjë, për të qenë gjithnjë në qendër. Mund të prisje edhe duart e tua, vetëm që njerëzit të vinin gjithnjë rrotull teje, të lidhur, pa mundur të të afrohen dhe as të të largohen.

Ajo fliste për veten, po donte edhe t'i thoshte atij diçka të hidhur. Ishte e padrejtë dhe e kuptonte, donte t'i vinte faj atij për të fshehur dobësinë e vet.

Agroni u rrudh në fytyrë si nga një dhimbje e brendshme.

— Jona, nuk ka mundësi që ne të dy të mëremi vesh në ndonjë mënyrë?

Jona e vështroi me shpresë dhe tha prapë ato që s'duhej:

— Po, ka. Që unë të të them se që ditën e parë që u takuam... dhe ti të më thuash se nuk jam vajza që bëj për ty, se më mungon dinjiteti dhe secili të ikë në punën e vet, unë e mundur, ti triumfator.

Ajo ndjeu se po i dridhej mjekra.

— Mos fol më, Jona, se do të pendohesh...

— Sigurisht që do të pendohem, nuk është kjo që do ti? Që njerëzit të pendohen dhe të thonë gjithnjë që ti kishe të drejtë?

— Nuk të pyeta për atë.

— Po për çfarë më pyete? Tani mund të thuash ç'të duash. — Ajo po djersinte.

— Eshtë njësoj sikur të mos i kesh thënë...

— Jo, nuk është njësoj. Nuk e duroj më zemërgjerësinë tënde. Eshtë false fund e krye...

Ai i ktheu krahët dhe eci ngadalë në drejtim të spitalit.

Jona ndjeu t'i dridheshin gjunjët. Një nga shërim që po i shkundte trupin e bëri të lëvizte nga vendi dhe mbajti gojën me dorë që të mos bërtiste. U kthye mbrapsht dhe zuri të vraponte pa marrë frysë. I dukej vetja si një njeri në fund të detit që kërkon të ngrihet në sipërfaqe. E kishte ulur veten aq poshtë, ku do ta gjente forcën të ngrihej lart?

Drita e diellit që hynte midis trungjeve, i pulsonte në sy pareshtur. Kishte vâpë dhe ndiente djersë të ftohta. Tani ecte shpejt, po, për çudi, zuri të mendonte me qetësi. Ishte verbuar naa një dashuri e zjarrtë, si në filmat. Nga e njihte atë njeri? Pse i kishte rrahur zemra për të? Ai e kishte përbuzur, sepse e kishte kuptuar që ditën e parë dashurinë e saj. «Zemra ka arsuet e veta që arsueja nuk i nje». thoshte një mik i tyre, beqar i lashtë. E kishte lexuar te një shkrimitar i madh. Fliste për zemrën ai, që s'dinte ç'ishte zemra. Ajo kish thënë në shtëpi «Eshtë një inxhinier atje në kantier që më vjen rrötull». Kishte folur kof, për t'u llastuar, sepse ishte e bindur që çdo djalë mund të binte në dashuri me të.

Ndaloi dhe ndjeu turpin ta pështilltë të tërën. Vështroi rrötull me shpresë se mund ta shihet diku. Por ai s'qe gjëkundi. Iu shkreh trupi sikur

u lirua në kyçe dhe mendoi se kishte shpëtuar një herë e mirë nga ai pasion që po i kthehej në sëmundje. Po kishte shpëtuar vërtet?

Jona hyri në klub dhe i erdhi mirë që doktor Thomai nuk ishte në tavolinën e tyre. Kishte shkuar dhe rrinte i ulur, me karrigen të kthyer mbrapsht, në tavolinën e çiftit. Gruaja qeshtë me nervozizëm. Pinte duhan duke e mbajtur cigaren përpjetë e duke e shkundur pa pushim me gishtërinjtë e hollë. Frynte tymin lart, duke tendosur fytyrën që të dukej më e re dhe kishte marrë një shprehje sikur do të fillonte të kendonte.

Doktori kishte mbështetur mjekrën në shpinën e karriges dhe fliste pér gjahun. Burri i shihte herë njërin, herë tjetrin me një buzëqeshje të pakuptueshme, të skalitur në mjekrën gati katrore dhe s'merrej vesh në talje apo i vinte keq. Hijet luanin mbi fytyrën e tij.

Jona u ul në tavolinë dhe i foli Agronit duke vështruar jashtë:

— I pe ata dy pleqtë?

— Jo. Cilët janë?

— Nuk e di. Hera e parë që i shoh.

Ajo u kthye dhe e vështroi në sy.

— Mund të janë prindët e Burhanit. Më duket se i kam parë në një fotografi në shtëpinë e tij.

Agroni lëvizi në karrige.

— Burhani ka vetëm nënën në Përmet. Nuk i kemi thënë gjë.

Një burrë i veshur me xhupolëkure hyri me hapa të gjatë e i ra banakierit me pëllëmbë në gjoks.

— Ku je, arushë e malit? A i ushqeve pasagjerët e urbanit më të dalluar Tiranë — E?

— I ke të ngjeshur top.

— Bjer pak tagji për shoferin. — Ai vështroi rrötull dhe i qeshi sallës. Ngadalë folura dukej shkodran. Filloi të hante simite duke fryrë bulqitë. Dhe rrumbullakosur sytë si bretkë. Pastaj nxori nga xhepi i brendshëm një stufë me dokumente dhe zuri t'i plotësonë duke e mbajtur lapsin me katër gishtërinjtë. Të mbledhur, siç e mbajnjë fëmijët, e duke rixjerrë gjuhën që të shkruan te bukur.

— Unë do të kthehem prapë në kantier, tha Jona ngadalë.

— Agroni e vështroi dhe zgjati dörën imbi tavolinë, si të donte t'a prekte.

— Pyetë atë shoferin e autobusit mos ka ndonjë vend përmua.

— Do të bëhen mierak në shtëpi, tha Agroni dhe mendoi se kjo që gjëja e fundit që mund të thoshte.

— Nuk e dinë që kthehem sotë. S'u kam thënë.

Vajza dukej e qetë, po faqet i skugnин dhe i genë ndezur sytë.

— Shko sotë në shtëpi. Nesër në mëngjes kthehem bashkë.

Ajo tundi kokëna:

— Do të kthehem. Eshë më mirë.

Ai nuk foli më. Vajza donte vërtet të kthehej. Duhej të mbaronte punë me vëten. U ngrit dhe vajti të fliste me atë shoferin gazmor. — E marr posa, — bërtiti ai dhe tundi kokë fort, duke shikuar nga Jona.

Ata dolën jashtë dhe qëndruan në udhëkryq.

— Do të niset për një çerek ore, — tha Agroni.

— Oh, shumë mirë!

Jona vështroi rrötull. Dukej se mbrëmja kishte qëndruar në vend. Ai perëndim po zgjat tej tej muzgut. Prilli po shndërrohej në maj. Iu bë se ndjeu erën e detit.

— Desha të shkoja në shtëpi, — tha ajo ngadalë, sikur fliste me vete, — kisha shpresë se babai do të gjente njeri të më nxirte nga ky hall.

— E' di, — tha Agroni.

— Tani nuk dua të kthehem më. Vërtet. — Ajo u kthyё dhë ne vështroi drejt. — Më beson?

— Po.

Ajo vështroi katër rrugët që mblidheshin tekembët e saj. Iu dëk se i është mbrëmje kishte qëndruar aty, të shihte njerëzit, në atë nyjë ku lidheshin rrugët e tyre. Ata vinin, takoheshin, sikur ta kishin lënë atë takim prej kohe dheniknin prapë, nëpër rrugët e holla. Tani ajo kishte dëshirë të printe aty, të priste e të përcilëtë njerëzit nga njëri krah, në atjetrin. Kishte dashuri, të ngjitej diku, duke ardhur rrötull vëtes si në vorbull kurse ishin aq të thjeshta rrugët e hapura prej tyre. Këto dejet e dheut ngjanin si shtrafi i jetës që s'kishte të sosur kurrë.

— Jona...

Ajo qëndroi.

— Kisha dëshirë ta bënim rrugën bashkë, — tha Agroni.

Vajza qeshi lëllë. Nuk dëgjoi t'i trokiste zemra e as u inatos. Ai nuk luante më.

— Desha të të them diçka...

— ...

— Ke ndryshuar.

— ... po ... po nuk e di sesi.

— Do të ta them unë, po të mos mërzitesh.

— Nuk mërzitem.

— Mirë.

Ai ndezi cigaren dhe e thithi disa herë rrreshjt.

— Ti je mësuar të të shohin, të të admirojnë për atë që je dhe ato që bën. Po nuk e pranon këfë, sepse ke një sedër të sëmurë.

— Mbështet...

— Dhe në qoftë se njerëzit nuk kthehen të të shohin, atëherë bërtet, sillesh rrrotull vetes duke u djegur...

(Jona mendoi druvarin me këmbën e çarë. Kish bërtitur vërtet.) Ulikokën dhe nuk foli.

— ... Ti deshë që unë të bija në dashuri me ty menjëherë. Dhe ashtu ndodhi vërtet. Të dua edhe tani, fort, aq sa ti nuk je e zonja të duash. Po nuk t'u afrova, sepse ti nuk do të qëndroje me mua. Doje vetëm ta ndieje veten të adhuruar, të përkëdhelür. Do të ikje. Ske munduar ndonjëherë që mund të isha unë njeriu yt dhe mund të mbeteshe përgjithnjë pranë meje, larg babait...

Vajza ngriti kokën:

— Kjo... kjo... nuk është e vërtetë!..

— ... Ike nga punëtorët, sepse nuk duron të tē nënçmojnë, dhe po ikën nga Burhani sepse nuk sheh dot gruan dhe fëmijët e tij, që mund të tē quajnë fajtore. — Ai e preku lehtë me bërryl në krah. — Deshe të shkoje te babai që tē tē thosh «s'ka gjë, ti s'ke asnje faj për këtë, sepse ti je vajza ime dhe e bën çdo gjë mirë».

Ajo e vështroi e habitur.

— ... Dhe të ikje nga hetuesi, sepse nuk do tē marrësh vesh ç'faj ke...

Ajo hoqi flokët nga fytyra sikur kishte vapë dhe lagu me majën e gjuhës buzët e zbardhura.

— Jona... — ai e vështroi drejt. — Tani që do tē kthehet, do tē qëndrosh te Burhani?

— Po...

— ... dhe... tek unë?

Ajo e vështroi me një mall që nuk e fshihte dot dhe nuk mundi të fliste. Agroni e tërroqi në gjoks dhe e mbëstolli me krahë duke ndier atë trup tē dobët të dridhej nga ngashërimi. Vajza nuk e shqiste fytyrën nga këmisha e tij.

Nga klubi po zbriste doktori, që mezi përmblidhte qentë. Ai i vështroi i habitur, duke shqyer sytë, si t'i kishte dalë përpara një pre e ta kish gjetur pa fishekë. Nuk po i gjente dot fjalët. Tërroqi litarët e qenve, që qenë hapur në tē dyja anët e rrugës dhe foli me hidhërim:

— Më tradhtove, vëlla... s'kish nevojë tē më gënjeje, tē ma kishe thënë në fillim...

Agroni qeshi dhe e shtrëngoi vajzën më fort.

Jona vështron te nga dritarja e autobusit qiellin te mbushur the yje. Kishte shkuar drejt perëndimit dhe tanë po kthehej nga lindja. Ishte errur krejt, po qelli mbi horizont ishte i bardhë sic bëhet vetëm afër mëngjesit.

Shtriu këmbët dhe vështroi jashtë atë peizazh të errët, që sillej rrötull si në endërt. I fërgëllroi trupi nga një gëzim i papritur dhë nuk pombushej me frymë. Nesër ishte e premte, pastaj vinte e shtuna. Për herë të parë mendoi dhe u habit sa e thjeshtë që se e diela ishtë një ditë dhe e këna një ditë tjeter.

Scout Act, which was
defined as "any illegal or unauthorised act,
or omission, whether lawful or not, which
is done or omitted to be done in connection with any
activity, function or purpose of the Scout Association".
The definition also included acts which
were done in the course of carrying out its
functions, provided they were done in
connection with the Scout Association.
The definition did not include acts
done by a Scout in his private capacity.
The definition did not include acts
done by a Scout in his private capacity.

XIX ELLONJA

XIX ELLONJA

Agtronoma Abedini zbriti, ngadalé, shkallét, laboratorit dherishkoi gjaté serrés së itrendafilave duke zgjatur kakentë shihtë përtej xhamit të pluhunosur. Te portap e vogël qëndroi, irregullar mbi sy dy spalë gjyzylykë dhe hyrnik në serrë, përkulur. Në fund, të rreshtit qe një xwend bosh, i punuar imet, t' në mes të cilët rritej me frikë një këroeli si holle jeshil me majën ngjyrë kafe. Agronomia usul me injerin gju përtokë dher kerkoi me inqllëzat: et gishterin jve përgjatë kërcellit. Nuk kishte asnjë syth të ri, por do të lindnin brenda njavës. Nuk mundante, imenditët kishte pritur gjebijetë me padurim, mbaseqë i ri, kur zgjatej të degjontë hapat e së dashurës në lëndinë. Folt me zë të ulët, gati me lutje. Të sic do t'i bësh lulet me dy ngjyra, përndryshe, djemtë do jë qeshin me plakun. Dhe unë nuk dua të qeshin. Nëj serrë bënte mkehtë dher por i zihej frymat Doli, dher ishkoi ngadalë anës, gardhit. Plepat në lëndinë ishin tjet heshtur, në atë buzëmbrëmje të vaket, me degët të ingira, dher trungjet të perret, të vënat, në rresht, në largësi, agsë të spegullt, sa

herë-herë i dukej se do të lëviznin papritur. I pëlqente ajo lëndina pas laboratorit, e gjerë, e qetë si fundi i një liqeni. Aty do të ndërtonin korpusin e ri të fakultetit. Një ditë kishte parë të vinin rrrotull dy djem me instrumenta. Do t'i prisnin shpejt ata plepat e qetë, që duhej të qenë moshatarë me të. Patjetër do t'i prisnin.

Dy shpend të egër, të kapur njëri me tjetrin, ranë mbi lëndinë si të goditur, prekën tokën, pa staj u ndanë dhe ikën qiellit në drejtime të kundërtat. Nuk mundi t'i dallonte çfarë shpendësh qenë. Ai qeshi. Kishte qenë tërë jetën agronom, po dinte pak për shpendët, dhé, më e keqja, tanë-në fund i dukej se nuk po njihte as njerëzit.

Ai ngriti sytë drejt qiellit pâ i pulitur qepallat. Ishte një diell i kuq, që vinte duke u zma-dhuar sa më poshtë zbriste. Kaloi ngadalë nëpër rrugicat e kopshtit duke têrhequr hijen pas këmbëve dhe hyri në laborator duke fshirë këmbët në derë. Në errësirën e sallonit luanin vorbuj drite. Tha me vete se nuk duhej ta shihte më diellin ashtu, ndonjë ditë mund të mbetej i verbët.

Një grua trupvogël, që duhej të qe mbi pesë-dhjetë vjeçë, e veshur me përparëse, tê bardhë, doli duke sjellë rrrotull fundin e një provëze.

— Urdhëro, profesor!

— Më bën dot një kafe?

Kishin njëzet vjet që punonin bashkë. Ruzja nuk linte njëri në laborator të prekte gjë me dorë, ishte e sertë dhe e sigurt, po kur dilte ja-shtë, bëhej e druajtur si çupë dhe puliste sytë pa pushim, sikur e vriste dielli. S'kishte fëmijë dhe nuk qe martuar kurrë. Kishte sikur nga fshati

të bënte një kurs për laborante, me këpucët e të vëllait. Vëllai i madh, Avniu, furnitor në fermë, e kishte marrë që ta martonte e ta sistemonte në Tiranë. E kishte futur laborante në institutin bujqësor, po nuk kishte mundur ta martonte. Profesor Abedinin e donte me shpirt. Qante fshehur për të kur kishte ndonjë hall dhe gjëzohej kur e shihte të getë. Po kishte edhe një njeri tjetër për të c'lin Ruzja derdhë lot. Motra e madhe, Asimeja, që rrinte në fshat. Asimeja, me dy djem e dy çupa, kishte mbetur e ve pas çupës së dytë. Djemtë, të shëndetshëm e trup-mëdhenj, kur ishin studentë, vinin te tezja për ndonjë lek. I vogli kishte mbaruar për inxhinier pyjesh, kurse i madhi qe bërë veteriner, kish ikur nga fshati, pasi qe martuar dhe punonte në një institut në Tiranë. Tezja i mbante fotografitë e djemve në dhomën e vet, nga një në çdo faqe muri dhe të rrethuara me korniza të trasha druri. Nganjëherë thoshte se kishte bërë mirë që s'qe martuar.

Profesori rrinte në verandën e laboratorit dhe shihte si i ngulitur perëndimin e diellit, pa asnjë mendim tjetër. Ruzja qëndroi në derë me filxhanin e kafes në dorë dhe u kollit lehtë.

Ai u kthye me rrëmbim, si të qe thyer diçka papritur, po nuk dukej i inatosur. Fytyra e zeshkët i rrudhosej vetëm në tri-katër vija të thella si të prera me brisk. Ai nuk do të zhurosej edhe kur të shkonte 100 vjeç. Vetëm ato vijat do t'i thelloheshin deri në kockë.

— Si duket Lira? — tha Ruzja duke i zgjatur filxhanin.

Profesori ngriti supet.

— Nuk s'endis. Më shumë rribrënda. Hiqet si kur s'i këndodhur gjë. — Iu shfëngua gjoksi, siç i ndodhët shpesh kur mendonte pér të bijën. Kur që fejuar Lira, gratë e farrëfisit kishin thënë se kisha linidur me këmiskë. Ishte e zgjuar dhe e pashme, po dhëndri kishite qëlluar i rrallë, profesor në universitet, kandidat pér tituj, djalë i vëtëm, me shtëpinë vilë dhe me hënëndërit zoterinj, sidomos krushka, që ishte fa martoje edhe një herë. Me këtë rast agronomit i kishin bërë ca shakara pa lezet. Nuk i kishin pëloqyer as krushka, as krushku dhe mendohet pér djalifin. «Eshtë imë tri gjuhë», thoshtë një nuse xhaxlfai, duke vëre tregimishtërinjë pava gojës dhe pashëfisintë kur mendonte se skishite pasur fat pér dñehën e saj, që ishte imë një gjuhë te vëtme. — Profesori i spikte këtë gjë Tani e gjithë kjo kishite marrë fund. — Profesori Prifti kafen dhe u kthyë nga Turqja. — Është një vëllim qëndrueshëm.

— Më duket sikur më vajti dëm ajo vafzë, tha dhe iu drodh m'iekra. — Puhë e fixituar. — Rusja e veshtroi me kësardhje. — Unë nuk i kuptoj këto gjëra të nxituar, — tha ajo duke shku ndur bërbërësen kof dhe mendoi më krenari e më hidhërim se s'i kishite ndodhur kurre ne jetë të nxitohej. — As unë — tha profesori duke tundur lumen e filxhanit dhe rrudha, në ballë iu bë si e therur. — Por unë mund edhe ta kisha ndaluar... — Nga poshtë erdhë zhurma e ngjiruri e triçklit të Mironit, aë humbiste në kthesa sikur e frynte era. Profesori u ngriti tinga m'ekolli

— Erdhi-djali, — shā
Ruzja ūzgjat tē shihte.
— Avniū tē pret nidoňje dite, tē shohesh rru-
shin, — tha'ajo.

— Do shkoj patjetër. Më ka marrë malli për Avniun. Motori doli spapritur në mës të shkurreve; i erdhë rrrotull oborrit si pulë e streibur dhe ndaloj në çast te këmbët e tyre. Është dojvina e tij Mirëmbrëma, — i tha djali paozbritur, si uingryse, teto Ruze? — I kishte gjithë shkatërruar — Mirë, faleminderit, ti si jë? Vërtet qëndri

— Ndore dite do na hipesh me motor nepër shkallë, — tha profesori duke ngjeshur në koke një kapelë që s'mund t'i thoshe «republikë».

Në shtëpi nuk ishin zgjuar akoma, por i dukej se kishte dëgjuar një gërvimë dere kur kotej në atë éndërr të lumtur. Ishte një zhurmë e gjallë, si ai shtrëngimi i dorës, nuk qe zhurmë éndrre. Shtëpia merrte frymë.

Poshtë në oborr u ndez triçikli i Ronit. Ajo buzëqeshi, shtriu këmbët fort dhe iu duk vetja e gjatë. Lira drithërohej për të vëllanë. Mironi ishte tre vjet më i vogël, po kishte filluar punën si elektricist sa mbaroi teknikumin, d.m.th. i kishte dalë vetes zot. Ditën e fejesës ai i kish thënë Lirës «Nuk e kisha menduar kështu burrin tënd», pastaj qe larguar dhe e kishte vështruar tërë kohën me sytë e mëdhenj të trishtuar. Ajo nuk e kish pyetur dot atë ditë «si e kisha menduar», dhe më pas qe ruajtur të mos mbetej vetëm me të. Mironi ikte mëngjeseve herët dhe kthehej në mbrëmje me babanë pas vetes. Kishte ditë që nuk shiheshin fare dhe Lira ndiente mall si për një njeri të humbur. E përgjonte fshehu-razi kur pastronte triçiklin poshtë në oborr dhe mbante gjuhën që të mos e thërriste. Nganjëherë ai ngrinte kokën sikur e dëgjonte atë thirrje pa zë dhe qëndronte pa lëvizur, i përqendruar, si atëherë kur qe fëmijë dhe luante nën tryezë më lodrat e tij. Lira ia mbante mend kaçurrelat e verdhë pas zverkut.

Tani ai qe rritur aq, sa mund të mos ndiente mall për motrën.

Lira u ngrit dhe u afroa në dritare. Kishte dëshirë të shëtiste nëpër qytet, të takonte shqet, Mironi nuk ishte poshtë. Dy muaj ai kishte hyrë e dalë në shtëpi si një njeri i ndryshuar. Një mbrëmje kish pushuar së renduri. Kishte

kérkuar nënën, babanë dhe Lirën të uleshin e ta dëgjonin. Kish thënë, duke u munduar të dukej i qetë, se ai Stilian Teroja s'mund të ishte më i fejuari i motrës së tij. Ai qe shtirur i fejuar që para se të merrte Lirën, kishte thënë se për dy javë shkonte në ambasadë dhe prandaj e kish kérkuar celebrimin me aq ngut, sepse duhej të quhej i martuar. Pastaj kish thënë, duke ulur sytë, se kishte një fëmijë ilegal me një balerinë, që mund t'ia hidhte në erë ambasadën e gjithë të tjerat dhe se ai mund të merrte çdo vajzë që t'i dilte përpara për t'u vënë kapak gjërave. «Kjo është një budallaqe», kishte thënë më në fund duke treguar me gisht Lirën.

Lira u afrua te pasqyra dhe u pa duke lëvizur shpejt sytë e tërhequr si të një mongoli. Nga afër i dukej vetja e bukur, me lëkurën e hollë ngjyrë gruri dhe bebëzat e çelëta gati të verdha. U largua dhe e pa veten të egër, siç do të ishte pas disa vitesh, me mollëzat e kërcyera, lëkurën të futur gropë pas faqeve e gojën e madhe. U rrrotullua rrreth vetes dhe eci me nxitim nëpër dhomë. Bëhej nervoze kur shihej gjatë në pasqyrë. Kishte më tepër trupin e një djali se të një vajze, e hollë, gjithë nyja, me gjoksin të vogël dhe vithet të ngushta. Nuk gjendej një fustan që t'i rrinte mirë. Nëna kishte pasur gjithnjë frikë se mos mbetej pa martuar. Ajo kish qarë atë natë që vendosën të prishnin fejesën dhe ditët e tjera, sa herë gjente kohë. Thoshte se i ranë së mirës me shkelm dhe nuk kuptonte gjë në kishte ardhur përpara fejesa apo ambasada. Njësoj ishte. Pastaj, të gjithë djemtë, para se të martohen, kanë ndonjë vajzë...

„Po nëna kishi pushuar së qari atë ditë që kishte ardhur përnjë vizitë hakmarrjeje shoqja Tonë, nëna e Stilianit. Ajo kërkoi pa u skuqur t'i kthenin dorovitë e fejesës, se do t'i duheshin prapë. Ishte e veshur me një kostum kafe prej stofë të shtrënjtë dhe mbante pamjen e një, nëne të plagosur e tepër të fismës. «Na prishët avenirin e ndjalit», kishte thënë ajo duke tundur para fytyrës së ish-krushkës një gisht të hollë e të gjatë. «Këtë nuk ju fal kurrë. Kurre!» Pastaj kishte ikur me kokën përpjetë, po në derë që kthyer prapë dhe kishte thënë, duke hedhur pas me përgjim flokët e lyer: «Djalit im dë të gjejë një më të mirë se vajzen tuaj, siç bëdhe e meriton. Dhe shumë shpejt bile!»

Qe dashur i kjo vizitë që qëndronte pushonte së pshëretiri. I kishte ardhur indot nga ajo lloj kru-
shke, që është më i vjetri i njëj. Ky i
Lira u veshengadalë dhë kreku me gishterinj
flokët e prerë shkurt. Atë muaj e kish parë Stilia-
nin vetëm një herë së largu, i kishte rrahur zemra
fort, po nuk kishte kuptuar nëse nga malli apo
nga fyterja. E kishte dashur atë njeri? U

Ajo doli nga dhoma më nxitim. Në korridor pa Mirenin që rrithë më duart në xhëpa, i veshur
me xhup dhë më kasketën në kokë. Po e priste.

— Unë, unë... kujtova se kishe ikur.
— Je zemëruar me mua? — Ai e vështrot me
merak, me buzën e poshtme të varur, si atëherë
kur ishte pesë vjec.

— Jo... tha Lira dhe ndjeu se do të qante,
po nuk arrrij t'imbush mendjen vetes se shpë-
tuam nga një e keqe.

— Shpëtuam, ta ihotë vëllai ty.
Ajo i zgjati krahët dhe e përqafoi me mallin
e tre muajve.

— Tricikli që çonte në fermë agronom Abedinin
dhe dy fëmijët e tij, fluturonte në rrugën buzë
lumit. Një dy herë desh u futën nën rrrotat e sko-
dave. Lira mezi mbahej pas të vëllait të mos
përmbyej në kthesa. Profesori pa orën dhe mati
me mend rrugën e bërë. Ai vështroi me habi
djalin në timon, që këndonte dhe shtonte gazin.
Vajza ishte e heshtur.

— Ore bir, duhet të vemi shëndoshë te miqtë,
— i thirri djalit fort.

— Po ju çoj si të jeni shportë me vezë, shoku
agronom dhe shoqja mësuese, — u përgjigj djali
dhe uli pak shpejtësinë.

Profesori vështronë ujin e lumit që ndriste si
zhivë. Dukej se drita e paktë e pasdites buronte
prej tij. Ai u kthye brinjas që t'i ruhej erës nga
xhami i thyer, që i kthehej në kurri, sikur e
godiste njeri me pëllëmbë. Kjo erë e marrë s'e
linte as të mendohej. Vështroi profilin e errët e
të pakuptueshmët të vajzës me flokët e shkurtër
pas zverkut të hollë. Nuk kuptonte kurrë q'men-
donte vajza, sidomos po ta shihte në profil. Nuk
kishte kuptuar kurrë q'mendonin fëmijët e tij.

Ata i erdhën rrötull kodrës sikur i ngjiteshin
një kërmilli gjigant. Disa gra, që zbritnin me ko-
shat e rrushit në duar, u hodhën në kanal t'i hap-

nin rrugën asaj furtune të vogël. Mironi shkeli gazin, u ngrit në këmbë dhe qeshi duke çuar kokën përpjetë. Mund të fluturonte me gjithë motocikletë.

Nga poshtë shtëpitë dukeshin të vogla, sikur rrinin ngushtë mbi shkëmb. Po kur u ngjitën lart, një lëndinë e butë, e gjelbër, gjithë dritë, hapej para shtëpisë së Avniut.

Avniu i priste në derë. Ishte i shkurtër, me këmbët të trasha, me ballin të ndritur. Gëzohej përmiqjtë dhe qeshte me buzën e gjerë. Në krah të tij rrinte Ruzja, e veshur përfestë.

— Ju pashë që poshtë në rrugë, — tha Avniu dhe bëri përpara. — Urdhëroni brenda!

— Rrimë këtu në verandë më mirë. Është fresk, — tha Abedini.

Avniu i bëri vend agronomit dhe afroi karrigen përvajzën.

E zonja e shtëpisë doli me vrap nga dera dhe iu turrë miqve. I shtrëngoi të dyja duart profesorit dhe u zuri frymën fëmijëve duke i puthur nga katër herë në çdo faqe, me një lumë urimësh.

Abedini po bisedonte me Avniun. Lira qëndronte më sytë nga kupa e ndritur e qiellit që po përmbysej në një krah. Asaj i mbeti në sy njolla e gjelbër e diellit, pastaj zuri të shihte rrullin.

Kur ishte e vogël, Lira vinte gjithnjë në vilën e fermës, te xhaxha Avniu, vëllai i tetë Ruzes. Teto Ruzja i kërkonte leje babait tri ditë përpara dhe Lira bënte gati rrrobatë saj në një valixhe të vogël, me një çelës sa maja e thoit. Xha Avniu i priste gjithnjë në verandën para shtëpisë, por

atëherë nuk ishte aq i trashë dhe ballin e kishte më të vogël.

Ato rrinin të dyja në një dhomë që dilte mbi verandë. Ishte dhoma më e bukur që kish parë, me një qilim të shtruar cep më cep, me një shtrat të madh dhe një më të vogël. Po, në atë dhomë mund të flije edhe përdhe, me velenxat afër oxhakut. Më shumë se çdo gjë Lirës i pëlqenin gjethet dhe lulet e thara, të vëna në herbariumet, që mbanin erë të këndshme. Teto Ruzja i lexonte emrat e luleve e të gjethive, ca emra të gjatë, si të lidhur me nyja, pastaj qeshte dhe thoshte një emër të vogël, që Lirës i pëlgente shumë. Teto Ruzja i thoshte se do ta conte edhe në fshat, tek e motra, por ai fshat ishte shumë larg dhe nuk e kishte çuar kurrë.

Mironi po lëvizte në karrige. S'rrinte dot gjatë në një vend. Një vajzë fytyrërrumbullake doli nga salloni me një tabaka me rrush dhe qëndroi në cep të verandës, e druajtur. Kishte ëmbëlsinë e hijes. Rrinte mënjanë dhe priste me sytë e thellë e të butë, me trupin të përkulur përpara, sikur trembej se mos i derdheshin rrushtë. Supet e rrumbullakëta i kishte të rënduara sikur donte të përbante një ngazëllim të brendshëm.

— Hajde, moj Zanë! — tha Avniu. — Eshtë vajza e baxhanakut.

Vajza buzëqeshi me dhëmbët e bardhë. Ajo latabakanë mbi tryezë dhe vështroi vjedhurazi Mironin, duke lëvizur me shpejtësi sytë e zez. Rastaj, iku duke shkelur lehtë me këpucët atlete në drejtim, të barakës, në fund të oborrit.

Djalit i qe ndezur koka nga era e dielli. Ai ndoqi me sy vajzën që, në qellin e kuq

te pérëndimit, duket e perrët dhe e vogël si një zog nate. Ndjeu t'i turbullohej gjaku. Agronomi pyeste pér rrushin dhe shihte Avniun në sy.

Mironi mori fryshtësi thellë dhe ngriti fytyrën lart. Ndjeu një gaz si një mall të largët pér netët e vëres në vogëli, kuri përgjonte qelli në muzg derisa të ndritnin jetët dhe rrinitë i numëronte. Që e vëtmja gjëriqë mund ta mbante Mironin në vend. Atëherë qelli i dukej i afërt sa mund t'i arrinte me duar zjarret e tij.

Agronomi rrinte me bërrylin e ngulur në tryezën prej kashte, kurse dorën e imbladhur pas faqes e kishte shtrënguar fort, qsa i zbardhë si gur.

M'u bë qejfi që erdhët sonte, tha Avniu pa ia shqitur sylt profesorit, duke usur zërin sikur kerkon të ndjesë që foli ose Profesori më i një vilë rrush, e solli një çopë herë në duar, njerëz, pastaj hengri një kokërr dhe tha:

Duhej të kishte më shumë skedë. Avniu ndenji në majë të karriges si shkollar:

Morem më shumë prodhim këtë vit, po cilësia... — tha ai.

S'kam ngrënë ndonjëherë rrushinë të embël, — tha Mironi, si pér t'i dalë në krah Avniut.

Agronomi ktheu kokën dhe e pa me habi. Djali u pendua që foli. Lidhja e tyre kishte diçka përtëj asaj që shihte ai.

Një "djale" trupmadh po ngjitej kodrës nga-

dalë në drejtim të tyre. Kur i pa, ai buzëqeshi dhe shpejtoi hapin.

— Mirë se erdhët, — tha ai duke i dhënë dorën profesorit. E kishte zërin të plotë e të ngrrohtë dhe Lira ndjeu vapë. E njihet atë timbër, ishte i afërt si zëri i një shoku fëmijnie, i bërë burrë papritur. Ai i zgjati dorën, një dorë të madhe e të thatë dhe ia shtrëngoi fort sikur do t'ia shkërmonte gishtërinjtë e hollë. Ajo vështroi rrëshqitas siluetën e errët të bidjalit. Diçka vezulloi në fytyrën e tij.

— Është Dani, djali i motrës sime, së madhes, Asimesë, — tha Ruzja. — Inxhinier pyjesh.

Lira ngriti kokën me vrull.

Dani rrinte në hije, me duart lidhur mbi gjoks. Ai i tundi kokën lehtë dhe qeshi. Lira s'e kishte njobur, por ai qe një njeri i afërt, që po kthjellohej si t'i hidhje dritën sipër. Mbase kishte dymbëdhjetë vjet pa e parë. Herën e fundit kishin lozur bashkë, pastaj ai e kishte rrahur dhe vajza kishte qarë me zë të lartë që ta dëgjonin. Ai qe trëmbur dhe e kishte marrë me të mirë, e kishte puthur në faqe me buzët e plasaritura. Ishte Dani pra, që rrinte në atë fshatin e largët, ku teto Ruzja s'e kishte çuar kurrë.

Lira u ngrit dhe i zgjati dorën prapë.

— Ti je Dani?

Ai qeshi duke i shtrënguar pëllëmbën fort.

— Ti je Lira?

— Të kam borxh një të rrahur, — tha vajza.

— Ai e vështroi drejt, nuk qeshte më. U ul dhe lidhi duart mbi gjoks.

— Zonja e shtëpisë dhe Ruzja sollën mezet e rakinë. Avniu i nxiste miqtë të hanin duke marrë edhe vetë nga pak. Fliste për rrushin e perimet duke vështruar profesorin me merak, si të kërkonte miratimin e tij për çdo fjalë.

— Profesori qe mbështetur në jastëkë dhe përtypej ndadalë. Majat e gishtërinje, të pugura sikur mbante një top në duar, i trokiste lehtë me kadencë. Mbështetje kohën midis asaj që thoshte Avniu dhe mendimeve të tij.

— Hajde ndonjë ditë të shohësh rrushin në parcelat e institutit, — tha profesori.

Avniu tundi kokën i bindur si shkollar.

Dani u ngrit të mbushte gotat e të pastronte tavllat e duhanit.

— Kam qenë në pyjet tuaja vite më parë, — tha profesori duke e ndjekur djalin me sy. — Edhe në Llogara. — Dani e vështroi duke nënqeshur.

— Më duket se s'ja bëni shërbimin tamam. Bëhen ca gabime që duan mbas 100 vjet, të ndreqen.

Dani u mendua. Pastaj zuri të tregonte ngadalë për pyjet me pishë, për pyllëzimet e reja e dëmtuesit, për prerjet.

Lira e vështronë me qetësi. Habitej si mund të dilte ai zë i trashë nga qafa e hollë, ku molla e Adamit dukej sé do t'i çante lëkurën.

Dani heshti, duke menduar se profesori po mërzitez. Ai e kishte humbur gjallërinë dhe tani dukej krejt i plakur.

— Keni vënë bletë në pyje? — pyeti pa-pritur profesori.

— Po, po.

— Bleta i duhet pyllit.

— Andej nga ne kullotin në sherbelë. Mjalti ka një si shije të hidhur, po të mirë.

— Kur të vish ndonjë ditë në Tiranë, do të të jap një libër për pyjet. Mund të të duhet.

Profesori u ngrit ngadalë, duke u mbajtur në cepin e tryezës.

— Dalim njëherë në vresht, — i tha Avni-ut duke hedhur xhaketën krahëve dhe zbriti i pari në udhëzën e bardhë. Mironi u vajti pas.

Dani e shihte Lirën në sy dhe nuk qeshë. Pastaj foli duke ulur zërin sikur ruhej të mos e dëgjonte njeri.

— Të pëlqen që do të jesh mësuese?

Lira tundi kokën pa thënë as po as jo.

— Të pëlqen pylli? — djali kishte ngut.

— Shumë.

Ai vështroi rrotull sikur trembej mos vinte njeri. Vajza ndjeu se po skuqeji. Donte të ngri-hej, por ai njeri, me vështrimin e butë, bojë qelli, e mbante si të mbërthyer.

— Po të vijë ndonjëherë babai, do vish edhe ti të shohësh pyjet tona?

Ajo deshi t'i thoshte se nuk do të shkonte kurrë dhe i vështroi me përcëmim këpucët e trasha me qafa, ku mungonte njëra llapë, Djali i dukej i pacipë. Pse fliste me zë të ulët? Po të kish qenë aty babai ose Mironi, nuk do të guxonë t'i fliste ashtu. E ndjeu veten të fyer,

uq ngriti dhesi erdhin rrrotull. Pastaj foli me zë të lartë, duke e shikuar djalin nga lartë.

— Edhe mund të shkoj ndonjëherë. Pyje ka kudo... me babanë osë... me ndonjë njeri tjetër. Djali shihte vajzën pa së fshehur. I vinte keq për të. Dukej nervoze si i ati, gjithë deje e nyje, po ata syltë shpejtë, po ajo fytyrë e prejtë. Dukej sikur vajza s'fiste kufirë dhe ishte lëvizjë të pakontrolluara, sikur pengohej diku, si një mëz që i kanë lidhur këmbët. Një tufë flokësh të pashtuar, si të djemve, i ngrihej në majë të kokës. «Mbase dó të qëtësohej po të vrapi me kalë», tha djali me vete dhe u ngrit. I vinte keq që e mërziti.

— Do të shkosh brenda? — tha ai. — Teto Ruzja është aty.

— Po, — tha Lira dhe u drejtua nga dera. Nuk donte të rrinte vetëm me të.

* * *
Stai vërtet qëndronte në ballkonin e dhomës se saj dhe vështronë lëndinën e vogël, ku dy fëmijë ndiqnin njëri-tjetrin. Ndiente një dhembje të lehtë pas kokës e në temthë. Një vajzë e vogël hidhej si zog, pa qëndruar dy sekonda në një vend. Lira u zgjat të shihte dhe thirri:

— Lira! — Ishte Lira e vogël, që e sigurt, po vajza vazhdoi të luante duke u sjellë rrrotull vetes.

Ajo u kthye dhe hyri në dhomë. Nuk ishte

nga atë tipaqë ëndërrojnë hqatë. Kishte një muaj që e kishte prishur fejesën, por që ende në martuar. Stilianini vononte formalitetet që të ndreqte punët ne tij. Po të kish dashuri ajo, tani mundotë ishte diuksushëtitur në Indonjë. Nga kryeqytetet e Evropës. Libri që iku i cili, Lira solli ndër mend ditët e furishme të fejesës. Nuk kishte pasur kohë të ndalej, e të mendohej. Ky ishte njëriu i saj? Stilianin e të hiqte dhë ajo bridhë pas tij si parqe, kafene, në gasti te tezet, te mbesa e nënës, e babait, e lumturi, krenare përburrin që kishte në krah. Tani qdo gjë ishte shuar si një film i prerë, në mës dhi dukej se rrinte në të errët, e ulur në boshllék. Nuk mund të rrinte në shtëpi dhe as dönte të dilte. Mbështetë që më mirë po të kishte dhembje dikur në trup, po nuk i dhimbte asgjë. Nuk ishte më e zonjatë shihdhertohej dhe nuk i vinte për të qarë. ëp

Mendoi se qe nxituar kur qe fejuar, qe dukur gjëja imësë e thjeshtë. Mbështetë u nxitua edhe tani që u nda. Ajo kujtoi natën e fundit që kishte genë me Stilianin, dhe ndjeu një farë neverie... Ata shëtitën si cdo natë në kodrat e Rrugës së Elbasanit, pastaj zbritën në shëtitore. Vajza ecte shpejt, gati me vrapi, duke u kapur fort pas krahut të tij. Nuk dönte të ulej gjëkundi. Stilianin e veshtrohte me bisht të syrit. Edinte se, kur ishte nervoze, qe më mirë të mos fliste. E linte derisa ftohej ngadalë, ndryshtë mund ti hapte andralla vetes. Ai po mundohej të gjente ku ia kishte prishur qejfin, duke rruajtur profilin e saj, po vajza kishte qepur buzët e dukej se s'do të hapte gojë.

Më në fund qëndruan në parkun «Rinia» dhe Lira u lëshua e këputur në karrige, duke marrë frymë me zor. Stiliani u ul përballë dhe priti të qetësohej duke e shikuar me merak.

— Pse nuk fliste ai, pse nuk e pyeste? Ajo filloj tē bëhej nervoze përsëri. Ku i kishte lodrat son-te? Ai po e duronte siç mund tē duronte një fëmijë dhe mbasë e quante tē papjekur, tē paden-jë pér t'i kërkuar e pér t'i dhënë shpjegime. Lira mezi përmblahej. Kishin shumë gjëra pér tē thënë, por ai e vështron te me një buzëqeshje tē sëmurë, si një i shurdhër, që mund tē dëgjojë vetëm zërin e arsyes së vet. Lira ndjeu se po i mbusheshin sytë me ilot. Kishte bërë një gabim që s'ndreqeje më. Nuk mund tē kuptonte ç'mendonte ai njeri pér tē, mbasë pér tē vetmen arsyë që ai s'mendonte asgjë pér tē. Si ishte dashuria e një tē shurdhëri?

Kërkonte më kot që ai t'ia thoshte gjérat vetë.

— Ajo u ngrit përgjysmë dhe bërtiti fort;

— Çfarë ke? Pse s'flet?

Ai ngriti vetullat i habitur dhe e vështri i trembur me sytë e bukur me qerpikë tē dendur, Nuk nxehet kurrë dhe mundohej ta kalonte çdo gjë me atë buzëqeshjen pa ngjyrë.

— Më dhëmbin pak grykët, — tha duke u gëlltitur, që t'i tregonte se i dhimbnin vërtet.

— Aha! — Ajo mendoi se nuk do tē mund ta tërhiqte kurrë në një grindje. Ai kishte qejf tē hiqej i sëmurë, nuk i duronte dhembjet në trup, sido që thoshte se i duronte shumë.

— Ikim në shtëpi, — tha Lira dhe u ngrit.

Ai nuk kundërshtoi, u ngrit pas saj dhe e zuri nga krahu lehtë.

— Cfare ke, Lira?

— Unë?... Asgjë... Asgjë, vetëm se... — Ajo ishte e tendosur sa mund të këpuntej në mes.

— Vetëm se?!

— Ulemi këtu, — thashajo dhe shkoi në tryezën pranë. Ai e ndoqi.

— Po sikur të ndahemi? — tha Lira duke e vështruar drejt në sy.

Ai vështroi rrötull me atë buzëqeshjen që i që ngjitur në fytyrë tërë darkën dhe i mori dorën. Kishte vërtet pamjen e një të sëmuri. Ajo ndjeu si i dridhej lëkura e njomë e pëllëmbës dhe deshi ta tërhiqte dorën. Ai nuk e fshehu dot frikën dhe tanë kishte një pamje budallai.

Vajzës i erdhi keq, po tanë skthehej dot mbrapa. Deshi ta shihte atë njeri në fund të shpirtit. U përkul përparrë, me sytë të frikësuar. Si mund të ishte një burrë me një gjoks aq të ngushtë? Duhej ta kish pasur të paktën tri herë më të gjerë. S'e kishte vënë re më parë.

— Po sikur të të lë? — tha prapë ajo.

Ai nuk qeshte më. Lëpiu buzët e lagura me majën e holë të gjuhës dhe foli duke rrrotulluar sytë nga tryezat përreth, sikur kërkonte ndihmë:

— Ti... ti s'mund ta bësh atë! S'mund të më bësh, kështu! — Tani s'e fshihte më frikën. E vështronë, me lutje, e kërcënëm dhe i shtrëngonte dorën me ngërc.

— Po e bëra, do të jetë njësoj keq si për ty edhe për mua. Pse nuk thua gjë për mua?

— Po, po, sigurisht. Edhe për ty është shumë keq, po sidomos për mua, unë shkatërrohem krejt...

Ajo filloi të qeshte ngadalë, po me nervozizëm, duke u penguar sikur po e shkundte lemtza, pastaj u ngrit në këmbë dhe qeshi fort me zë të lartë.

— Lira! C'bën kështu? — Ai e shihte gojë-hapët. — Lira!

Ajo i kishte sytë me lot dhe dridhej e tëra. Stiliani u ngrit dhe zgjati duart sikur kërkonte ta mbante.

— Lira, c'bën kështu? Mbaje veten, jemi në lokal. — Tani ai fliste me gjakftohtësi, duke parë anash, dhe ngrinte supet duke kërkuar të shfajësonte veten. Vajza e vuri re atë shenjë të lehtë të supeve drejtar publikut. Foli me zë të ulët, të gjerrë, duke fërkuar fytin me gishterinj:

— Domethënë s'ke gjë për të më treguar. Mos më thirr Lira... dhe mos më hajde pas... dua të iki vetëm.

Ajo i ktheu kurrizin dhe iku me vrap, duke u penguar nëpër karrigjet metalike. Aq i bënte për njerëzit, aq i bënte për çdo gjë. Jeta e saj qe përmbysur. Po tani nuk i vinte keq për këtë, donte të shfrynte millefin. Ktheu kokën me shpresë se mos ai e ndiqte, por e pa të ulur aty ku e kishte lënë dhe mbase qeshte për t'u dukur, duke vështruar klientët e tavolinës ngjitur. Po mbase edhe nuk qeshte. Trembej për veten.

Gjithë rrugës Lira nuk qe e zonja të mendonte asgjë. Kur arriti në shtëpi, ngjiti shkallët me një frymë dhe ndaloi në derë. E kuptonte gjithnjë kur kishte njerëz të huaj në shtëpi. Dikush po ngjitej nëpër shkallë, dukej që kishte një pafkë të vetme në këpucë që e trokiste si bastun. Ajo hyri pa zhurmë, mbylli derën pas vetes dhe u mbështet. Kishte vapë. Hoqi sandalet dhe hyri në banjë të lahej. Çfarë bënte Stiliani tani? Rrinte akoma në lulishte? Mbase ishte duke ardhur këtu. Tani Lira nuk donte që ai të vinte. Le të shkonte të qante tek e ëma, te shoqja Tone. E quanin Antuaneta vjehrrën e saj, po kishte dashur t'i jepte emrit një tingëllim populor dhe e kishte shkurtuar vetë. Don'te të dukej grua e thjeshtë. Shoqja Tone. Lira u fshi me peshqir fort dhe zuri të djersinte përsëri. I dukej se ishte ngushtë kudo që rrinte. Doli duke krejt flokët me gishterinj dhe hapi me vrull derën e kuzhinës. Do t'u thoshte se kishte marrë fund...

II

Në shtator Lira kishte filluar punë si mësuese kimie në një shkollë në periferi.

Kishte ndryshuar, sikur koha e saj të qe ndarë më dysh. Në mëngjes ishte njeri tjetër, shkonte në shkollë me gëzimin e fëmijëve. Në drekë i kthehej trishtimi si të vishte një rrobë të vjetër të irnosur. Nuk kishin të sosur ato pasditet

e gjata, me gjumin e drekës, me grilat të ulura. Një kafe në orën gjashtë, darka në orën nëntë.

Nganjëherë, në atë lloj muzgu të zgjatur sillte ndër mend atë mbrëmjen në vilën e fermës dhe ndiente në gjoks ca goditje të shpejta, të forta. Ishte si të ndizte një dritë në të errët, që zvogëlohej e shkëlqente sa më shumë largohej, si një imazh i ndritur i myllur në qelq që s'i përkiste më asaj. Kur kishte parë nga maja e kodrës diellin t'i rrokullisej poshtë këmbëve, i qe dukur vetja për një çast si zonjë e botës. Tani e shihte përmes grilave të copëtar në rripa paralelë.

Një të shtunë Lira u kthye nga shkolla më herët me shpresën se do ta gjente nënën në shtëpi. Ajo kishte tri ditë tek e motra në Përmet dhe as Lira, as babai nuk rrinin dot pa të, sidoqë, kur ishte në shtëpi, i thoshin tërë kohën «hesht!», se s'i linte të lexonin, duke treguar historitë e mëhallës.

Lira u ngjit në shkallën e errët dhe mendoi se prej këtej niste trishtimi. Cili qe ai arkitekt që i kishte bërë shkallët si pus? Në katin e dytë, te dera e elektricistit, drita e kuqe e ziles, që rrinte gjithnjë ndezur, i kujtonte radiografinë. Një mësues në shkollë kishte thënë se gjysma e trurit të njeriut ka të bëjë me gjëzimin, gjysma tjetër me trishtimin, prandaj ftyra nuk është kurrë simetrike. Lira hyri në shtëpi dhe u erdhi rrrotull dhomave ngadalë. S'kishte dëshirë të pastronte. Kur ishte vetëm, shtëpia i dukej shumë e madhe, kur ktheheteshin të gjithë, s'gjente vend ku të rrinte. Ajo mbeti në sallon me duart në mes.

Një ditë kishte shkuar te Ruzja në laborator. Ajo e kishte pritur me gjësim. «Kur ke ardhur këtu herën e fundit, e kishe fustanin dy pëllëmbë mbi gju, mban mend?» i kishte thënë ajo duke e përqafuar. Pastaj e kishte gostitur dhe kishin dalë të shëtisnin në serrat e luleve. Ruzja i mblođhi një tufë trëndafila duke i prerë e pastruar me një gërshërë të vogël, pastaj e kish përcjellë deri poshtë në stacion, në rrugën përmes pyllit të vogël, duke iu rënduar vajzës në krah. Dukej e gjuar vërtet dhe tërë kohën mbanente fytyrën lart të nuhaste ajrin e pyllit. «Të shtunën vjen Dani», kishte thënë ajo kur Lira po ngjitej në autobus. Lira qe kthyer me nxitim, por i kishte parë vetëm flokët e bardhë të mbledhur në zvërk dhe shpatullat e bëshme, tek largohej. Më mirë. Ajo e kishte kuptuar, pra...

Lira ndjeu se po skuqej tek rrinte në mes të sallonit me duart në mës.

Mbase ishte më mirë të dilte, por duhej të gatuante drekën. Në shkallë dikush ngjitej me nxitim. Vajza u largua nga dera, e trembur, pastaj u hodh dhe e hapi para se njeriu të trokiste.

Dani qëndronte në derë dhe buzëqeshëte, sikur ta dinte që ajo e priste.

— Urdhëro, — tha Lira, po nuk lëvizi nga dera. E kishte pritur dy muaj, duke e përfytruar takimin me një mijë hollësi, duke u turpëruar nga vetja. I kujtohej turbull që e shihte veten të gjatë, shumë më të gjatë se ai, kurse ai tani rrinte me kokën në trarin e derës, i buzëqeshëte nga lart dhe priste. Çfarë priste ai?

— Urdhéro!

Ai ngriti supet.

— Do tē urdhéroj po tē më hapësh rrugën!

Ai hyri dhe vajza ndjeu erën e rrobave tē tij, si tē pyllit në vjeshtë. Ajo eci përpara që t'i kthente kurrizin, se po i mbusheshin sytë nga një mall pa anë, por ndjeu gishterinjtë e tij që e shtrënguan në llërë dhe qëndroi. Po e lëshonin gjunjët, kishte dëshirë tē mbështetej tek ai, dhe i erdhi rëndë. Mbase ai e kishte kuptuar atë lëvizje tē lehtë, se bëri përpara sikur deshi ta mbante. Lira u përmblodh dhe ktheu kokën ngadalë. Ai nuk queshte.

— Mbase nuk duhej tē vija në këtë orë. Mos ju bezdis? Ne në fshat shkojmë te njëri-tjetri në çdo orë. — Ai nuk ia lëshonte krahun.

— Jo, aspak! Babai do tē gëzohet shumë. Duhet tē vijë tanë. — Ajo foli duke u shtirur e qetë.

— Aha! — Ai e lëshoi.

Dani u ul në divan dhe s'po dinte ku t'i vinte këmbët në qilimin e shtrenjtë.

— Si është profesori? — pyeti ai, pa ngritur sytë.

— Mirë. Shkon çdo ditë në institut.

— Po ti si je? I fejuari mirë?

Ajo qeshi me nervozizëm:

— Nuk kam më tē fejuar. S'të ka thënë tetë Ruzja?

— Jo. Më fal, nuk e dija.

— S'kam pse tē tē fal për një gjë që s'e dije.

Ajo u ngrit, i erdhi rrrotull dhomës dhe qëndroi para tij:

— Vetém se jam e martuar! Nuk tē duket çudi? As mund tē marto hem prapë, sepse duhet tē ndahem me një burrë që s'e kam as tē fejuar.

Ajo bëri një lëvizje tē kokës si tē hidhët flokët pas dhe qeshi vetém me buzë.

Djali nuk e vështronët dhe nuk fliste. Dukej i vrarë, i kthyer nga vetja. Ajo nuk pa në fytyrën e tij asnë shenjë gjëzimi. Ai kishte ardhur për tē, dhe tanë që mori vesh se vajza ishte e lirë, po tërhiqej.

Lira mbushi një gotë me raki dhe ia solli në tabalka. Ai e ktheu njëherësh dhe u ngrit.

— Unë... unë më mirë po shkoj Babai mbase vonohet.

— Si tē duash, — tha Lira. Ishte e fyter deri në kockë.

Në derë ai i tha «mirupafshim», po nuk ia shtrëngoi dorën më shumë nga ç'duhej dhe nuk e vështroi në sy.

— Mbase do tē shihemi prapë, shpejt, — tha ai.

Vajza ngriti supët. Në errësirën e sallonit nuk kishte kuptuar nëse ai donte apo jo tē shiheshin prapë.

Priti sa u shuan hapat në shkallë, duke menduar se po e humbiste, dhe u hodh tē përgjonte pas perdes. Ai ikte me shpatullat tē kërrusura, duke ngritur me këmbë ca gjethurina. Qëndroi një çast dhe u përkul më shumë, mbase ndezigaren, apo ndjeu dhimbje në gjoks.

Nga trotuari tjetër u shkëput gati me vrap një djalë, e përqafoi Danin dy herë dhe i ra në

gjoks me pëllëmbë. Ishte Mironi. Ai i futi krahun dhe shkoi bashkë me të. Lira e ndjeu veten jashtë lidhjes së tyre. Me siguri do të bëheshin miq. Nuk kishte kuptuar kurrë se çfarë e mban te lidhur shqërinë e djemve.

Dani zbriti kodrën duke u hedhur nëpër gurët e bardhë, që fëmijët e shkollës i kishin vënë si shkallë pér të zbritur në det. Ai qëndroi një çast. Deti dukej i qetë, por mandej vinte një mërmërimë e lehtë, pa drejtim, që e bënte të kthente kokën pareshtur. Faqja e ujit po ndizej nga drita e bardhë e mëngjesit. Era e lehtë luan te mbi sipërfaqe duke e mbledhur dritën në spirale gazmore, që ndiqnin njëra-tjetren. Djali qeshi duke ndjekur lojën e erës. «Sinjorinelo» i thoshin detarët. Ajo erë e gjuar nuk arrinte të trazonte masën e pafund të ujit. Djali u mundua të shihte atë lëvizjen e brendshme, që vetëm një detar mund ta nuhaste. Ndryshimin e ngjyrës. Në drekë era do të fërshëllente fort duke ikur drejt pyllit me pisha.

Tej, në molin e vogël, që ishte ngritur me një bankinë druri dhe disa hunj ku lidhnin varkat, vinte rrrotull xha Isufi me trikon e kuqe, i kërrusur, si një nuse pashke gjigante, duke lënë në rërën e lagur ca gjurmë më të mëdha se çmund të linin këmbët e tij.

Dani rrëshqiti nëpër udhëzën e lëmuar nga

këmbët e fëmijëve dhe eci në rërë duke shkelur në gjurmët e plakut. U habit që plaku ta kish hapin aq të gjatë.

Qëndroi mbi bankinë dhe vuri këmbën në ujë. Algat lëpiheshin pas drurëve, largoheshin për t'u afruar prapë. Djali u zgjat të dëgjonte atë muzikën e pakapshme të dallgëve. Mendja i bridhte nëpër tinguj pa qëndruar gjëkundi.

Plaku dukej i futur në veten e tij. Shplekste rrjetën duke e pastruar nga leshterikët dhe rrallë hidhte ndonjë peshk në arkën e vogël në fund të varkës. Dukej që gjuetia i kishte vajtur ters. Hera-herës ngrinte sytë e vegjël si zare, aq të ndritur e të gjallë, sa të futnin frikën, pastaj i mbulonte me qerpikët e djegur dhe bëhej përsëri i pakapshëm si një molusk, që mylllet në guaskë, kur e ngacmon me shkop.

Një peshk i vogël u hodh përpjetë duke bërrë në ajër ca harqe të mundimshme, pastaj u përpëlit në shesh dhe vetëm rrallë dridhej nga një lëvizje pa jetë.

— Xha Isuf. — foli djali.

Plaku u kthye dhe e vështroi me fshehtësi.

— Erdhe? — Ai rrëmbeu një peshk nga arka dhe shkoi përpara duke nxituar. — Hajde, — tha.

Djali e ndoqi në gjurmë dhe s'po e arrinte dot. Plaku rrrokullisej para tij si një lëmsh i kuq në dritën e bardhë të mëngjesit.

Kur u afroa te baraka e tij, i bëri shenjë Dant të hynte brenda. Në anë të barakës që një oxhak prej guri, që dukej si një kockë e dheut, me themelin të ngulur fort në rërë dhe majën

përpjetë mbi çati. Qe e vetmja gjë që mund të mbetej në mes të rërës, sikur ndonjë stuhi e marrë ta shkulte barakën prej andej.

«E kemi për miq», thoshte plaku dhe kish merak që ta hiqte tymin mirë. I pastronte blozën dhe e lyente me gëlqere.

— E di pse erdha, xha Isuf? — tha djali.

— Të më thuash mirëmëngjes, — tha plaku duke qëruar peshkun. E kripi dhe e vuri në tje-gull. Pastaj hapi strastën dhe nxori bukën.

— Hajde të hash!

— Kam një vajzë në Tiranë. Dua ta sjell këtu.

Plaku e vështroi me sytë si zare.

— Ç'punë i bën i ati?

— Agronom, profesor.

Plaku filloi të hante duke u përtypur ngadalë. E bënte bukën thërrime dhe e rrötullonte një copë herë në gojë.

— Erdhën inxhinierët për limanin e portokalleve. Do ngrenë këtu mensën dhe çadrat përtë fjetur. U thashë të mos e luajnë barakën.

— Kur do të fillojnë?

— Javën që vjen.

Plaku u ngrit, mori tjegullën me duar nga zjarri dhe ia vuri Danit përpara.

— Ha!

Djali deshi të kundërshtonte, po plaku ia bëri me dorë i bezdisur.

— Nuk më the për atë vajzën, xha Isuf.

Plaku u afroa te dera e barakës, u mbështet dhe vështroi jashtë.

— Nuk të them dot. Bëj si të dish.

Agronom Abedini rrinte përbys, sikur kërkonte diçka në gjoks. Dukej se nuk do të drejtotoj dot më. Rrudhat përgjatë faqeve i qenë futur thellë. Drita, e shoqja, rrinte në minder me këmbët mbledhur nën vete sikur të kish ftohtë.

Lira hyri pa u ndier dhe qëndroi mbështetur në derë.

— ...Babi...

Agronomi rruddhi sytë e turbullt duke kërkuar të fiksonte vajzën. Asaj i qenë mbledhur lottët, po në fytyrën e imprehtë nuk i lëvizte asnjë muskul. Agronomi uli kokën si i këputur në zverk. Një rënkim pa frymë i shtypi gjoksin.

Lira i vajti pranë dhe foli shpejt, duke gëlltitur ngashërimin, pa vështruar asgjékund.

— Babi... ne do të fejohemi... ju nuk doni... e di, po më vonë, kur ta njihni Danin... e

Tani vajza qanter pa u munduar të mbahej dhe kërkonte me sy një vend ku të rrinte.

Abedini fërkoi ballin me dorë.

— Ulu dhe më dëgjo, — foli ai me qetësinë që mund të ta japë vetëm një dhimbje e thellë.

— C'qe kjo që na bëre! — tha nëna si e shurdhër.

Vajza erdhi rrotull vetes si një njeri që ka humbur peshën duke kërkuar një pikë ku të mbahej. Mbase po humbiste më shumë nga c'kishte pandehur. Në atë çast nuk donte asnjë djalë, donte të ulej në prehrin e nënës e, si kur që e vogël, ta fuste fytyrën në gjoksin e saj.

— Ti nuk e njeh fare atë djalë, — tha Abedini ngadalë, — nuk ia dimë njerëzit dhe shtëpinë.

— Unë e njoh që kur ishte i vogël, — tha Lira me zërin të mekur, — kemi luajtur bashkë. Abedini e vështroi me hidhërim.

— Ty nuk të kujtohej as ftyra e tij. Nuk e dimë ç'lloj njeriu mund të jetë gatuar në tërë këto vite, dhe s'mund të kemi garanci një lodër fëmijërie. — Ai fliste me zë të ulët sikur kërkonte t'i mbushte mendjen vetes.

Nëna psherëtinte me zë të lartë dhe pinte duhan, siç bënte kur «kishte ndonjë hall». I dridhej mjejkra dhe nuk fliste dot.

Abedini e vështroi të shoqen në sy dhe nënqeshi hidhur.

— Kjo ka hallin e saj, — tha ai. — Do thonë bota se e nisi vajzën lakuriq dhe se i ka dhëndrin e krushqit fshatarë. Kjo nuk sheh më larg se një pulë.

Abedini u ngrit duke u mbështetur në krahët e kolktukut.

— Unë nuk e kam atë hall. Në do të dish, ai djalë më pëlqen dhe, po të kishin qenë punët ndryshe, do ta kisha zgjedhur dhëndër pas qejfit tim. Puna është se unë nuk kam më besim te ti. Më duket se i merr gjërat lehtë. Është gjëja më e keqe që mund të na ndodhë.

Ai fliste ngadalë, mundohej të mbahej i qetë, po kishte një dridhje të lehtë të zërit.

Lira u tremb. Iu duk se i ati mezi mbushej me frymë.

— Nuk më vjen keq që do të shkosh në atë fshat, — tha ai dhe heshti pak.

Lirës iu shtrëngua fytì. Atij nuk i vinte keq vërtet.

— ... kam vetëm një merak. Se mos kthehet prapë këtu.

Lira u ngrit. Ajo qëndronte në mes të atyre dy njerëzve të dashur dhe dukej e pafuqishme t'i lidhte me dashurinë e saj.

— Edhe një gjë tjetër, — tha Abedini, — tani unë do të vij me ty atje. Edhe Mironi. Mami nuk vjen dot, se është rrugë e lodhshme.

Lira deshi t'i përqafonte. Po nëna rrinte me sytë të ngulur në prehër dhe babai që ulur prapë në kolktuk, me kokën mbi gjoks.

— Dëshironi që vjen me mua? — tha Abedini.

— Nëse vjen, vjen. — tha Lira. — Dëshironi që vjen?

— Dëshironi që vjen. — tha Abedini. — Dëshironi që vjen?

— Dëshironi që vjen. — tha Lira. — Dëshironi që vjen?

— Dëshironi që vjen. — tha Abedini. — Dëshironi që vjen?

— Dëshironi që vjen. — tha Lira. — Dëshironi që vjen?

— Dëshironi që vjen. — tha Abedini. — Dëshironi që vjen?

— Dëshironi që vjen. — tha Lira. — Dëshironi që vjen?

— Dëshironi që vjen. — tha Abedini. — Dëshironi që vjen?

— Dëshironi që vjen. — tha Lira. — Dëshironi që vjen?

— Dëshironi që vjen. — tha Abedini. — Dëshironi që vjen?

— Dëshironi që vjen. — tha Lira. — Dëshironi që vjen?

Plaka bëri dasmë të madhe, siç i kishte bë-
rë edhe djalit tjetër. I tha Danit se nusja i pël-
qente, pak e vockël, e dobët, por e mirë. Do ta
shëndoshnin.

Të shtunën në darkë Asimeja me Avniun,
djalin tjetër dhe kunatin, pritën krushkun e
madh dhe ia bënë nderet siç do t'ia kish bëre
plaku po të qe gjallë. Abedini erdhi me të birin
dhe Ruzen, që kishte dashur të ishte krushkë
nga ana e nuses. Pastaj ajo do të rrinte tërë
dasmën. Të dielën pasdreke burrat e familjes
e përcollën krushkun dhe djalin deri poshtë, te
sheshi ku ndalonte autobusi. Plaka i dha Mi-
ronit mjaltë dhe arra për krushkën dhe u tha
grave se krushku i madh ashtu kishte një pune
me rëndësi e s'rrinte dot më shumë.

Darka u shtrua në oborr për burrat e në
kuzhinë për gratë.

Dita kishte qenë e nxeh të. Lira, e ndrequr
dhe e krehur nga motrat e Danit, kishte nusë-
ruar në qoshe me një fustan të bardhë të qepur
me tyl perdesh. Vajzat dhe nuset i kishin nde-

njur tërë kohën në dy krahët, të ngjitura me njëra-tjetrën (si mund të rrinë aq ngjitur me atë vapë?) dhe këndonin herë pas here këngë vajzërishte, me iso, me seriozitetin e një detyre që u takonte vetëm atyre. Lira s'mbante mend sa orë kish qëndruar ashtu, me sytë përdhe, duke vështruar herë pas here Danin, që pinte raki me burrat dhe queshte me zë të lartë. Atëherë ai i dukej i errët, i largët, i huaj, si një njeri i egër që ka gjetur fisin, sikur e kishte harruar krejt. Pastaj i nënqeshte fshehur, siç dintë vetëm ai, duke e kërkuar me sy mbi kokat e burrave, me vetullat të puqura, duke vuajtur për të. Në ato çaste ai ngjante shumë me nënën.

Lira e kishte dashur plakën menjëherë.

Mezi kish pritur të mbaronte ajo natë. Hidhëtë sytë në detin e paanë, të rrafshët e të ndritur dhe donte të ikte nga dritarja, të vraponte mbi det, të kthehej në shtëpi.

Të djeshmen vëllai kishte gëzuar në dasmë, kishte pirë me burrat duke ngritur shëndete dhe kishte hedhur valle. Babai kishte qëndruar tërë kohën në krye të tryezës, dhe ajo e kish parë turbull, përmes lotëve e tymit, pa kuptuar se ç'kërkonte t'i thoshte.

Tani shihte nënën dhe Danin që përpinqeshin ta mbanin në këmbë atë dasmë, që pengohej në çdo hap, sikur do të rrëzohej papritur, duke kërkuar të gëzonin njerëzit, dhe i vinte keq përtë. I dukej se kjo s'qe dasma e saj. Burrat nuk bëheshin dot bashkë të këndonin dhe gratë dukeshin të lodhura. Nënës i qenë skuqur dy pulla në faqet e thata, ku dukej se i qe mbledhur tërë gjaku.

Afër mesnatës nëna i qëndroi nuses pranë
dhe i mori dorën.

— Mos ke ethe? — tha ajo dhe e vështroi
me sytë e mirë.

Lira ngriti supet. Pëllëmba e thatë dhe e
ftohtë e plakës e qetësoi:

— Ikim lart, të keqen nëna, të ndërrohesh
e të çlodhesh, — tha nëna.

E mori për krahu dhe është ngjiti shkallëve të
drunjta. Në dhomën e madhe ishte vetëm një
shtrat i lartë, një dollap dhe një juk. Lira qëndro
në mes të dhomës, me dorën te pëllëmba e
plakës, dhe nuk donte që ajo të ikte, po plaka e
puthi në faqe dhe u largua duke shkelur avash.

Lira nuk lëvizi, me sytë në shtratin e lartë, që
dukej i madh për një njeri dhe i vogël për dy.
Në vegjeli e dënonin të rrinte në shtrat kur
bënte faje. Pasdite të tëra kishte kaluar e
shtrirë, pa guxuar të ngrinte as kokën nga jas-
tëku dhe dëgjonte zërat e shoqeve që luanin
poshtë. Mbase që atëherë e kishte zët shtra-
tin. Kur shtrihej, nuk qe e zonja të mblidhë
mendimet, ndiente nevojën të ngrihej në kën-
bë, në majë të gishtave. Tani e shihte me zi-
li atë shtrat të bardhë, të huaj.

Dani hyri ngadalë, e zuri nga supet dhe e
puthi lehtë në zverk. Lira lëshoi trupin si të
donte të mbështetej diku në ajër, gati të
shtrihej. Nga dritarja e hapur erdhë një erë
rrëshire.

— U mërzite? — tha ai duke e parë me
merak.

Ajo nuk foli.

— Mos u mërzi! Janë njerëz të thjeshtë.
Do t'i duash më pas.

Ajo ishte gati të shkrehej në lot. Kafshoi buzën që të mos fliste më. Nuk kishte dashur ta hidhëronte, por e dinte që tanë s'do të përbahëj më. Ai qëndronte me duart lidhur mbi gjoks. Nuk e mori më të mirë, as u inatos. Vështron-te nga dritarja në të errët diçka që vajza nuk mund ta shihte. Mbase detin.

Ajo hoqi me nervozizëm fustanin e rüsërisë dhe mbeti në këmishë. Ishte hera e parë që zhvishej në sytë një burri. Ktheu kokën nga dera. Shtëpia ishte gjithë të çara, si sy të fshehtë. Mbase ato vajzat e këngës përgjonin diku, të bëra bllok dhe mbanin gojën me dorë. Ajo mblodhi rrobat shuk para gjoksit.

Dani u afroa. S'mund ta prekte, ishte si një vajzë uji që mund t'i rrëshqiste në errësirë, të arrinte detin. I shkoi pëllëmbët përgjatë krahëve të hollë lakuriqës dhe ndjeu fërgëllimën e lehtë të lëkurës së saj. Mbase vajza vinte nga një botë tjetër.

— Do më presësh?

Ajo pohoi më kokë. Djali e pa me gjëzim.

— Mbase do të ikin shpejt. — Ai u largua duke ecur mbrapsht, me sytë në ata dy krahët e hollë lakuriqë.

Lira ra mbi shtrat përmbyss. Deshi të flinte, që Dani ta gjente në gjumi. Ndihej e fyter dhe e vetme mbi atë shtrat të huaj, me detin që zhauritej poshtë.

* * *

Plaka qëndroi në verandë dhe vështroi detin. Shtëpia e saj rrinte në kodër mbi të tjerat, si një anije që priste e përcillte brezat nga një breg në tjetrit. Mbase qe shtëpia më e vjetër e fshatit. Zoti i parë i saj, stërgjyshi i Danit, kishte vënë mbi portë një kokë luani që ngjante më tepër me një njeri.

Kur ishte gjallë plaku, babai i Danit, shtëpia qe plot. Djali i madh, i martuar, me tre fëmi-jë, rrinte veç, në odat lart. Plaku rrinte poshtë, në odën e madhe me oxhak dhe verandë, në krahun e detit, që zbriste me shkallë deri poshtë. Qe ndarë me plakën që kur u martua djali i madh, se ashtu qe zakon. Plaka flinte me djalin e dytë, në dhomën ngjitur, dhe dy çupat e pamartuara në një odë të vogël, që e kishin shtruar më pas.

Tani shtëpia qe boshatisur dhe dukej si kurrizi i një breshke të madhe që i vërvhellente era. Strehët e gjera bënин hije mbi muret. Plaka ndjeu ftohtë. Vështroi gurët e themelit të jeshilosur prej myshkut. Nuk kishte lëvizur kurre nga fshati. Këtu qe sjellë rrrotull bota e saj. Ndjeu t'i këputeshin gjunjët nga pesha e viteve.

I kish thënë Danit se shtëpia donte mbajtur dhe djali qe përgjigjur «po». Po do ta mbannte vallë djali? Nusja dukej që nuk do të rrinte në atë shtëpi.

Plaka ferkoi ballin me gishtërinjtë e thatë. Në oborr dy pula ziheshin për një krimb. Gje-

li vinte rrrotull me krahët ngjeshur pas kurrizit. Qe i bukur si gjel përrallash. Në kryenuk i ngacmoi, ecte rëndë, me majat e thonjve, pastaj turfullooi me puplat përpjetë dhe u sul e rrëmbeu krimbin.

— Shshshsh, — ia bëri plaka dhe mendoi se mashkulli është gjithnjë më i bukur. Si djemtë e saj. Asnjëra nga nuset s'qe e bukur si djemtë e saj.

Ajo pa vajzat që kalonin para shtëpisë, i thoshin «mirëmëngjes» dhe iknin drejt vreshtave. Tej, në kodër, hapeshin rrathë-rrathë portokallet.

Në janar i kishte thënë Danit: «Dua të mabiesh nusen në shtëpi deri në fund të vitit!» «Si e do nusen», kishte qeshur djali. «Ezmere», kishte thënë ajo duke menduar çupën e Zalos, kryetarit të këshillit, që i hipte të kuqtë në ftyrë sa herë i thoshte mirëmëngjes. «Po ti zgjidhe si të duash vetë.» Mbësë s'kishte bërë mirë që e kishte kërkuar nusen me axhale.

U ngrit duke u mbajtur pas gjunjëve. Kur kish ardhur nuse, kish qarë fshehur. Nuk e kishte dashur të shoqin. Ajo rrudhi sytë dhe vëshitroi tutje faqen e hirtë të malit, sikur donte të gjente aty diçka që kishte të bënte me rininë e saj, mbësë atë djalin me poture të zeza që fshihej shkurreve ta trembte.

Duhej të hynte në shtëpi, të gatuante. Dukej se nuses nuk i pëlqenin gjellët e saj. Do të bënte fëmijë ajo? Nusja dukej e sertë, po me plakën sillej mirë. Ia lavdëronte gjellët, po pastronte vetëm dhomën e saj. Plaka deshi ta mësonte

zonjë shtëpie, po nusja nuk qëndronte gjëkund. Zbriste poshtë në det, lahej pas gurëve vetëm ose ikte në pyll pas Danit. Dukej e lehtë sikur e frynte era dhe ishte e ngushtë në vithe. Plaka shihte me zili çupat e fshatit me shpatulla e vithe të rrumbullakëta. Të kishte rrojtur plaku, mbasë do ta kish martuar yetë djalin. Ndryshe është burri në shtëpi.

Hyri brenda ngadalë dhe qëndroi në dhomën e madhe. I dukej se muret e pasaj dhoma zgjeroheshin me kalimin e viteve. Ajo nuk ulej kurrrë në qoshen e plakut dhe e mbante derën e shtëpisë gjithnjë të hapur.

Vështroi fotografinë e plakut në mur. I krehur, me mustaqet përpjetë e kostumin e zi. Çupat i martoi njëren pas tjetrës, i gjeti vetë dhëndurët. Pastaj vdiq, s'arriti ta martonte Danin.

Plaka e çoi djalin në shkollë dhe e mbajti shtëpinë si mundi. Tani gjunjët po e linin dhe sytë i mjegulloheshin, nuk e shihte mirë fotografinë e plakut. Në murin karshi kishte fotografi të tjera, të zverdhura nga koha, babai i plakut dhe tre xhaxhallarët. Kishte diçka të përbashkët në fizionominë e tyre, hunda e gjatë deri mbi buzë dhe sytë e vegjël rrumbullakë u jepnin pamjen e shpendëve të egër. Të gjithë të thatë, vetëm njëri vinte i plotë. Ishte vëlla me nënë tjetër, po hundën e kishte prapë të gjatë dhe sytë rrumbullakë.

Kur kishte qenë gjallë plaku, fliste me fotografitë në mure dhe ndante veç xhaxhanë e madh, që e kishte dashur shumë.

Gratë nuk qenë nëpër mure, sikur s'kishin rrojtur në atë shtëpi. Veçse hijet e tyre plaka i ndiente kudo. Në shtresat e gëlqeres, në musëndrat, në dhogat e tavaneve. Duhej të kishin qenë gra nikoqire, secila kish lënë nga një gjë të sajën dhe plaka mërmëriste si t'i shihte. Më shumë kishin vuajtur, se qenë gëzuar në atë shtëpi.

VI

Ajo hodhi sytë edhe një herë nga fytyra e plakut, që dukej e re në letrën e bardhë. E kishte marrë malli për plakun. Fotografia e sajnuk do të varej në mur. Kështu kishte qenë zakoni i asaj shtëpie. Po mbasë ajo do të qe plaka e fundit. Nusja e re nuk do të qëndronte aty. I erdhi keq. Mbështetje shtëpia qe vjetruar shumë. Kur frynte erë, ajo kërciste sikur do të shkërmohesh.

Ndonjë ditë do të fliste me Danin dhe nusen.

IV

Ditët që pasuan martesën, Lira dhe Dani do t'i ruanin si gjënë më të çmuar të dashurisë së tyre. Ishte një èndërr që zgjati dhjetë ditë e dhjetë net dhe koha midis netve e ditëve, èndrrës dhe zhgjendrrës, trazohej e rridhë me kufijtë vëgëlluar. Netve përkundeshin në zhurmën e paprerë të detit dhe mëngjeseve vraponin zbatohur në rërën e ashpër. Vajza ishte e virgjër. Mbështetje prandaj ato ditë ishin si një èndërr.

Dani qëndronte shtrirë në kurriz, me sytë në kupën e qiellit. Fundi i tetorit ishte i ngrohtë, po qelli qe si një kube e hirtë, e mbyllur, që shpërndante dritën në mënyrë opake. Mund të ishte mëngjes apo pasdite. Ai ndjeu t'i rëndohej koka dhe provoi mbi gjoks gjithë peshën e qiellit njëherësh. U kthyte të shihte vajzën që rrinte mbi pllakën e gurit e përgjumur dhe i erdhë mirë që ishte aty. Vështroi trupin e saj të nxirë, me gjymtyrët e holla qepur pas gurit dhe nuk deshi ta prekte. Iu duk diçka e largët, që

s'kishte tē bënte me tē, diçka që u përkiste detit dhe gurëve, si një gjallesë që prehet nën kupëndje qicllit, që jepte e merrte me çdo gjë përreth, me qetësinë e një zonje tē natyrës.

— Lira... — foli ai ngadalë.

Vajza buzëqeshi nën strehën e kapeles dhe lëvizi pëllëmbën në drejtim tē tij, po nuk u kthyte.

Ai u ngrit dhe zbriti ngadalë në det. Ndjeu t'i drithërohej trupi si t'i hynte uji në poret. Zhyti kokën dhe zuri tē godiste me krahë faqen e ujit, u kthyte në kurriz, pastaj në bark, duke e lëshuar trupin një copë herë në lojën e dallgëve.

Kur doli në breg, u shtri në gur me duar nën kokë dhe e ndjeu veten tē rëndë sa mund tē lëvizte dheu nga pesha e tij. Vështroi qie llin që ikte gjithnjë më thellë dhe qëndroi ash tu pezull midis asaj kupe tē hirtë dhe dheut në një gjysmëdremitje që i përfshiu çdo qelizë, një prehje e plotë. Rrallë i ndodhte edhe në gjumë ta humbiste krejt vetëdijen. E ndiente që ishte në èndërr dhe nuk trembej kurrë, që i vogël. Pastaj mundohej tē tregonte èndrrat, që t'i jetonte prapë. Ishte si tē jetonte një jetë tē dytë.

U end pak çaste në qie llin pa fund. Ca zëra tē fshehtë fëmijësh i dëgjoi fare pranë, si tē ishin brenda tij. U ngrit, vështroi rrrotull, po nuk pa gjékundi fëmijët. Lira rrinte shtrirë, mbërthyer pas gurit, si një nimfë që e kishte nxjerrë deti në breg.

Ai u kthyte në brinjë, i mbështetur mbi bë-

rryl dhe e vështroi një copë herë. Kishte ftohtë.

— Lira...

Ajo hapi sytë e rënduar dhe buzëqeshi.

— ...

— Duhet të kthehem i në shtëpi...

— ... Pse?

— Mbështetës nëna na pret për darkë.

— ... Po.

Ajo nuk lëvizi. Zgjati ngadalë dorën e hollë.

— Hajde...

Djali u shtri pranë saj. I pa buzët e rrudhura të pjekura nga dielli dhe sytë e shpejtë që nuk gjenin prehje. Ajo i mbështolli krahët e nxeh të rreth shpatullave dhe djali ndjeu ngrohtësinë e trupit të saj si një zjarr që digjet mbuluar.

Ata ecën bregut të kapur për dore. Era e detit i ftohte në një krah. Do të ngjiteshin në shtëpi nga ana e shkëmbit. Nuk donin të takonin njeri. Vajza i shtrëngonte dorën me gishtërinjtë e hollë dhe atij i vinte të qeshte duke ndier ato tentakula të lëvizshme që i plekseshin pas pëllëmbës me butësi e me forcë. Nuk mund ta shkëpuste dorën po të mos ia lëshonte vetë. I pëlqente ajo lloj robërie dhe mundohej të kuqonte gjuhën e fshehtë.

— Nesër do fillosh punën? — tha vajza pa e vështruar.

— Po.

— Po unë ç'do bëj?

Ai mbajti këmbët.

— Mos u mërzit. Kam folur në komitet me shefin e arsimit. Mund ta zbresin Verën në qytet dhe të hysh në vend të saj, të mbash klasën e parë.

— Ah, paske folur!

— Do mësohesh avash-avash. Ki durim, sa të gjejmë një vend më të mirë.

— A, do mësohem, ë? — Ajo nuk ia lëshonte dorën dhe zuri të ecte përpara me nxitim, duke e tërhequr gati me vrap. — Po sikur të mos mësohem? Nuk më the se do të flisje në komitet... mbase unë nuk e doja klasën e parë. Sikur do të gjendej një vend për kimiste!

Ajo e lëshoi dhe eci me hapa të gjatë, duke tundur krahët me nervozizëm e duke mërmëritur pa pushim:

— Lira!

Ajo qëndroi dhe u kthye. Djali e shihte me hidhërim. Ai e kishte buzën e sipërme më të gjatë se të poshtmen, mbase prandaj i kishte fjalët të kursyera. Qe gjëja e parë që të binte në sy në fytyrën e tij. Kishte diçka midis një burri të vendosur dhe një fëmije gati në të qarë.

— Mendova se kështu qe më mirë. Në dorë e kemi ta kthejmë.

— Jo, mos e kthe!

Ajo iu afrua, iu hodh në qafë dhe foli me buzët në gjoksin e tij:

— Më fal!

— Lira...

Ajo fshiu sytë dhe qeshi me gojën e madhe. S'kishte më asnjë gjurmë trishtimi.

Kur arritën në shtëpi, nuk qe errur akoma. Lira hyri në barakën ngjitur me shtëpinë, që shërbente si banjë, ku Dani kishte sajuar për të një vaskë llamarine. Nëna e mbante pastër dhe e ambushte vaskën me ujë të ngrohur në diell. Në një rrip xhami të varur me fije në mur ishte sapuni i mirë, pudra e kreml. Nëna e don-te të bukur nusen e djalit.

Vajza u shtri në vaskë dhe ndjeu prehje. S'kishte gjë më të këndshme se të lähesh me ujë të ngrohur në diell. Trupi iu ngjit lehtë nga fundi dhe këmbët e holla notuan të përkulura.

Nëpër të çarën e dërrasës pa në oborrin e Zalos plakën që mundohej të ndizte zjarrin duke ia futur frymën nën të. Nëna e Danit i kishte thënë se mbesa e madhe e plakës kishte ikur nga shtëpia me një ushtar dhe qe martuar në Vlorë. Ata e kishin bërë lanet. Tani kishte filluar e vogla t'i hidhte baluket mbi sy. Dukej se vajzat do të iknin një nga një, fshehurazi, nga ajo shtëpi.

Lira mendoi shtëpinë e saj. E kishte marrë malli për nënën. Ndenji në banjë një copë herë, pastaj shkoi në dhomën e madhe, me kokën të mbështjellë me peshqir. Kishte uri. Nëna kish shtruar tryezën për tre veta dhe kish hapur derën e verandës mbi det. Zërat e fëmijëve që hidheshin nga gurët, vinin afër sikur qenë benda në dhomë.

* * *

Asimeja e çoi nusén pér tē parë nē farefis, miq e komshinj. U dërgonte fjalë një ditë më parë dhe vishtë rrrobat e reja. Ajo ishte grua e urtë, po, kur shkonte rrugës së fshatit, me nusen pér krahу, mundohej tē bënte zhurmë, që tē dilnin ta shihnin.

I kishte thënë se do ta shpinte edhe nē fshatin e saj, lart nē mal.

Lira nē fillim e ndoqi pas me qejf, pastaj zuri tē mërzitej. I tha Danit se nuk rrinte dot nē shtëpi vetëm me nënën. Ai s'kishte folur.

Ditet që pasuan, ajo shkoi pas Danit nē pyje. Iknin nē mëngjes, me një kamion që shpinte punëtorët, nja një orë larg fshatit, dhe ktheheshin nē mbrëmje.

Ishte një mëngjes i myllur dhe kupa e qiellit tkurrej e mblidhej si nga një dihatje e egër. Re tē errëta qëndronin pezull mbi pyll dhe dukej se mbanin me pahir një shi tē ftohtë tē rëndë. Nëntori po bënte përpara me ngut.

Lira ecte pas Danit përmes pyllit me bre-dha. Punëtorët shkonin përpara pa folur dhe vetëm herë pas here dukeshin e zhdukeshin pas trungjeve si fragmente tē një ingjarjeje tē kaluar. Ata ngjiteshin vazhdimisht, po në

pyll nuk mund tē merrje vesh sa lart ishe mbi det.

Lira mezi mbahej tē mos rrëshqiste në trungjet e rrëzuara prej stuhisë. Sharrëtarët thoshin se në ato trungje vërsulej tipografi që tē linte «shkrimet» e tij dhe tē shtohej. Këta ishin drurët kapës. Pylli kishte ligjet e veta, që e tërhiqnin në thellësi.

Aty-këtu, ku hapej ndonjë çeltinë e vogël, zbardhte druri i mështekës. Lira vështronte e mahnitur atë pemë tē argjendtë, që e përcillte dritën e qiellit nëpër gjethet e bardha si duar tē vogla, deri poshtë në tokë. Lart, kurorat dukej se ndizeshin. Mështekna kishte ëmbëlsi dhe aromë. Dani tha se prej saj mund tē nxirrej sheqer dhe esencë parfumesh.

Ajo qëndroi.

— Më pëlqen mështekna, — tha vajza.
— Është si një vajzë e virgjër.

— Në fund tē gushtit mështekna nuk është më një vajzë e virgjër. Fara e saj është e pjekur. Vetëm se ajo s'mund ta hedhë farën më poshtë se kati i saj, as ta ngjitet më lart, atje ku fillojnë mbretëri tē tjera. — Ai i tregoi me gisht lart dhe qeshi me vajzën që dëgjonte gojëhapët.

Lira u mbështet në trungun e një ahu dhe ndjeu t'i ngroheshin shpatullat. Ajo mori mes gishtërinjve një gjethë tē ngrënë nga flutura. Dejet e holla si dantellë ndritnin transparente. Hodhi sytë tej në faqen e malit. Ishte e lодhur, nuk donte tē shkonte më tej.

— Ecim, inxhinier? — tha njëri nga sharrëtarët.

Dani shkoi pérpara duke zgjatur hapin dhe Lira e ndoqi me vështrimin tē fiksuar në shpatullat e tij. Tani ai nuk do tē ndalej më derisa tē arrinin në sektorin 2 dhe do ta harronte Lirën krejt duke menduar punët e tij, siç e kishte harruar edhe ditët e tjera. Të djeshmen në mëngjes ai e kish mbledhur brigadën në barakë dhe Lira kishte mbetur jashtë vetém. Kur mbaruan, ai qëndroi një copë herë me punëtorët, pastaj e kishte parë Lirën befas dhei qe afruar duke i hedhur dorën në sup. «Pse s'erdhe brenda?»

Në sektorin 2 po shkulnin nga dheu trungjet e prera. Ua kishin hapur gropën rreth e qark dhe një buldozer i vogël, si lodër fëmijësh, tërhiqte kavot e lidhura. Trungu kapej fort pas dheut tē zi me një përpjekje tē fundit, pastaj ngrivej duke marrë pas vetes atë mori gjallesash që kishin lidhur jetën e tyre në rrënjen e madhe. Lira ndjeu neveri tek shihte gjallesat e ndritshme, si tē lagura, tē iknin me panik prej dritës, duke kërkuar rrugët e dheut. Si tē pastrohej pylli nga rrënjet, do tē fillonte kullotja e derrave, që do tē shkatërronin larvat dhe vezët e dëmtuesve.

Lira vështroi rrrotull që tē merrte vesh se në ç'kat tē pyllit ishte. Lart, në majën e malit, ishin tē paprekura kullotat alpine. Aty rriteshin lulet më tē bukurë, Ylli i Malit. Vajza mendoi se nuk do tē arrinte ta shihte Yllin e Malit. Lart nuk fryn erë, i kish thënë një herë Dani, era fillon më poshtë, dhe vajza e shihte në ëndërr atë botë tē virgjër, pa erë, tē mbjellë me lule mali.

Zhurma e buldozierit u pre papritur. Sharrëtarët po têrhiqnin kavot për t'i lidhur në trungun tjetër. Ishte një dru i rëndë, têrë gunga, me lëvoren krejt tê zhveshur, një dru lakuriq. Në një zgavër tê thelluar në tê dukej se kishin ndezur zjarr. Zgavra qe zgjeruar anash nga gjuhët e flakëve që s'kishin arritur ta digjin.

Dani u afrua dhe shkoi pëllëmbën në trungun e lëmuar.

— Kjo është vatra, — tha ai duke qeshur.

— E premë vjet. Hajde shih këtu, — i tha Lirës duke treguar trungun me gisht.

Ajo u afrua dhe pa në tê ca kanale tê holla, që plekseshin duke formuar figura tê çuditshme dhe ngjanin si mesazhe tê lashtësisë.

— Ky është tipografi, — tha Dani, — armiku më i rrezikshëm i pyllit. — Ai i erdhi rrrotull trungut. — Po hyri në pyll, është më keq se zjarri. I pëlqen bredhi i zi. Sapo pastrojmë një trung, ai e shkruan një tjetër. Është llafazan i shpejtë.

Vajza e vështronte duke buzëqeshur. Do të donte ta shihte atë tipografin, armikun e parë tê pyllit e tê Danit.

Dani qëndroi me duart në xhepat e pantallonave, me sytë tê ngulur te «vatra». Këta dy vjetët e fundit kishin prerë më shumë nga sëmbillnin. Dëmtuesit po e zaptonin pyllin më shpejt nga ç'kish pandehur. Sa herë hynte tani thellë në pyll, ndiente një si kërcënëm që rrinte pezull në ajër. Dikur agronom Abedini kishte thënë se po i prishnin pyjet. Një pyll pishash donte tê paktën njëqind vjet tê rritej dhe ai

duhej të përgjigjej sot pér njëqind vjet më pas. Hodhi sytë në parcelën e fidanishtes. Ishte një pyll i vogël, i ri, me drurë të njomë, të një moshe, që rrinin drejt, në radhë të rregullta, si një grup shkollarësh. Duhej të shënonin pemët që do të shpërnguleshin të parat pér mbjetjet e dhjetorit.

Ca pika të mëdha e të rralla shiu u këputën nga reja mbi pyll. Ishte një shi që mund të pushonte shpejt, po mund edhe të zgjaste gjithë ditën.

Punëtorët u futën në barakë të hanin mëngjesin. Lira ishte mësuar me ta, e vinin në krye të vendit dhe i theknin bukën.

Shiu filloi me rrëmbim, po pylli i dendur ishte si një çadër. Shtrëngata hynte ngadalë në të duke e trazuar me forcë. Uji rridhte nga gjethet me currila. Pylli egërsohej ngadalë, si deti, po zemërimin e mbante gjatë dhe vazhdonte të dridhej edhe kur lart andriste dielli. Si një plak i mocëm, rregullonte ujërat e tij, mbante ç'i duhej e kthente tepricën.

Ata hëngrën në heshtje, secili me mendimet e veta, pastaj brigada e vogël u vesh me mušamatë e shiut dhe u nis pér në sektorin tjetër. Dani do të shkonte me ta. Ato ishin castet më të vështira pér Lirën. Gjithsecili shihte punën e vet dhe ajo mbetej vetëm me pyllin dhe me djalin që gatuante. Ajo priste duke përgjuar gjethet e drurëve, duke dëgjuar zërat e pyllit. I dukej se Dani kujtohej pér të vetëm kur kthehej. Një mëri e verbër i mblidhej pak nga pak. Po kur e shihte të vinte si nga një botë tjetër, që ajo s'e njihte, i

rrihte zemra si ditët e para dhe i harronte gjithë fjalët e hidhura që kishte në mend t'i thoshte. I ndriste fytyra si nga djersa, po nuk kishte djersë. Ajo nuk arrinte të kuptionte dritën e hijet e fytyrës së tij të re e të pjekur. Ishte një njeri që s'lodhej kurrë. Në mëngjes dukej një djalosh i njomë, i larë e i krehur si shkollar. Në mbrëmje kthehej burrë, me hijen e kaltër rreth mjekrës.

Lira erdhi rrrotull barakave. I pëlqente era e pishës, dhe rrëshira e ngurtësuar në trungjet e errëta kishte ngjyrën e fildishit. Shiu kishte pushuar dhe diku këndonte një vijë uji. Ajo u ul në gur dhe ndoqi lojën e ujërave. Në barakë dëgjohej djali që kërciste enët. Ai do t'i sillte diçka të ngrohtë dhe do të ikte prapë i druajtur, si përditë.

Lira uli kokën mbi gjunjë. Mbase Dani tani ishte duke u kthyer. Donte të shkonte në shtëpi.

Ndjeu hapat e lehtë të djalit fare pranë dhe u tremb. S'e kishte dëgjuar të vinte, po nuk e ktheu kokën. Djali nuk po lëvizte, dhe Lirës zuri t'i rrihte zemra nga një frikë e verbër.

Ai e mbërtheu fort në dy krahët dhe e puthi në zverk me buzët e nxehtha. Lira u lirua me forcë. Inati i mbledhur aq ditë rresht, fyrrja që nuk dinte nga i vinte, dukej se do ta mbytnin po të mos shpërthenin në një krah, në një të çarë. U kthye dhe pa fytyrën prej budallai të djalit. Mbase trembej prej asaj që kishte bërë. Ajo iu vërsul dhe filloi t'i binte, ku mundte, duke qarë me zë, duke e çjerrë me thonj. Djali mbrohej me duar vetëm në fytyrë. Lira qëndroi papritur. I qëllonte shpesh, në inat e sipër, ta

shihte vetens siç do ta shihte një tjetër, duke bërë atë që s'duhej, të egërsuar jashtë natyre dhe atëherë têrhiqej duke e lënë atë pamje të humbiste, duke u habitur me atë tjetrën, duke e përcmuar.

Ç'bënte ajo në majë të malit, duke rrahur një djalë sharrxhi? U lëshua përtokë, vuri fytërën mbi pëllëmbë dhe qau me dënesë.

Djali i erdhi rrotull pa folur dhe e preku lehtë në sup. Vajza ngriti kokën, nuk ishte e inatosur me të.

— Nuk do t'i thuash inxhinierit... mua më ngordh babai... më përzë fare... — Ai e shihte me lutje, me faqet të skuqura, duke rrotulluar një pjatë xingoje nëpër duar.

Lira do ta mbante fshehur atë që ndodhi, se i kishte dhënë fjalën djalit, dhe kjo i dukej si një hakmarrje ndaj të shoqit, mospërfilljes së tij. E mendoi këtë, po nuk ndjeu lehtësim. Ndjenja e fyerjes e pështillte ngado që kthehej. Çdo sharrëtar mund ta puthte në zverk, po t'i tekej, dhe i shoqi nuk do të shihte kurrë gjë përveç pyjeve të tij. Ajo u mblohdh. Ndiente ftohtë nga rrobat e lagura.

— Hajde të ngrohesh, — tha djali me frymën të zënë, — unë... unë rri jashtë.

Pylli ishte i errët dhe ajri dukej i gjelbër si të ishe në fund të detit. Ajo erdhi rrotull lëndinës dhe ngriti kokën lart. Retë iknin me shpejtësi, të bardha, si shtëllunga avulli, duke u rrokullisur njëra pas tjetrës dhe një qiell blu, i larë, u nder mbi pyll.

Lira mbeti me sytë përdhe, duke përgjuar si rrotulloheshin hijet e pemëve pas diellit. I

bëhej se e shihte atë lëvizje të pakapshme, që kishte ngadalësinë e tmerrshme të akrepite të orëve dhe shpejtësinë e rrjedhjes së sekondave. Dita po përmbysej dhe vajza s'dinte të thoshte në kishte kaluar shpejt, apo kish një jetë të tërë që rrinte në atë copë tokë të hapur si nga një zjarr në mes të pyllit.

Dani u kthyte me dy sharrëtarë pasdreke. Lira pa hijen e kaltër rreth mjekrës dhe ishte gati t'ia shkrepente qarit. Pa gjëzimin në sytë e tij. Si do ta mbante atë të fshehtë?

— U mërzite? — tha ai dhe e vështroi me merak.

— Jo, hiç fare. — Nuk e kuptonte pse thoshte gjithnjë të kundërtën e asaj që mendonte.

— Unë u mërzita pa ty. — Nuk i vinte rëndë nga sharrëtarët. — Këto janë ditët e fundit që shkojmë aq larg. Javën tjetër do të punojmë në sektorin e parë dhe do të rrimë bashkë gjithë pasditen.

— Sa mirë! — Ajo foli ftohtë dhe rrotulloi kokën anash sikur kjo s'kishte rëndësi.

Sharrëtarët hynë në barakë.

Dani e shtrëngoi në shpatulla dhe i ktheu kokën nga vetja. Lira nuk e shihte në sy. E dinte se ato pasditet do të ishin shumë të shkurtra dhe ai do të ikte prapë pyjeve, me ditë të tëra, duke e harruar krejt.

Të fshehtën do ta mbante për vete dhe nuk do të shkonte më në pyje pas tij.

Hodhi trikon krahëve dhe u nis e para. Kërkoi dritën e horizontit midis trungjeve të errëta. Ajo ecte pjerrët dhe via e ndritur e horizontit ikte gjithnjë më poshtë. I dukej se qelli ishte nën këmbët e saj.

— Unë nuk dua fëmijë, — i kish thënë Lira Danit në darkë, duke e shtyrë lehtë, dhe e kishte puthur në faqe.

— Pse nuk do fëmijë?

Ajo qe ngritur nga shtrati, shkonte e vinte nëpër dhomë me hapa të gjatë, me këmbët e holla, ku i ngjitej këmisha e mëdafshtë dhe duart e pleksura. Pastaj u ul mbi shtrat, me këmbët mbledhur nën vetë dhe e vështroi Danin me sytë e gjatë, që nuk gjenin prehje. Dukej e vogël dhe e mjerë si një fëmijë i rrahir.

— Pse nuk do fëmijë? — e kish pyetur ai prapë dhe kishte ndier t'i hipte të nxehjtë në kokë. Mendoi turbull se ajo ishte penduar që kishte ardhur pas tij dhe kërkonte kohë të mendohej.

Ai e kishte zënë nga krahët dhe e kishte kthyer që ta shihte në dritë. Atëherë i qe dukur sikur ata qenë takuar vetëm natën dhe asnjeherë në dritën e mëngjesit. Për herë të parë mendoi se vajza e kishte lënë të fejuarin pa ngurruar dhe kishte rënë në dashuri me Danin menjëherë. I kishte pëlqyer kjo lidhje, i pëlqente një gjë e rastit kur rrëmbehej. Atëherë, në fillim, ai do të qe pikëlluar sikur ajo të mos ishte përgjigjur. Tani i vinte keq që ajo qe hedhur në krahët e tij duke e harruar krejt atë tjetrin. Mos ishte e lehtë? Mbështetë ajo kishte bërë një lojë me të, me nënën, me shtëpinë e

tij, me njerëzit? Dani qe përpjekur tërë natën dhe, mbasi e kishte bindur veten se kishte të drejtë për çdo gjë, e kishte zënë padashur një gjumë i rëndë.

Kur u ngrit, dita kishte zbardhur krejt dhe u tremb kur nuk e pa Lirën në shtrat. Preku me dorë jastëkun e saj dhe ngjeshi fytyrën t'i merrte erë. Lira nuk hidhte kurrë parfum, kishte erën e saj. Iu duk se ajo kishte qarë natën. Ai u vesh dhe zbriti poshtë me nxitim. Kur hyri në kuzhinë, i pa të dyja, nuse e vjehrrë në tryezë, duke pritur atë.

Lira mundohejtë dukej e qetë, por ai pa t'i dridheshin gishterintë e hollë kur ngriti gotën e qumështit dhe ajo rrudha midis vetullave mori një formë tël dhimbshme. Ngjante shumë me të atin.

— Sot do të shkoj në Tiranë, — tha Dani dhe vështroi Lirën në sy.

Lira kafshoi buzën, po mjekra i dridhej. Një lot i vetëm iu mblodh në rrëzë të syrit.

— Shumë mirë që do të shkosh, — tha ajo duke ngritur ballin dhe fytyra i mori dritë nga një gëzim i fshehur.

Kishte mall për njerëzit e saj, për Tiranën, po nuk i zinte në gojë kurrë. E kuptoi që ai do të shkonte për të. Dani nuk ia shqiste sytë. S'qe vetëm malli për shtëpinë. Ajo ishte e fyer. Dani s'ia kishte zënë në gojë asnjëherë Stilianin dhe divorcin duke pritur që ajo t'ia thoshte vetë, duke u shtirë sikur kjo të mos kishte rëndësi për të. Kish dashur t'i tregonte Lirës se ai e pranonte ashtu siç qe, si një provë dashurie. Po

nuk kishte kuptuar që ajo nuk donte ta «pranonin», donte ta «kërkoni».

Dani arriti në Tiranë pasdite dhe u end një copë hërë rrugëve. Gjithkush dukej se nxiton i thithur nga një punë. Vetëm vajzat e reja, të zëna për krahu, ecnin ngeshëm, duke vështruar vjedhurazi anash, duke zvarritur trotuareve ca biseda të vakëta.

Ai lëvizte hotel. Të nesërmen në mëngjes do të kërkonte Stilianin, pastaj do të shkonte në shtëpinë e Lirës. Kishte tërë kohën atëstë ftohtë në trup që të jep mesi i vjeshtës, kur dielli nuk të ngroh dhe zjarret nuk janë ndezur ende. Mbylli dritaren dhe u shtri mbi shtrat me gjithë rroba. Mbase nuk do të sillnin njeri në shtratin tjetër. Pas pak u ngrit, shkundi rrobat dhe zbriti poshtë në hollin e hotelit të telefononte në shtëpinë e Stilianit. Një grua, që nga zëri dukej e re për të qenë nëna e tij, iu përgjigj se kish shkuar në laborator për praktikat e studentëve. Gruaja dukej sikur tërë kohën mbillaçiste çamçakëz ose i luanin dhëmbët.

Dani eci në shëtitoren «Skënderbej» me sytë në ndërtesen e gurtë të fakultetit, me tri harqet në hyrje dhe dritaret e larta. S'e kishte parë asnjëherë Stilianin, po do ta njihte.

• Roja rrinte në karrige, jashtë derës, dhe lexonte një letër duke i ndjekur shkronjat me gisht.

— Mirëmbrëma, xhaxha!

Ai mërmëriti diçka nëpër dhëmbë pa e ngri-
tur kokën.

— Desha tē takoj pak profesor Stilianin.

— S'ka njeri këtu. Studentët dolën.

— Mbase s'e ke parë kur ka hyrë. Kam ardhur nga larg.

Plaku u ngriti kokën:

— Shko vetë shih. Kati i parë, djathtas, në fund,

Ai shkoi anës, në korridorin e errët. Një grua po lante me leckën tē mbështjellë në një shkop tē gjatë, duke u hedhur majtas e djathtas shkopit. Dy vajza dolën nga një derë, me librat në sisetull. Danë u kthyte djathtas dhe u mundua tē shihte në fund. Një dritë opake, që mund tē ishte neon ose drita e mbetur e ditës, dukej se ndryshonte formë në konturet e pashquara.

Ai po bëhej gati tē trokiste në derë, kur një burrë doli me ngut dhe gati u përplas me të.

— Kë kërkon?

Kishte një zë tē hollë dhe vinte i paktë në trup. Mbase ishte 40 vjeç apo njëzet e pesë.

— Profesor Stilianin.

— Ah! Hyr brenda, prit pak.

Dani qëndroi në këmbë në mes tē laboratorit, duke vështruar jashtë kodrën e liqenit, që dukej e ndezur nga drita e perëndimit.

Burri u kthyte shpejt. Mbase s'kishte shkuar asgjékundi. Ai bëri dy ecejake tē kota në rruginat e laboratorit. Qëndroi para Danit me duart në xhepat e pantallonave.

— Unë jam Stiliani. — Qeshte sikur po zbatitej në një lojë.

Dani mendoi se ai po tallej. Kishte përfytyruar një njeri tjetër dhe tani s'po e kujtonte dot

fytyrën e tij. Fytyra e djalit të ri, që queshte me tallje, s'e linte të shihte më tej.

— Unë... unë jam i shoqi i Lirës, — tha Dani duke belbëzuar. I merrej goja kur s'duhej. E kish përgatitur ndryshe takimin. Tjetri s'i kish lënë kohë të merrte veten. Mbasse e kishte kuptuar që në derë cili qe.

— I shoqi i Lirës jam unë, më duket, — tha ai dhe vazhdonte të queshte pa turp.

— Kam ardhur për divorcin, — tha Dani duke u munduar të dukej i qetë.

— Aha.

— Sikur s'ka më kuptim.

— Po. S'ka më kuptim. Vetëm se Lira duhet të vijë këtu për formalitetet.

— Do të vijë.

— Mbaruam besoj, — tha Stiliani dhe u nis të hapte derën duke u rrotulluar rrëth thembrës me shkathësi.

— Kur të vijë Lira?

— Do t'ju lajmëroj me telegram. Adresën.

— Ai nxori një bllok të vogël të hollë gjysmë gishti dhe u bë gati të shënonë.

— Lira... Dane Nuri... N...

— Vetëm kaq?

— Vetëm kaq. — Dani po djersinte. Kishte ardhur t'i thyente hundët atij njeriu dhe e ndien të veten të poshtëruar në çdo fjalë. Përfundimisht ishte një fshatar i pagdhendur, që s'mund të kishte as një adresë më të gjatë.

Tjetri buzëqueshte. Dukej i kënaqur në çdo gjë të tijë. Dani e vështroi nga koka në këmbë. Nuk i zinte besë pamjes së tij. Ngjante me

ata djemtë e mësuar që në fëmijëri të vishen mirë, pas stinëve. Mbase prandaj kishte atë siguri në të ecur, në të folur, në gjithë qenien e tij. Nuk e përfytyronte dot si do të dukej i zhveshur ai njeri. Mbase nuk do të dinte ku t'i fuste duart e holla si prej çupe dhe as të fliste me sigurinë e një profesori. Ai vazhdonte të nënqesh me buzët e holla, të vogla, që i hapeshin tej masës, sa e bënин buzëqeshjen e tij të dukej si një e çarë tejpërtej fytyrës. Dani doli pa i dhënë dorën.

Dielli kish perënduar, po kishte akoma drithë. Ai ndjeu nën këmbë ngrohtësinë e gurëve të bardhë, po në trup ruante ende të ftohtët e laboratorit. Nuk donte të kthehej në hotel, por edhe në shtëpinë e Lirës nuk kishte dëshirë të shkonte. I erdhi ndër mënd gëzimi i saj kur i tha se do të nisej për Tiranë. Ajo e priste.

Ngjiti ngadalë shkallët e apartamentit dhe, kur qëndroi në derë, ndjeu njëherësh gjithë lodhjen e ditës. Trokiti po nuk ia hapi njeri. E megjithatë dikush duhej të ishte brenda. Ai shtyu derën e korridorit dhe pa në fund të dhomës Abedinin, të zhytur në kolltuk, me librin e hapur të kthyer përmbyss. E vështroi djalin pa mëri, me hidhërim. Gjunjët e hollë i mbante të bashkuar dhe duart të lidhura nën mjekër. Dukej se plaku kishte ngrirë në atë pozicion dy muaj të tërë dhe e priste. Prandaj nuk që habitur. U ngrit e i dha dorën. U duk sikur deshi ta përqafonte. I tregoi kolltukun dhe priti me sytë të hapur. Dani u mbështet në shpinë dhe mund ta zinte gjumi. Profesori i dukej

tani një njeri aq i afërt, sa edhe mund të flinte në sy të tij.

— Si jeni? — pyeti profesori, me zërin e njeriut që ka kohë pa folur.

— Mirë.

Profesori rrinte me kurrizin të kthyer nga dritarja dhe dukej krejt i errët. Drita e paktë e ditës, që hynte në dhomë, që mbledhur e tëra në fytyrën e Danit. Ata heshtën një copë herë përballë njëri-tjetrit, si dy lajmës të së shkuarës dhe të së ardhmes së botës. Kishin në mes një hendek, atë që duhej thënë e bërë atë çast dhe në çastin më pas.

— E po, ç'bëhet ajo vajza ime? — pyeti profesori.

Dani pa dhimbjen dhe tronditjen e thellë të plakut dhe aty për aty foli hapur, njëherësh:

— Më duket sikur Lira nuk është mësuar të punojë. Nuk do fëmijë dhe unë s'dua t'i bëj pa dëshirë. Ajo nuk di të dojë njerëzit. — I kishte thënë të gjitha.

— Profesori lëvizi sikur do të çohej, pastaj hodhi këmbën mbi këmbë duke e ngritur me dorë dhe foli duke ngatërruar gjuhën nëpër dhëmbë:

— Pak më butë kur të flasësh për të, pak më butë.

— Unë e dua njësoj, — tha djali.

— Sigurisht, — tha profesori, — patjetër.

— Dua që ajo të jetë e lumtur vetë dhe të gëzojë njerëzit që ka rrotull, nënën time, miqtë. Ajo mërzitet.

Profesori u ngrit ngadalë, nxori nga bufeja dy gota dhe një shishe të vogël. I mbushi dhe ia zgjati njërën djalit. Ata pinë në heshtje, pa i trokitur gotat, duke gëlltitur secili hidhërimin e vet.

— Mironi ka marrë lejen, — tha profesori.
— Mbase vjen nja dy ditë andej. Drita ka bërë ca plaçka për Lirën.

Dani e ktheu rakinë njëherësh. Pati dëshirë t'i puthte duart e thata. U lirua nga tensioni i asaj dite dhe ndjeu t'i zbuteshin kyçet.

— Shkojmë bashkë, — tha.

— Po të rrish sonte te ne, nesër vemi të dy të shohim Ruzen. Ka qenë sëmureë.

— Jo, — tha Dani, — kam një dhomë në hotel. Do vij nesër në mëngjes, të merrem vesh me Ronin e të takoj Dritën.

Ai u ngrit të ikte. Nuk donte që plakut t'i vinte rëndë pse e liroi zemrën aq lehtë.

— Natën e mirë! Shumë të fala!

— Natën e mirë! — Plaku e përçolli duke e mbajtur për krahu dhe i ndezi dritat me radhë.

Dani brodhi një copë herë nëpër qytet. Kishste tërë ditën pa ngrënë dhe ajo gota e rakisë sikur ia trazonte pamjen. I pëlgente të përplasej me njerëzit. Një vajzë e pa me inat. U ngjit në dhomën e hotelit dhe për herë të parë, pas kaq kohësh, fjeti një gjumë të thellë, tej kufirit të ëndrrave.

U zgjua nga një zhurmë e njojur shtëpie. Po përreth ishte qefësi. Nuk dëgjohej nëna po-shtë. Qe hëra e parë që ajo flinte në atë orë të mëngjesit ose kishte dalë nga shtëpia.

Të hënën ai kishia ardhur në fshat me Mironin. Qenë nisur nga Tirana me shi dhe kishin mbërritur në fshat me diell. Që lart, nga rruga e shtëpisë, qe sulur nëna, duke u mëshuar gurreve me këmbët e shtrembra e krahët hapët. «Më erdhi djali me krushkun e vogël», u kishte thënë ajo grave që kishin dalë të prisnin «kondrapostën». Ato tri ditë nëna me nusen e kishin mbajtur krushkun e vogël si ujin e paktë. Lira e kishte gjëzimin në trup. Pastaj ato e kishin përcjellë me lot në sy.

Dani vështroi Lirën, që flinte me gojën gjysmë të hapët. Rinte e mbledhur në një krah dhe nën mbulesë i shquheshin gjymtyrët e gjata. Dukej e qetë, me nöfullat e holla dhe buzët e trasha. Nuk ishte qetësia e gjumit, ishte qetësia e një detit të trazuar që ulet avash. Ishte një vajzë në pragun e amësisë. Mbështetës shtëpia e tij do të mbushej me djem e çupa. Do ta ngrindet të tire, mbi themelat e gurit, dhe donte që bijtë e tij të mos i knin siç kishin ikur vëllai e motrat.

Ai u ngrit e po vishej ngadalë, që të mos e zgjonte, po, kur u kthyesh në derë, ajo po e vështronë me sytë e gjatë e të ngushtë, që, në mëngjes i dukeshin fare të ngushtë, sa mezi

arrinte t'i hapte. Ajo i bëri shenjë të afrohej.

Dani u ul në buzë të shtratit, i mori dorën dhe ia afroi në buzë.

— Fli dhe pak. Është shpejt.

— Ku do shkosh sot?

— Në sektorin Rrasë, do fillojmë prerjen. Do të vish?

— Sot do të rri në shtëpi, me nënën.

Ai e puthi në ballin e djersitur e në gushë.

— Falemnderit, — tha dhe nuk foli më se ndjeu t'i mbusheshin sytë.

Lira qeshi.

— S'të vjen turp? — Ajo i pleksi krahët rrëth qafës dhe e shtrëngoi fort.

— Jo, s'më vjen... — Dani e përmblodhi me krahët e fuqishëm dhe ndjeu rrähjen e zemrës së saj në gjoks, të ngadalshme, por të fortë, që shpinte gjakun qetë në atë trupin e dobësuar. Mbështetja ajo do të fillonte të shëndoshej.

Dani zbriti poshtë dhe Lira u rrotullua një copë herë në shtrat. I pëlqente mëngjesi në atë shtëpi. Ishte një gjumë i shëndetshëm mbi det. Do të zbriste të pinte kafe me nënën dhe do të dilte rrugëve të fshatit vetëm që të dëgjonte njerëzit t'i thoshin mirëmëngjes. Këtu të thoshin mirëmëngjes të gjithë, edhe kur s'të njihnin. Tani vajzat dhe plakat nuk e shihnin nën shami, si të fyera nga ajo nuse pa krushq. E ftonin në shtëpi dhe e gostitnin me fiq të thatë dhe stafidhe.

Poshtë u dëgjua zëri i fqinjës, nënë Hati-xhesë.

— Si u dive, Simo?

— Mirë. Hajde, Xhexhe! Eja brenda. Tani e poqa kafen. Qe e mirë, dërsiu në qebap.

Nëna s'para shkonte e vinte me Hatixhenë që kur kish vdekur plaku. Ditën që vdiq, ai i kishte lënë amanet t'ia çonin bastunin xha Muratit, mikut të tij dhe të shoqit të Hatixhesë. Qe një bastun i bukur, me dru thane, i punuar dhe me dorezë fildishi. Mbase qe njëqind vjeç bastun, kaluar brez paz brezi. Po xha Murati s'e kishte pranuar, e kishte dashur mikun fort, po s'donte ta ndiqte pas. Që atëherë plaka qe ftetur me fqinjën.

Lira i dëgjoi që rrufitnin kafen dhe i hidh-nin njëra-tjetrës ndonjë fjalë në të rrallë. Ajo u vesh, zbriti poshtë pa u ndier dhe deshi të dilte nga dera e pasme. Në sallon qëndroi.

— Mos e lër më nusen pyjeve, — po thoshte Hatixheja dhe zëri i saj doli nën derë si fish-këllimë. — Kushedi çmund të thonë bota.

— Me burrin e saj vete, — tha nëna.

— E, xhanëm, po helbete...

Lira doli që të mos e dëgjonte më.

Simo Sime

Kaso Labi që matur tri herë të shkonte në shtëpinë e Danit dhe kthehej prapë, se kjo s'qe punë e tij. Donte t'i thoshte ta linte gruan, se e kishin parë në pyll me djalin e Xhevos.

Pastaj u ul dhe shkroi letër duke i rreshtuar fjalët si nxënës. Më në fund e grisi letrën çika-çika dhe u nis vetë. Zuri shtegun tërë pasditen dhe, kur e pa Danin të dilte nga shtëpia, trokiti bastunin në gur dhe u ngrit.

— Të desha pak, — foli ai.

— Si u ngryse, xha Kaso? — Dani u afrua dhe i zgjati plakut një cigare. Ai e vuri në vesh dhe eci në krah të tij.

— Të prita qëparë, — tha plaku.

— Urdhëro, kishe ndonjë hall?

— Jo, hiç. Desha të të shoh si je. Kështu. Plaku ecte me bastunin mbërthyer pas kurritzit.

— E rregullove gruan në punë?

— Jo, akoma.

— Nëna si është? Më mirë fute në punë gruan, mos e merr më pyjeve.

Dani qeshi me pahir dhe ndjeu se po i skuqej balli.

— Po pse, o xha Kaso? — pycti.

— Flasin bota.

Djali po djersinte.

— Po ç'thonë bota?

Plaku qëndroi dhe e vështroi pjerrtas:

— Pyet më mirë, të marrësh vesh, Mbase flasin kot, — tha. — Njatjeta.

Plaku shkoi përpara dhe u kthye në rrugicë. Dani ndjeu të ftohtë në gjoks. Eci ngadalë drejt klubit, pa qenë i zoti të mendohej. Në verandën e klubit qëndroi dhe vështroi brenda përmes perdeve të holla. Nja dy gra, me veglat e punës në duar, blinin diçka te cepi i banakut. Në një tryezë, katër burra pinin duhan dhe dëgjonin Zenelin, normistin, që fliste me duar e këmbë duke qeshur vetë me zë të lartë. Lëpinte buzët me majën e gjuhës, të kuqe si flakë e të lëvizshme, dhe i binte shokut në krah me pëllëmbë. Mbase fliste për gruan e tij.

Dani nuk deshi të dëgjonte ç'thoshte dhe hyri duke hapur derën me vrull.

— Si u ngrysët? — tha dhe u drejtua nga banaku.

Burrat u kthyen. Zeneli qeshi me njérën anë të buzës. Dukej që u tremb, se usundua të mbahej në dorezën e karriges. Të tjerët ndenjën heshtur, si të zënë në faj,

Plaku i Halilit, veterinerit, i thatë e i kërrusur, me shaminë të lidhur nyjë në qafë si pionier, kaloi përmes sallës, duke rrahur këm-

bët~~le~~ i karrigeve me bastun, sikur donte tē hapté rrugën. Dukej dritëshkurtér.

Dani qëndroi pranë bënakut në këmbë, me sytë përdhe. Nuk donte tē rrinte, mund tē ikte. Ndiente tē nxehëtë në shesh tē këmbëve, sikur tē kishte shkelur mbi prush.

Dikush i hodhi dorën në sup. Ishte xhaxhai i tij, Isufi.

— Ulu tē pimë një kafe, — i tha plaku.

— E pimë, xha Isuf. — Dani ndjeu lehtësim. Mbase qe i vetmi njeri që donte tē shihte tani.

Ustai nxitoi tē pastronte tryezën.

Dani ngriti sytë tē shihte xhaxhanë, por ai rrinte kokulur dhe thithë llullën duke i bërë tym fytyrës së tij, si tē donte ta fshihte.

— Isha me xha Kason, — tha Dani.

Plaku thithi duhanin disa herë rresht nga pak, sikur s'kishte tē ngopur, dhe foli pa e hequr pipën nga goja, duke i nxjerrë fjalët bashkë me tymin, tē shprishura, tē tymosura.

— Të pashë, kur zbritët poshtë.

— Seç deshi tē më thoshte, — tha Dani, me sytë në filxhanin e kafes, ku ajka qe prerë. Plaku e vështroi një çast me sytë e ndritur tē rrumbullakët, pastaj u zhubros prapë në fytyrë dhe filloj tē rrufiste kafen. Një copë herë qëndruan pa folur, duke hetuar secili mendi mint e tjetrit.

Dani e shtyu filxhanin e vet dhe vështroi burrat në tryezën tjeter, që i dukej se kishin humbur fjalët.

— Dalim, xhaxha? — tha ai dhe u ngri

ngadalë drejt derës. Jashtë, në verandë, qëndroi dhe vështroi detin. Ai iu duk i largët, me një armiqësi të fshehtë, që e mbulonte nën shkumën e bardhë. Era e lagësht dhe e kripur i hyri thellë në gjoks. Plaku i ndenji në krah.

Ata zbritën ngadalë në viaret me portokalle dhe i erdhën kodrës rrëth pa folur.

— Flasin në fshat për time shoqe, — tha më në fund Dani, dhe qëndroi duke ngulur thembrën në dheun e butë sikur kërkonte ta provonte.

— Po, tha — plaku, — flasin. Kam dashur të të them.

— Po ç'thonë, mor xhaxha?

— Thonë se e kanë parë në pyll, me djalin e Xhevos. E ka parë Hakani, kur çonte delet në kullotë.

Plaku eci përpara dhe vazhdoi të fliste nën zë, si me yete. Kishte ardhur koha t'i vinte gjërat në kandar.

— „Hakani s'është nga ata që i japin gojës kot, s'them dot pa folur vetë me të...

Ai qëndroi dhe u kthyte nga Dani.

— Unë asaj vajzës i besoj, — tha.

— Xhaxha Isuf... unë nuk di ç'do të bëj mië tej...

— Mbaje mendjen në vend. Fol me të, me rehat, kur të të ftohet koka, pastaj prapë e bisedojmë.

Plaku tundi dorën dhe iku përpara.

Dani eëndoqi me sy derisa humbi në mes të gjethive dhe ru kthyte. Nuk donte të shkonte në shtëpi. Lira do të ishte duke lexuar ose

punonte një triko për të. Ajo s'kishte vajtur më në pyll që atë ditë kur ai e kishte gjetur jashtë barakës, me duart nën mjekër e sytë të ndezur. Dicka kishte ndodhur në pyll dhe mbase ai ishte një i verbër. Tani i kujtohej që herë-herë ajo e ruante sikur donte t'i thoshte dicka që e mundonte dhe i ndizeshin faqet pa shkak aq sa dukej se do t'i plasaritej cipa e hollë. Për herë të parë Dani mendoi se e njihte shumë pak, ose aspak. Dyshimet i kalonin në shpirt të shpejta, të mprehta.

Zbriti drejt detit, me shpresë se do të gjente prehjen si te një mik i vjetër.

Lira erdhi rrötull nëpër dhomat e mëdha duke ndier ftohtë edhe në majat e flokëve. Dukej se shtëpia e vjetër, me dy dhoma poshtë e tri lart, me muret e trasha të plasaritura, nuk do të ngrohej dimrit. Shtëpia kishte dy oxhakë. I kishte ndërtuar gjyshja e Danit kur i ishin turbulluar sytë nga pleqëria.

«Nuk shoh mirë, kish thënë plaka, i kam sytë tym, i dua oxhakët të térheqin mirë», dhe e kishte vënë të birin, xhaxhanë e Danit, të ndreqte oxhakun e madh e të bënte një tjeter në odën e miqve. Po njerëzit mblidheshin të gjithë në dhomën e madhe, kokë më kokë dhe dukej që në atë tjetrën s'qe ndezur zjarr ndnjëherë. Ai oxhak i vogël, i padjegur kurrë, i

lyer me gëlgere jashtë e brenda, me bandën e qëndisur sipër, i kallte të ftohtët. Ca panorama të prera nga kalendarët qenë vendosur lart, afër tavanit, dhe mbi fotografitë me kornizë druri rrinin shtrembër ca dantella të punuara me grep.

Ndjeu mall për shtëpinë e saj. E përfytyroi me dritat ndezur si një anije në festë. Këtu i thoshin «shuaje dritën», kur hynte e dilte nëpër dhoma. Me ngadalë, me kujdes, por ia thoshin, ama, dhe ajo qe mësuar. Afronte dorën te çelësi sa herë shkonte nëpër dyer. I vinte inat që po mësohej. Nuk i duronte dot ato drita të dobëta dyzetvatëshe që u jepnin fytyrave një ngjyrë të kuqërrreme.

Në njérën nga dhomat, që e quanin e «çupave», ishte një kartolinë e ngulur me gozhëdë në suvanë e plasaritur. Qe pamja e një qyteti të huaj, me ndërtesa të larta dhe rrugët gjithë dritë. Ishte një pamje e marrë natën.

Ajo futi dorën në xhepin e fustanit dhe nxori telegramin të prerë në një qoshe: «*Lira, eja, të dielën, gjyqi të hënën, Stilianni.*» Ia kishte dhënë vetë përgjegjësi i postës duke e palosur me fshehtësi. «Nuk ia kam treguar njeriu», i kish thënë. «Unë? Unë jam pus. Desha t'ia jap Danit, po thashë më mirë t'ia vë në dorë së zonjës.» Po s'kish mbetur njeri në fshat pa e marrë vesh.

Lira i kishte lexuar telegramin disa herë fshehur. Pse i thoshte të vente të dielën, kur gjyqi ishte të hënën? Ç'të drejtë kishte ai t'i tregonte kur duhej të vente? Kishte një mesazh

të fshehtë midis atyre dy pjesëve të telegramit, një thirrje që lidhej me kohën midis së dielës dhe së hënës, të cilën një telegrafiste e kishte shuar si të panevojshme. Mbase kishte dëshirë ta shihte përpara, veç të tjerëve, t'i thoshte diçka, mbase t'i kërkonte të falur, apo t'i thoshte të kthehej tek ai. Ndiente turpin e një tradhtie që nuk do ta bënte kurrë. Po këto mendime a nuk ishin një lloj tradhtie ndaj Danit? Nganjëherë turbull shkonte nëpër mend se mund të ishte nëpër rrugët e Parisit, në vend që të rrinte rrëzë malit, e rrëthuar nga njerëz që s'ishin të sajët dhe që e pranonin për hir të Danit. Ju kujtuan shtë e trembur të Stilianit atë natë që i kishte thënë «po sikur të ndahemi?» dhe ndjeu neveri. Ia shihtebë gjitha tiparet, po nuk i bënte dot bashkë. Fytyra e tij ndryshonte formë si ameba në ujë. Ndjeu mall për Danin dhe i rrahu zemra me frikë se mos e humbiste. Deshi ta shihte atë çast. Po të vinte tani, do t'i tregonte edhe për atë ditën në pyll.

Nganjëherë i digjte gjoksi sa i zihej fryma. Qe e fshehta e parë që kish mbuluar aq kohë duke kopsitur trikon mbi gjoks me gishterinjt e dridhur, që të mos i turbullonte jetën.

Poshtë sahati me lavjerrës ra pesë herë. Po ora ishte gjashtë. Sahati qe gjëja më e çmuar e asaj shtëpie. Plaku e kishte sjellë nga kurbeti. Plaka hipte çdo natë mbi një fron që ta kurdiste dhe psherëtintë thellë, sikur nxirrte nga gjoksi ditën që povikte. Ishte si një rit që e kryente me mallin e një amaneti. Vetëm në orën gjashtë.

Ajo dëgjoi hapat e Danit dhe i rrahu zemra fort. Zbriti shkallët me vrap dhe qëndroi ta shihte. Ai po hiqte këpucët dhe ngriti kokën ngadalë, i buzëqeshi. Po që vetëm një ngërdheshje e mundimshme e muskujve. Në fytyrën e tij që vulosur një dhimbje e thellë, që mund ta shohësh vetëm të njerëzit që kanë humbur një të afërm. Sytë, si dy gropë të errëta, kishin boshllékun e një ikjeje. I kishte parë ata sy. Ndjeu frikë.

U lodhe, — e pyeti ajo. Kishte dëshirë t'i afrohej, të ndiente erën e tij.

— Pak, — tha ai pa i ngritur sytë dhe hodhi këpucët në qoshe. Lira ndjeu përsëri të ftohtët në majat e flokëve. Ai nuk ishte më djali i zjarrtë i pyjeve. Qe një fshatar, me rrobat të zhubbrosura, më trikon e leshtë të tjerrë më furkë, i mbështjellë nga një ndjenjë krenarie dhe vetëmbrojtjeje.

Vajza mori frymë thellë. Diçka po rrrokullisej, duke shpejtar, duke u rënduar sa më tepër i afrohej fundit.

— Qe nisur të vinte Cania me të kunatin, — tha Dani, — thuaji nënës mos na bën ndonjë gjë, se dua t'i mbaj për darkë.

Lira e vështroi drejt në sy. Nuk donte njerëz të huaj atë natë dhe iu duk se ai e kuptoi. U inatos dhe e ndjeu veten të fyter. Ai e kishte sajuar darkën që të mos rrinte vetëm me të. I ktheu kurrizin dhe hyri në kuzhinë pa folur.

— Dje, t'ju bëni përgjigje!

Dani rrinte kokulur dhe nuk hante. Njëra faqe i qe bërë flakë, sikur të qe mbledhur turpi i gjithë fshatit. Përveç asaj njolle të kuqe, që dukej si t'ia kishin bërë me dorë, ai ishte i zbehëtë dhe djersinte.

Lira ia afroi pjatën me zemër të dridhur. Dani ngriti sytë dhe u mundua të vinte buzën në gaz.

Burrat pinin raki dhe flisnin për limanin e portokalleve. Lira u kthye në kuzhinë. I dukej sikur Cania e ruante me sy, po, kur ajo kthehej ta shihte, ai vështronte diku në krah të saj. Dëgjoi vjehrrën të thoshte:

— Nusen e kam të mirë. Ajo i gatoi të gjitha. Lira ndjeu vapë. Iu duk sikur nëna donte t'i mbushte mendjen edhe vetes.

Miqtë lëvduan mezet dhe plaka lëvdonte nusen, dhe vajzës i dukej sikur ajo darkë s'kishte të sosur. Baxhanaku i Canes mori një këngë nën zë, po s'e ndoqi njeri dhe kënga e tij u pre në mes si të rrëzohej diku. Mbase tani ata do të iknin. Ajo doli në dhomë.

— Hajde, nuse, — tha Cania, — ulu këtu, — dhe i bëri vend pranë vetes. Ai i qeshi haptas, ishte gjysmë i dehur. I dha gotën e tij në dorë dhe foli me zërin e zvargur të mpirë nga rakia:

— Këtë shëndet do ta pimë për nusen dhe njerëzit e saj.

Lira e vuri gotën në buzë dhe piu pak. Iu duk sikur po i hynte avulli i rakisë në gjak.

— Mirë. Tani do të pimë për zonjën e kësaj shtëpie! — Dhe Lira piu prapë.

— Me kaq, — tha Cania, — i mbylla hesapet.
— Ai ia afroi kokën te koka e tij dhe ia shtrëngoi: — Asnjeri nuk e ka më hak në këtë dhomë t'i pish shëndetin. — Ai u shkund sikur e zuri lemza. — Këta që mbetën, janë palo burra: palo burra... Nuk jam aq i dehur, sa të mos mbaj mend nesër këto që them sonte. Jam aq, sa të them ato që s'do t'i kisha thënë esëll.

Ai u ngrit duke u mbajtur në supin e vajzës:

— O burrë, çohu! Na fal, nënë e Danit, — i tha plakës, që e shihte pa u habitur. Ishte mësuar me të dehurit e burrave të saj. Ata u përshëndetën me nusen e plakën dhe ikën pa folur.

Dani u ngjit në dhomë e priti. Kishte pirë raki mjaft, po mendjen e kishte të kthjellët dhe syrin, të hapët. Poshtë dëgjoheshin ato të dyja që ndreqnin shtëpinë e lanin enët,

Lira u ngjit në shkallë dhe qëndroi në derën e hapur. Në atë suazë druri të verdhë, që po merrte një shkëlqim të bakërt, vajza u duk e lehtë, transparente, sikur mund të zhdukej e thithur nga errësira. Ai u tremb. Mund ta humbiste.

— Lira, hajde këtu, — foli me frikë.
Po vajza nuk e kuptoi. Bëri një hap prapa, gati të humbiste në të errët.

Ai u hodh dhe e zuri nga krahët, duke e shtrënguar fort. Ia lëvizi krahët e hollë si të qe mekanizëm, si të donte të lirohej. Ai e ngriti gati peshë, e uli në shtrat dhe i foli duke u penguar, duke u mbytur sikur i kishin prerë gjuhën.

— Do tē më thuash tē vërtetën?

Ajo e vështroi me habi.

— Të vërtetën?! Për çfarë!

— Për atë që thonë në fshat, — tha ai, —
dhe do tē ma thuash tan, përndryshe... — hesh-
ti, po dëgjohej frymëmarrja e egër si grahamë.

— Përndryshe çfarë? — tha ajo.

— Ti... ti mund tē shkosh tē flesh ku tē
duash, se nuk do ta kesh vështirë ta gjesh një
shtrat.

Lira hapi sytë e tmerruar. Ai po e zbonte.
Pati frikë nga nata. Pastaj i hip i inati, një inat
i verbër. U lirua prej tij me forcë dhe vrapoi
shkallëve. Në fund tē oborrit qëndroi. Mbase
ai po thërriste. U kthy, po shtëpia ishte e
shurdhërt dhe në dritaret e myllura, me ka-
pakë druri, nuk ndihej dasnjë gërvimë. Një
derë u hap ngadalë.

Atëherë vajza vrapoi në rrugët e fshatit du-
ke dërrmuar këmbët nëpër gurë që tē mos e
arrinin, duke parë hije tē bardha në dritaret e
shtëpive që dukej sikur iknin përpjetë. Kur arri-
ti në krye tē fshatit, qëndroi tē merrte frymë.
Gjithë kohën i qe dukur sikur dëgjonte hapa
pas vetes. Një qen lehu pas gardhit. Shtëpitë
dukeshin tē bardha në errësirë. S'kishte dritë
gjekundi. U ul në një gur dhe ndjeu ftohtë, po
djersa i pikonte nën gjoks. Mbase që fëmijë nuk
qe djersitur ashtu, kur luante në fushën me
plepa tē lartë. Vështroi rrotull dhe mbeti e ha-
bitur. Ç'bënte ajo në mes tē natës, në atë fshat
në majë tē malit? Vetëm mbi det kishte dri-

të, sikur ta ndriste një diell i fshehur, që vajza nuk e shihte dot.

Ajo do të ikte të nesërmen në mëngjes. Do të priste agimin. E mendoi këtë si gjënë më të thjeshtë dhe inati po i ulej. Do të shkonte në shtëpinë e saj.

Poshtë në breg të detit lëvizte hija e një njeriu që tërhiqte rrjetat sikur i nxirrte nga dheu. Vajza njohu xha Isufin. Ishte një rrjetë pa fillim e fund, e gjatë sijeta e plakut. Njeriu shkoi te varka dhe i erdhi rrotull si një brumbull i zi. Atëherë ajo pa në det varka të tjera që lëkundeshin si lëvozhga. Brigada e peshkatarëve që nisur. Lira nxitoi të zbriste. Po të dilte në det plaku, kushedi kur kthehej.

Eci rërës me hapa të shpejtë dhe iu afrua. Mbështetje plaku s'dëgjonte asgjë veç zhurmës së detit.

— Xha Isuf!

Plaku u kthye dhe vajza e dalloi qartë fytarën e tij të hirtë në dritën e fenerit. Mbështetje aq plak, sa nuk habitej më për asgjë. Vëtem sytë, si gurë molusqesh, i lëvizën shpejt në gropat e errëta.

— Prit, — tha plaku dhe u kthye të hidhë rrjetën në varkë. Flaka e fenerit të vogël dridhej, por erë nuk frynte. Dukej se plakun e bezdiste drita e dobët që ndriçonte vetëm dy pashë rrotull tij. I uli fitilin dhe ferkoi sytë me gishterinj.

Vajza vështroi larg, në natën që dukej se po merrte dritën e detit. Rrathë të verdhë drite hapeshin e zbeheshin rreth saj.

— Ç'ka bërë, vaki? Ku do vesh? — tha plaku.

— Unë do të kthehem në shtëpi, xha Isuf, nesër në mëngjes. Më mban sonte këtu?

— Dale, moj vajzë, avash. — Ai shkoi në drejtëm të kasolles duke folur me zë të ulët.

— Po të iknin nuset kështu, nuk do kish mbetur shtëpi në këmbë.

— Unë do kthehem, xha Isuf.

— Nesër në mëngjes do të jetë ndryshe. Nata ta turbullon mëndjen. — Plaku lidhi derën e kasolles me tel.

— Vemi lart, te plaka ime.

Ai shkoi përpara me fenerin në dorë. Dukej sikur kishte kocka në fytyrë më tepër nga ç'duhej.

* * *

Qielli ishte i nxirë nga re të dendura, që vërtiteshin mbi det si të marrosura. Vetëm në lindje dukej një e çarë e madhe, e ndritur, e bardhë. Dielli duhej të qe diku afër. Dani shkonte gjatë bregut me këmbë në ujë. Stërkalat e bardha ndritnin si rruzuj të vegjël drite që binin e shuheshin prapë në ujin e turbullt.

Ai vështroi detin me frikë, duke kërkuar një shenjë. Varkat e vogla të peshkimit po ktheheshin varg, të lidhura njëra pas tjetrës. Djali u ul e priti. Në rërën e dallgëzuar dukeshin gjurmët katërfishe të një buburreci dhe

spiralja e njé gaforreje. Ai dalloi trikon e kuqe të xha Isufit, që rrinte në këmbë në mes tç varkës. Plaku zbriti, u foli diçka djemve, që zunë të zbritnin rrjetat, dhe shkoi ngadalë drejt Danit. Plaku e dinte.

— Xha Isuf...

— Mos u tremb, — tha plaku, — te ti do vija. — Ai i fshihte sytë. Dukej që i vinte rën-dë pér djalin. Turpërohej.

— Nusja është tek unë. Ngjitemi në shtëpi.

Dani i vajti pas. I kërcitnin dhëmbët e i dridheshin gjunjët.

— Xha Isuf... — foli me zërin e shuar gati me të psherëtirë.

Plaku u kthye dhe e pa me ngulm, me sytë e vegjël aq të rrumbullakët, sa të një kafshe deti.

— Ajo çupa s'ka njeri vec teje. Ne kemi pritur edhe ata që s'i duam, jo më ata që i duam.

Djali kafshonte buzën. Ndjeu shijen e gjakut në gojë, po s'pati dhimbje.

— Po... po... — mund të pranonte çdo gjë. Lira ishte aty.

— Sikur s'e kishim llafin kështu.

— Jo, s'e kishim.

Plaka e Isufit qe ngritur e bënte sikur fshinte jashtë.

— Ec brenda, — tha plaku.

Ajo shtrëngoi lidhëset e shamisë dhe vështroi Danin duke i tundur kokën me qortim.

Xha Isufi ngjiti shkallët dhe hapi dritaren e dhomës mbi verandë.

Hajde këtu, — tha.

Dani u afrua dhe kërkoi me sy në errësirë. I pa kokën e verdhë të këputur mbi gjoks si të një zogu të vrarë dhe trupin e hollë që mezi shquhej nën mbulesa. Kuptoi njëherësh sa kish vuajtur ajo :dhe rënkoj nga një dhimbje e thelle.

Atë natë Lira kishte mbetur vetëm në dhomën e miqve, në shtëpinë e xha Isufit. Plaka i kishte sjellë çarçafë të larë dhe i kish bërë një kafe të mblidhët shpirtin. Pastaj kishte ikur në majë të gishtave. Lira kishte ardhur rrötull një copë herë nëpër dhomë, si të kërkonte një fill ku të kapej. Nuk e dinte çfarë thoshin në fshat, me siguri ishte fjala për atë djalin e pyllit.

Tërë ato kohë kishte qenë si një njeri që noton në ujëra të thella, duke ndier gjithë peshën e detit mbi vete. Tani i dukej se kishte prekur fundin, atë fundin e dëshiruar, po nuk ndiente lehtësim. Kishte përsëri peshën e detit mbi gjoks. Mund të ikte ose të kthehej prapë. Po nuk do të kthehej më. Dani s'kishte ardhur ta kërkonte. Nuk fjeti, duke përgjuar zhurmat e natës, po ndaj të gdhirë e zuri gjumi padashur, një gjumë i lehtë, bojë qielli dhe shihtë ëndërr sikur që zbardhur bota nga një dritë e fortë. Qielli dhet deti qenë të bardhë.

Ajo u përpoq në shtrat, dëgjoi zërin e plakës që fliste poshtë dhe xha Isufin që kollitej e

rrufiste kafen. U vesh si mundi dhe zbriti me vrap.

Në anë të vatrës rrinte Dani kokulur dhe pinte duhan pa e hequr nga goja, me sytë të ngulur në boshllëk. E kishte kuptuar që ajo nuk do të kthehej më. Plaku doli avash. Lira e vështroi duke lëvizur sytë e shpejtë. Malli për të shoqin po i zinte frymën si atëherë kurrë e kishte takuar në fillim dhe s'e kish njohur. E kishte humbur dhe e kishte gjetur, dhe tanë nuk donte ta humbiste prapë. Dani e vështronte me sytë në ethe, sikur digjej zjarr dhe dukej i tretur..

— Ikim? — tha ai dhe në atë pyetje ishte gjithë ankthi i asaj nate.

— Po... — Falemnderit. Je... shumë e mirë... je shpirt...

Ajo deshi t'i hidhej në krahë, por u përbajt si t'i qenë lidhur këmbët.

Kur dolën në derë, ai e preku lehtë me gish-térinj në kurriz dhe vajza ndjeu ngrohtësinë t'i hapej në trup. Ngriti sytë një çast ta shihte. Dani ishte i verdhë si një njeri që humbet gjumin.

Ata dolën nga fshati pa folur dhe hynë në rrugën e pyllit.

— Unë ika që të mos kthehesha më, — tha Lira.

— E di.

— Kush të tha?

— Asnjëri. Po ti s'e bëje dot atë punë; se je nusja ime.

Lirës po i priteshin gjunjët. Kishte uri. Mbështetje prej vitesh nuk ndiente uri. Qe një ndjesi e harruar, gati e këndshme.

— Ti ke dyshuar tek unë, — tha ajo. — Nuk do ta harroj kurrë që ke dyshuar tek unë...

Ajo u mundua të vinte në ato fjalë gjithë forcën, por e dinte që do t'i harronte të gjitha një çast më pas.

— Kisha frikë se mos të humbisja... — tha Dani.

— Do të t'i kisha thënë të gjitha sikur të mos dyshoje. Unë e rraha fort atë djalin në pyll si s'kam rrahur njeri në jetën time. Nuk ta fal kurrë.

Ai deshi të queshte me zë të lartë që ta dëgjonte fshati, po pa atë fytyrën e mjerë e të tretur, me sytë që s'gjenin prehje, dhe rënkoj, ia mori dorën dhe e tërhoqi ngadalë në shtegun midis mareve.

V E L L A I

Tomor Serani qe afër të dyzetave kur filloj
të mendonte për veten. Kishte hyrë shofer që
gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe kish mbajtur me rro-
gën e vet dhe pensionin e prindërve vëllanë dhe
motrën më të vogël. Motrën e kish martuar kur
kishte mbushur të tetëmbëdhjetat, me pajë të
rëndë, si shoqet, dhe dasmë për njëqind veta.
Tani në shtëpi ishte vetëm vëllai, Genci, mjek
patolog në spital, që kishte filluar të mërmëriste
për një çupë. «Të mos martohesh pa rregulluar
dy të vegjlit», i kishte thënë e éma. Tomori
mendoi se tani kishte mbaruar punë dhe kish ar-
dhur koha e tij. Apo mbase ishte vonë? Nëna
kish vdekur e re dhe ajo kishte qenë një grua
trime. E dinte sëmundjen e vet dhe hiqej sikur
s'kuptonte. Tomori u mundua ta përfytyronte
si do të ishte ajo tani. Ndjeu mall. Ndonjë nga
këto ditë do të shkonte tek e motra në Berat.

Tomori numëronte arkat me mollë që ngarkonin
punëtorët e magazinës. E priste të shtunën
me gëzim. Lahej, rruhej dhe pastronte xhu-

pin me alkool. Pesë kilometra më tej ishte shkolla. «Do ta çosh këtë mësuesen në Tiranë?» i kish thënë një ditë kryetari i këshillit dhe ai e merrte me vete Katerinën çdo të shtunë. Ndalonte makinën e ngarkuar para shkollës dhe i binte borisë sa tundeshin muret e ulëta. E shihte të dilte pas gardhit, të vraponte në rrugicën e ngushtë mes gjethive, ku drita dhe hija luanin me fytyrën e saj dhe ai zgjatej të dëgjonte tingujt e lehtë të asaj loje. Ajo afrohej në kalldrëm me këpucët e sheshta prej gome, me ritmin e një kafshe të zbutur, e ndjekur nga nxënësit që e përcillnin deri në rrugë. «Hajde, Katerina, hip», dhe vajza me sytë e mëdhenj ngjyrë hiri ngjitej në makinë me këmbë e duar si mace dhe qeshte duke u rrotulluar midis çantave.

Tomori kishte vënë në kabinë perde të reja dhe kishte ngjitur fotografi nga revistat. Mbanëtë në kasë mollë të bukura, që i zgjidhët vetë dhe ia hidhte vajzës në prehër.

Erdhi rrotull oborrit të magazinës, u pa në xhamat e zyrate dhe qeshi. Kishte filluar të dallonte ngjyrat dhe të qeshte kot. Ishte i turbulluar dhe i merreshin këmbët si të kish pirë raki.

Magazinieri, Vaid Kérpi, i tundi dorën;
— Ec firmos këtu, — foli ai me zërin të mbytur, sikur ia kish zënë njeri hundën me dorë, duke futur kopjativet nën fletën e bllokut.
— Shihe peshën.

Tomori firmosi ku i thanë dhe u hodh në makinë të ikte shpejt. I zihej fryma kur e dëgjonte Vaidin të fliste.

Vajza e priste në rrugë, me flokët e zez në
erë.

Kabina sillej rrotull në muzg, qëndronte mbi
lumë, ngjitej lart e zbriste poshtë si në pus. Ishte
ajo orë e ditës kur çdo ngjyrë bëhet e argjendtë.
Dielli kishte perënduar, po qëlli kishte akoma
një dritë të bardhë.

— Ai e vështroi vajzën në pasqyrë.
— Mërzitesh këtu në fshat?

— Edhe mërzitem, — tha vajza dhe e vë-
shtroi me sytë ngjyrë hiri, që kishin dritën e
argjendtë të qiellit. Kishte një zë të trashë, pak
të ngjirur.

— Mbështetje transferohesh shpejt. — Ai men-
doi mësuesin e gjatë, që dilte nganjëherë ta për-
cillte bashkë me fëmijët.

Tomori shtriu këmbët dhe pa orën. Gjithë
rrugën që zbriste nga mali ishte vetëm me çu-
pën. Poshtë në xhade do të merrte ndonjë udhë-
tar tjeter.

Vajza mblodhi duart në gjoks dhe u rras në
ndenjëse.

— Ke ftohtë?
— Pak. — Ajo nuk e vështroi në pasqyrë.
Kishte udhëtar shumë herë me të, po sot e
bëzdisnin ata sytë e tij në pasqyrën e ngushtë.
Tomori i hodhi xhupin e tij në prehër.

— Merre, mbulohu.

Vajza e mori me pahir, e hodhi shpatullave, ndjeu erën e atij burri të huaj, të përzier me benzinë, dhe iu drodh trupi sikur ai e mbështolli në befasi. I erdhi rëndë. Vështroi në pasqyrë ballin e tij me dy xhunga në vendin e vetullave. Çfarë mendonte ai? Balli i ngurtë, i tendosur, dukej pa asnje mendim. Katerina deshi të ngrinte kokën t'i shihte sytë, po nuk lëvizi.

Në kthesën e fundit, kur dolën në asfalt, Tomori shoi motorin dhe makina zuri të shkiste si në vaj. Vajzës po i varej koka në gjumë. Apo mbasse bënte sikur flinte?

Po hynin në qytet. Katrorët e ndriçuar të drितareve dukeshin si të varur në errësirë. I erdhi keq që arritën, kishte dëshirë ta shëtiste vajzën e fjetur nëpër natë, të përgjonte gjumin e saj. Si mund të flinte ajo në kabinën e tij? Dukej se s'ndiente asnje rrezik. Përtej zhurmës së motorit dëgjohej gërhima e saj e lehtë si e një maceje dhe Tomori mundohej të shkonte pa zhurmë.

— Katerina, — pëshpëriti.

Ajo nuk lëvizi.

— Katerina. — Kishte dëshirë t'ia thoshte emrin me zë të ulët. Katerina... Ikte në asfalt... në kthesë... Katerina.

*

*

*

Ai ndaloj te karburanti. Një djalë i gjatë rrinte në strehë, mbështetur në bishtin e çadrës, aq i palëvizur, sa mund ta merrje për një hije.

— Gjergji... — pëshpëriti vajza dhe, para se Tomori të merrte vesh ndonjë gjë, Katerina u gjend në krahët e djalit. Ai e puthi në faqe dhe e mbajti shtrënguar. Vajza qeshte me nga-shërim, pastaj u shkëput, qëndroi një çast sikur iu kujtua diçka, u kthyte te kabina, u ngjit me një këmbë mbi shkallare dhe foli me zë të ulët, duke u ngutur:

— Natën e mirë dhe... dhe falemnderit...

Fryma e saj i ra drejt mbi fytyrë, e ngrohtë, me një shije gati të ëmbël. Djali u afrua dhe foli me zë të lartë;

— Natën e mirë, usta! Faleminderit shumë!

Tomori ndjeu gjuhën t'i ngjitej pas qiellzës sikur s'do të fliste më. E gjithë kjo kishte ndodhur shumë shpejt, aq sa deshi të kthente makinen mbrapsht. Tërhoqi derën, që u përplas duke thyer me zhurmë errësirën e natës, dhe u mbështet në ndenjëse, me sytë tek ata të dy, që largoheshin ngadalë në mes të rrugës. Hijet e tyre zgjateshin në asfalt deri te rrotat e makinës, pastaj shkurtoheshin e iknin përpara. Mbylli njérin sy, pastaj tjetrin dhe ajo siluetë e çuditshme zuri të hidhej sa në një trotuar në tjetrin. Ajo nuk do të vinte më në makinë me të. Kjo kishte qenë e shtuna e pestë. Apo e gjashta? Nuk i kujtohej mirë. Ishte diçka që kishte mbaruar para se të fillonte.

Nuk po e duronte atë shijen e ëmbël në gojë. Ndezi cigaren dhe e thithi me forcë. I shihet akoma ata të dy me sytë gjysmë mbyllur, krejt të vegjël, nëpër tymin e bardhë që

13 — 95

dukej sikur zgjatej e shtrohej mbi rrugë. Qëndroi një copë herë derisa ndjeu cigaren t'i digjte buzët. Po dremiste, ose shihte èndërr. Pështyu bishtin dhe u hodh jashtë. Donte zjarr dhe e dëshiroi aq fort, sa ndjeu t'i nxeheshin pëllëmbët. I vëllai patjetër kishte ndezur sobën dhe ia ruante gjellën të ngrohtë në anë të saj. Ai mërdhinte shumë, e ndizte zjarrin i pari dhe e hiqte i fundit; flinte shumë edhe mëngjeseve. Dukej sikur e kalonte jetën me gjumë.

Tomori i hodhi sytë rrugës së zbratzet, ngriti jakën e ngushtë të xhaketës në zverk dhe rrasia duart e lagura në xhepat e pantallonave. Mbase kishte filluar të plakej, që ndiente aq ftohtë. Rrotull çdo gjë dukej aq e ngrirë, sa të bëhej se mund të thyhej. Vetëm rruga e larë nga shiu dukej si e gjallë, sikur do të luante nga vendi.

Ai u ngjit në kabinë. Kur të kthehej në Peshkopi, do t'i thoshte atij kryetarit të këshillit të mos i jepte më nga këto mësueset për t'i guar në Tiranë. Po mbase kjo kishte qenë rruga e fundit e Peshkopisë. Drejtori kishte thënë se do të fillonin të merrnin mollë nga Korça.

Genci kishte qenë një fëmijë i bukur, me sytë bojë qelli të rrumbullakët dhe faqet e kuqe. Tomorit i dridhej diçka në gjoks, si një flutur në brinjë, kur shihte fytyrën e tij topçe, me gojën e vogël. Mbase ishte pesë apo gjashtë vjeç...

...Shpirti i vëllait, zogu i vëllait, gonxhe e

vëllait... gonxhe që ke edhe sy, edhe gojë, edhe këmbë... të gjitha i ke si unë, vetëm se i ke itë vogla... Pérjashta janë dielli, hëna, yjet, të presin ty, po ti je i vogël... mami thotë kur të vijë vera... më duket se vera është shumë larg... Ajo flutura në brinjë s'e linte të qetë... e dëgjon?

Kaptoi rrugën duke zgjatur hapat. Ndiente gëzim në shpirt. Në djall të shkonte ajo mësuesja flokëzë me gjithë djalin e saj. S'mbetej bosh zemra e njeriut. Iu duk se do ta gjente Gencin ashtu të vogël, si tridhjetë vjet më parë, sa një grusht, dhe nxitoi.

Genci flinte mbi divan, pranë sobës, me pëllëmbët midis kofshëve, me pizhamet bojë qie... Tomori qëndroi në derë pa lëvizur, ta shihte, po ndjeu t'i shuhej gëzimi.

Ai i pa buzët e fryra nga gjumi dhe flokët e dredhur që i bënin hije mbi ballë. Një kaçurrel i përdredhur si sy dukej gati i gjallë. Ishte një fëmijë i madh. E mendoi këtë për herë të parë, po kishte diçka tjetër përtej këtij mendimi. I vëllai qe një fëmijë i madh, që nuk dëshiron te kurrë gjë. E mendoi me qartësinë e një zbulimi dhe ndjeu nxeh të pas kokës.

Lëvizi. Nuk e duronte më atë pamje, deshi ta shkundte, ta ngrinte në këmbë. Erdhi rrotull tryezës duke shtrënguar duart po, nuk guxoi ta prekte. I vinte të kruante ballin kur shihte atë kaçurrelin e përdredhur si sy.

U ul duke i kthyer kurrizin dhe vështroi duart e veta tërë nyja e damarë, shtrëngoi dorën e majtë me të djathtën dhe iu duk si diçka

e huaj. Prej vitesh i kishte dalë zot vetes, vëllait dhe motrës dhe s'qe ndalur kurrë të shihte pas, në kish bërë ndonjë gjë keq, i bindur që i kishte bërë mirë. Tani dyshimi po e mbërthente në vend dhe rrëmonte me mendje në vitet e tij. S'e kishte dëgjuar kurrë të vëllanë të kërkonte diçka, s'e kishte parë të hidhërohej nëpër vdekje dhe as të gëzohej në dasma. Ai u ngrit dhe qëndroi në këmbë. I mbahej fryma. Ishte më e rehatshme të mos dëshiroje gjë. Të dëshiroje diçka e të mos e arrije, të shkaktonte vuajtje. Ajo mësuesja me këpucët prej gome, që hidhej si mbi sustë, kishte dëshira ajo?

— Tomor!

Ai i mori frymë i lehtësuar. Mbështetje tani do të ndryshonin gjërat.

— Të zgjova?

— Jo. Ke shumë që ke ardhur?

— Tani. Pse ke rënë kaq shpejt? Ke qenë rojë?

— ... Rojë?... Jo. Nuk kam bërë këto kohë.

— Ai futi gishtérinjtë në flokë dhe gogësiu. — Jam... më kanë futur në një grup studimi.

— Shumë mirë.

— Po shihja një ëndërr të bukur.

... (shihte ëndrra si gratë).

— Pse nuk mund të jemi aq të lumtur zgjuar, sa ç'jemi në ëndërr?

Tomori ndjeu përsëri atë shijen e ëmbël në gjuhë sikur hante zaharinë.

— Kjo nuk është e vërtetë.

Genci u ngrit ndenjur dhe kërkoi papuçet me këmbë.

— Tomor!

— Çfarë?

— Mund tē fejohem sē shpejti.

Ai foli me një zë siç do tē kerkonte një gotë ujë.

Tomori ndjeu boshllëkun nē gjoks. I vellai jetonte dhe aq, nuk mundohej tē gëzohej dhe as tē mërzitej.

— Ta shohësh edhe ti njëherë, po s'të pëlqeu...

Tomori mendohej. Si ishte ky njeri kështu, pa kockë? Mund ta bëje me duar si tē doje. Deshi tē prekte diçka tē ashpër. Ku ishte tani ajo mësuesja nervoze, me nofullat tē kërcyera dhe lëkurën tē futur faqeve si tē djemve?

Doli nga shtëpia herët. Mëhalla s'qe zgjuar ende, vetëm nja dy gra lagnin kalldrëmin para portave. I pëlqente e diela nē mëngjes, i pëlqente tē shëtiste nëpër rrugicat e ngushta tē mëhallës dhe tē shihte mbi tjegullat e mureve tē ulëta. Te shtëpia e Kazazëve porta qe hapur dykancat. Martonin Lidën, vajzën e fundit tē Hasanit.

Ai qëndroi para portës. Te çezma nē fund tē oborrit uji derdhej me zhurmë. Ca djem tē vegjël futnin brenda karriget e mbledhura nē mëhallë. Gratë hiqnin shtresat duke kaluar derë më derë me nxitim, si tē kish rënë zjarri nē shtëpi. «Nusja» doli nga hajati i errët dhe

vrapoi te çezma me peshqirin në krahë. U-hodhi ujë syve me vrull, pastaj hapi gishtin e madh dhe treguesin dhe vuri lëkurën e tendosur te gryka e rubinetit. Uji u hap në formën e në elbazeje të ndritur, që sillej rrotull si një dritë e gjallë. Vajza queshte. Pastaj qëndroi, se dikush e thirri nga brenda dhe vrapoi në shtëpi me atë këmishën e madhe, që i vinte rrotull trupit të thatë si leckë.

Tomori ngriti supet. Kur qe rritur ajo, Lida e vogël, që luante gjithë ditën me vija dhe bërtiste në kupë të qiellit?

Ai shkoi anës murit dhe iu foli dy grave që fshinin. Kur doli në rrugë, zuri të ecte shpejt në drejtim të parkut të makinave. Po të gjente Kasemin, do t'i thoshte atij. Nuk dinte çfarë, po me Kasemin mund të flisje si të doje.

Parku ishte një oborr i shtruar me asfalt, ku dikur luanin tenis. Qe rrethuar me një mur të lartë të vjetër, të pasuvatuar. Tullat qenë rrum-bullakosur e ngrënë dhe vende-vende mbuloeshin nga një myshk i butë. Tomori i erdhi rrotull oborrit. Makina e Kasemit nuk ishte aty. Një mace laramane kishte hipur në mur kushedi nga dhe nuk gjente vend nga të zbriste. Në fund të oborrit pa Lefterin të shtrirë nën makinë, më gjunjët e krahët përpjetë. Me xhupin e zi prej lëkure dukej si një brumbull i madh.

— Lefter!

Lefteri ktheu kokën dhe i qeshi midis rrotave.

— Erdha! — U tërhoq rrëshqitas dhe u turr

me trupin e bëshëm, duke fshirë duart me një shuk leckash.

— Po ku je, mor djall i madh? Mbete rrëpirave.

— Nuk do të vete më tanë. Mbarova. (Të dielën çupat dilnin shëtitje.)

— Hajde, — tha Lefteri, — të ngrohim pak gurmazin.

Fliste me theksin e minoritetit. Ai i shkoi krahun dhe e tërhoqi te makina. Nxori një shishe fërneti që poshtë ndenjëses dhe ia vuri në buzë;

— Pi, or djall i madh, se është e diel.

Tomori ndjeu pijen t'i shkonte poshtë si flakë dhe avullin t'i ngjitej në kokë. Nuk pinte, sidomos në mëngjes.

Lefteri po ia nxirrte fundin shishes. Pastaj ai do të këndonte atë avazin grek «ti kanis, kopella-mu» e do t'i vinte rrotull këngës deri në drekë.

Dera e oborrit u hap me forcë dhe përgjegjësi i parkut, Koçoja, filloi të bërtiste që poshtë;

— Ju marrtë djalli, ju marrtë, as të dielën s'të lini rehat! Kokétrashë, kokëboshër, gjen nga të gjitha kokat!

Fliste me vete dhe ishte gjithnjë i nxehur, dhe kjo tregonte që qe mirë, sepse, po të kishte hall vërtet, ftyra i zbehej dhe nuk hapte gojë gjithë ditën. Ai pa Tomorin dhe u skuq, u afrua, këmbëshkurtër, i djersitur deri në flokë, si në behar. Nga dilte gjithë ajo djersë nga ai burrë i imët? Dukej se ndonjë ditë do të tretej fare.

— Tome, paske ardhur, or plak? Mirë bëre që erdhe, thashë mos kishe këputur zverkun gjekundi.

U erdhi rrrotull makinave, pastaj ndaloi afër Lefterit.

— Ç'e ke atë? — E mori shishen e zbrazur përgjysmë dhe e ktheu, pastaj nxori nga xhepi syzet, që ishin dy xhamat të rrumbullakët të vegjël, aq të vegjël sa i mbulonin vetëm sytë, të lidhur me tel, dhe e rrrotulloi shishen duke kërkuar etiketën.

— 1930... Qenka e vjetër sa unë. Akoma ka shishe plaku?

— Ka, — tha Lefteri, — po do t'ia pimë. Nuk sheh më nga sytë.

— Goxha djalë je ti, Lefter! — ai pështyu anash dhe iku në atë zyrën e vogël, që mund të nxinte vetëm Koçon. Përplasi derën me forcë, që donte të thoshte se s'kishte qejf të fliste me njeri. Por ai do të dilte andej pas pesë minutash, nuk rrinte dot gjatë në një vend dhe sidomos vetëm.

Tomori u ul në një gur në diell. Ajo macja s'po zbriste dot nga muri. Mbase të tjerët nuk do të vinin sot.

Koçoja kishte qenë shoferi i parë kur u formua parku. Tani punonte me një mushkëri; se tjetrën ia kishin hequr. «Vetëm nga mushkëritë nuk do të vdes, thoshte, rroj edhe me gjysmë. Një grusht njeri jam unë. Të kisha pasur shkollë, të më shihnit më në park». Po vetëm nga parku s'ikte dot Koçoja.

Tomori u ngrit.

— Shëndet, Telo, po dal njëherë.

— Shëndet, Tomor, nuk do presësh të tjerët?

— Mbase kthehem më vonë. — Ai i tundi dorën Koços që ziente brenda xhamit dhe doli në rrugën e postës. Çupat ecnin për krahu; të ndrequra, djemtë rrinin në grupe buzë trotuarit. Mbase do ta shihte atë mësuesen flokëzëzë për herë të fundit, pastaj nuk do ta kërkonte më kurrë. Ai u hoq mënjanë, duke ruajtur atë rrymë njerëzish, duke ardhur rrrotull me mendjen tek ajo. Shihte shpatullat e saj, sytë, flokët, të mbuluar përgjysmë nga njerëzit që lëviznin pa pushim. E dinte që ajo ishte aty te të gjitha vajzat bashkë dhe i hidhej zemra. Pse nuk afrohej kurrë ajo?

Shkoi ngadalë kodrës së liqenit duke u ikur njerëzve. Qielli i butë i jugut në ngjyrë të kremit, dukej i ulët. Andej vinte pa u ndier një erë e ngrohtë. I pëlqente jugu me dritën e verdhë. Që fëmijë i kishte ndier katër krahët e horizontit. Shkoi buzë ujit. Në fund të rrugës qëndroi dhe u ul nën një pemë, ku kishin mbetur ca gjethe të zverdhura, që rrinin horizontalisht, të ngrira, pa frymë, si të prera me letër nga dora e një fëmije. U shtri në kurriz dhe ia nguli sytë kupës së qiellit. Mendimi po i trejtë në atë hapësirë të kaltër.

Në drekë, kur hyri në oborrin e shtëpisë, Tomori dëgjoi të qeshurat e një çupe dhe qëndroi. Asnjëra nga mbesat e tij nuk qeshte ashtu

(as ajo mësuesja). Nga dera prej xhami e sallonit pa të vëllanë që rrinte mbështetur në dy jastëkë dhe ngrohte duart në sobë. Ndiqte me një vështrim të vakët vajzën që po shtronte tryezën dhe qeshte me pahir, me mundim. Vajza ishte e vogël sa një kolibër. Dukej e gjëzuar dhe e shpejtë, rrrotullohej nëpër dhornë duke tundur palat e fustanit, duke u bërë erë flokëve si një zog që fërfellonte krahët. Pastaj qëndroi befas e palëvizur, me sytë të humbur dhe atëherë ishte vetëm një vajzë trupvogël, me sytë e vegjël dhe hundën përpjetë. Ktheu kokën nga Genci e trembur.

— Kush është?

— Tomori. Erdhi mbrëmë. — Ai nuk e ndryshoi qëndrimin.

— Po ti nuk më the.....

— ...Nuk të thashë....

Tomori hyri dhe i zgjati dorën çupës.

— Mirë se erdhe, — tha ai dhe u mundua të dukej i gjëzuar.

— Më falni, unë nuk e dija.....

— Pse t'ju fal? Bëre mirë që erdhe. Ka kohë që në shtëpinë tonë s'ka hyrë ndonjë vajzë.

Ajo u skuq. Mbase pandehu se ai donte ta fyente. Nuk i kishte sytë të vegjël. I dukeshin ashtu nga qepallat e fryra dhe vetullat e larta. Ajo hapi krahët si të donte të thoshte se tanë që e kotë të fshihej dhe mërmëriti diçka me zërin e këputur. Pastaj ngriti kokën, hodhi flokët pas dhe foli:

— Unë... unë kam ardhur edhe herë të tjera, kur nuk keni qenë këtu....

Tomorit i erdhi keq. Dukej një fëmijë krenar. Atë nuk mund ta fyeje. Qe nga ata njerëz që e ndëshkojnë veten para se ta ndëshkojnë të tjerët.

— Kjo është puna juaj, — tha ai dhe u ul në tryezë, — Do të më jepni ndonjë gjë për të ngrënë? Kam një javë nëpër restorante.

— Ja, menjëherë, — tha vajza dhe u sul të merrte pjatën. Pastaj qëndroi befas dhë u kthyesh. E vështroi Tomorin më sytë e zinxhi që i drithëronin me njëfarë inati të egër.

I vëllai s'kishte lëvizur nga vendi. E kishte sjellë vajzen që ta shihët ai dhe e pyeste me sy. Mund ta merrte ose ta linte, ishte injësoj pér të.

Tomori u ngrit. Donte të bënte diçka pér të ndihmuar vajzen.

— Ulu këtu, — tha ai dhe e preku lehtë në sup.

Genci u ul dhe zuri të hante duke u përtypur ngadalë, me një zhurmë të mbytur, sikur bluante gjuhën e tij. (Ha me gojë mbyllur.) Vajza rrinte përmbyss, më sytë mbi pjatë, me faqet të ndezura nga gjaku dhe trazonte sallatën me pirun. Një copë herë nuk folën.

— Ha ndonjë gjë, — tha Tomori. — Genci gatuan mirë, unë di të skuq vetëm vezë. — Ai u mundua të queshte.

Vajza nuk lëvizi, qe mbledhur grusht dhe nga sytë e fryrë i rrëshqitën lot.

— Çfarë ke, Tina? — Genci foli me gojën plot, si i habitur.

Asaj i dridhej mjekra.

— Asgjë... — mundi të thoshte me zë të

shuar, duke u kërrusur më shumë. Një gulç i fortë po i merrte frymën.

— E do Gencin? — tha Tomori.

Vajza fërgëlloji. Në sytë e zinj, që i drithëronin, sikur të mbanin një ngarkesë elektrike, kishte njëfarë përbuzjeje.

— Pyeteni Gencin më mirë, — tha ajo duke u munduar ta forconte zërin dhe u ngrit. U soll rrotull nëpër kuzhinë e çorientuar, si një zog i plagosur. Dukej se mund të rrëzohej nga çasti në çast. Po nuk u rrëzua. Mori çantën e pallton dhe iku me vrap.

Genci vështroi të vëllanë dhe ngriti supet. Një vijë lyre i ndriste nën mjekër.

— Ç'pati kjo? — tha.

Tomori u ngrit dhe doli në verandë. Nga muri i ulët i oborrit dukej ende në rrugicë ajo gjë e vogël që vraponte.

Genci doli pas tij.

— Si t'u duk? — tha ai. — Sikur s'është gjë, ë?

Tomori ndjeu ftohtë, sikur iu hap një e çarë në shpatull, një e çarë ku mund t'i hynte era.

— Kush është ajo çupa?

— Është shitëse, shitëse kinkalerie. S'është gjë, ë?

— Nuk më duket për ty ajo vajzë.

— Ashtu thashë edhe unë.

— Unë nuk thashë ashtu, ti s'e meriton atë vajzë.

Genci nuk foli, nuk u inatos. U kthyesh, hyri në dhomë dhe u ul në vendin e vet.

— Ç'njerëz ka? — tha Tomori.

— Ka nënën dhe gjyshen. Rrinë me vëllanë e madn, një mekanik.

— E dinë ata?

— Më duket se po, Tina do t'u ketë thënë. Tomori rrinte në këmbë dhe shihte atë profilin e bukur, si të një koke mermari, që nuk mund ta dalloje qartë në ishte i një vajze apo djali.

— Do të fejohesh?

— Nuk e di. Nuk më pëlqen.

— Pse e mban zvarrë atëherë?

— Mbase edhe e marr.

Tomori erdhi rrrotull nëpër dhomë, pastaj qëndroi para tij duke tundur trupin, siç bënte kur merrte ndonjë vendim.

— Në darkë do të shkojmë bashkë në shtëpinë e asaj çupës, — tha Tomori.

Gencë ngriti fytyrën e bukur dhe foli i habitur, duke qeshur me zor.

— Unë nuk vij.

Tomori u afrua, e zuri nga xhaketa, ia përdroddhi shuk në gjoks me grusht, e ngriti në këmbë dhe i foli duke ia lëshuar frymën drejt në fytyrë:

— Ti do të vish ku të të them unë, ndryshe bëji derman vetes! — Fliste duke kërcitur dhëmbët, duke u përpjekur ta mbante mjekrën në vend.

Ndjeu gjakun t'i rrihte pas kokës. Vëllai e shihte pa turp, me naivitet, i frikësuar si një fëmijë që s'kupton pse i flasin. E lëshoi, dhe ai u shemb në kolltuk duke rrrotulluar mureve systë e trembur.

* * *

Të dielën tjetër Tomori shkoi në shtëpinë e Tinës vetëm. Vajzën e gjeti në oborr, tek lante me fshesë gurët e kalldrëmit të lyer anash me gëlqere. Me shaminë e gjelbër dhe përparësen e madhe, dukej si një fëmijë që luan kukkanash. Ajo e pa një çast me gëzim, pastaj sytë iu shuan dhe vrapi dërejt shtëpisë, si të donte të fshihej.

Një burrë trupmadh bëri nga shkallët dhe e mbështolli Tomorin në krahë. Ishte vëllai i Tinës, Skënderi.

— Hajde, urdhëro! Na gjete rrëmujë. S'kanë të sosur punët e grave.

Një grua e imët u dha në derë duke fshirë me përparëse duart e skuqura.

— Urdhëro, mirë se erdhe! — tha ajo dhe i qeshën sytë e mirë.

— Është nëna jonë, — tha djali trupmadh dhe i vuri dorën në sup gruas, pa e hequr krahun nga miku. Dukej sikur donte t'i mbante të gjithë në krahë. S'ta merrte mendja që ajo grua e vogël të kishte atë djalë.

Në krye të dhomës së vogël rrinte gjyshja.

— Mirë se erdhe, krushk! — tha plaka dhe mbështeti grushtet në minder që të ngrihej, dy grushte të vogla me gdhençka, si gur. — Apo bëj gabim që të flas krushk?

— Mirë e ke, nëno, s'bën gabim.

Vëllai trupmadh mezi lëvizte në atë dhomë me sende të vogla, që dukej si zgjua bletësh.

Tomori u ul pranë plakës dhe vështroi kë-

pucët e tij të pafshira në qilimin e kuq, me ca motive si shqiponja të zeza.

— Hidhu këtej ngjitu lart — tha plaka duke i vënë dorën mbi gjunjë. Ajo e shihte tërë kohën.

Tomori i qeshi lehtë.

— Kam ardhur të njihemi, — tha ai.

Plaka lëvizi, uli shaminë mbi sy, pastaj e ngriti dhe e shtrëngoi nga pas. Mblodhi buzët:

— Mirë bëre, — tha. — Ndizja cigaren mikut, — i foli djalit dhe ai u ngrit, i dha cigare me pëllëmbën të hapur fort mbi gjoks, sikur donte t'i thoshte se ia bënte shërbimin me gjithë zemër.

Vajza rrinte në derë, me tabakanë në duar, dhe shihte «krushkun» me merak, pa i ulur sytë; e pyeste. I dridheshin gotat. Në dhomën tjetër dëgjohej nëna që përgatiste diçka.

Tomori piu rakinë ngadalë. S'kishte vënë gjë në gojë që të djeshmen dhe iu duk se po i ndizej gjoksi. Hodhi sytë mbi mur, te një fotografë madhe, ku ishte Tina me të vëllanë. Vajza qe e vogël, mbase katër apo pesë vjeçë. Djali dukej i rritur dhe zinte treçerekun e fotografisë, i bënte hije motrës. Me vetullat të shtrënguara dukej i vendosur t'i dilte mbrojtje asaj gjëje të vogël, që i mbështetëj në gjoks si një flutur, me një fjongo të bardhë më të madhe se ajo vetë. Sytë e djalit ishin të turbulluar, mbase kishte ndier njëfarë frike përpëra atij syri pa jetë, mbase thoshte me vete një betim që donte ta fotografonte. Çfarë kishte menduar ai fëmijë i madh në çastin kur shtypej susta e aparatit?

— Erdha të kërkoj vajzën për vëllanë tim,

— tha Tomori dhe mendoi se kishte folur para kohe.

Plaka e vështron te drejt dhe tundte kokën lehtë pareshtur. Tomori nuk kuptonte në ishte një shenjë pleqërie apo plaka jepte e merrte me veten.

— Të mendohemi, — tha pas pak ajo, — të pyesim.

— Doemos, — tha Tomori. Ai nuk kthehej të shihte vëllanë, po hija e tij rrinte pezull në ajër. Nuk do të dilte dot kollaj nga ajo dhomë.

— Do na e merrni çupën? — plaka foli sikur vetëm tanë u kujtua pse kishte ardhur mikë dhe fshiu me shami sytë e thatë. Mbase kishte vite që s'qante.

Vajza la tabakanë boshe mbi tryezë dhe iu afrua plakës, i mori dorën dhe ia mbajti në gjunjë.

— Cupat ikin, venë në fatin e tyre, — mërmëriti plaka si me vete.

Tomori fërkoi gjoksin me dorë.

— Do ta mbajmë mirë çupën, nëne, mos ki merak.

— S'kam merak. — Plaka e vështroi me sytë e largët. — S'kam merak, o xhan. — Ia mori dorën dhe ia shtrëngoi fort me gishtërinjtë gjithë nyja, që dukej sikur s'do t'i hapte më.

Vëllai pinte duhan kokulur, duke e thithur cigaren, pa pushim sikur donte ta mbaronte me një frymë. Dukej i brengosur dhe rrinte përbysë mbi brengën e tij.

— Si ia çoni me punë? — pyeti djali duke nxjerrë tymin njëherësh nga hunda e goja. — Tina na ka thënë se jeni shofer.

— Po, shofer jam. Në këtë kohë kemi shumë punë.

— Punoni, xhano, punoni! — tha plaka.

Ata pinë kafen dhe folën për kohën dhe për mollët e Korçës. Asnjeri s'e zuri më në gojë punën e dy të rinjve. Tina fërfellonte nëpër shtëpi, duke shërbyer, duke i folur së ëmës me zë të ulët. Po në sytë e zinj, me qepalla të fryra, ishte ajo brenga e të vëllait. I kishin sytë njëlloj. Po dukej se ata njerëz do ta bluanin vetë hallin e tyre dhe do ta mbanin buzën në gaz për mikun.

— E kur do ta shohim atë djalin? — pyeti plaka.

— Do ta shohësh, nëne, mos ki merak. Tomori u ngrit dhe i mori dorën plakës.

— Gëzohem që të njoha, nëne!

— Edhe unë, o xhan!

— Mirëmbec!

Vëllai e përcollti duke ia mbajtur dorën në shpatull dhe shkonte një hap para mikut, sikur t'i zgjidhë rrugën.

Jashtë kishte filluar të errej. Ata kaluan nëpër rrugicën e ngushtë të oborrit, ku s'kish vend për dy veta bashkë. Rrugica qe e mbuluar me hardhi në të dy krahët. Vile rrushi të zi ndrinin gjithë lëng, fshehur nën gjethet e mëdha si dorë. Pse ndriste aq fort rrushi në errësirë? Në atë vjeshtë të vonë të vinte çudi të shihje aq gjelberim njëherësh.

Vëllai mbajti hapin.

— Më fal, or mik!

— Urdhëro! — Tomori u kthye ta shihte, po nuk ia dalloj sytë.

— Ne kemi një hall në shtëpi.

— Mbase mund t'ju ndihmoj. Do t'ju ndihmoja me gjithë qejf.

— Jo, — tha vellai dhe shkoi përpara. Pastaj qëndroi dhe zuri gjithë rrugicën me trup.

— Mos i bini më në qafë vajzës. I thuajtët vëllai të mos e kërkojë më.

Tomori ndjeu t'i liroheshin shpatullat. Fajesa nuk do të bëhej. Mbase ishte njeri zemërgushtë. Tjetri kishte hall.

— Do t'ju ndihmoja, po të dija se si është puna.

— Jo, — tha djali prapë. Ai shkoi përpara në atë tunel gjethesh dhe qëndroi te porta.

Tomori e ndoqi me nxitim. Po djersinte.

— Dëgjo... mbase Tina... ata... desha të them im vëlla ka bërë ndonjë budallallëk... kupton... përmua... përmë ne, është njësoj. E duam vajzën njësoj.

Djali rrinte me ftyrën lart. Mjekra i kish ikur shtrembër nga një buzëqeshje e dhimbshme. Vetëm sytë e tij ishin tjetër gjë, endeshin në një betim vegjëlie.

— Thuaji Gencit të mos e kërkojë më Tinën, — ai i zgjati dorën.

— Si të doni, — tha Tomori. — Po mbase.... do të vijmë prapë...

Nxitoi të dilte në rrugë. U kthyesh dhe pa përtetje kangjellave të rralla shtëpinë me dritat e derën e vogël si zgjua bletësh dhe çatinë aq të kuqe, sa dukej si në flakë. Kishte ardhur me zemrën plot, të bënte të mira, tanë ikte duke hedhur këmbët në boshillëk.

Një shi i hollë po ngrinte erën e dheut. Po kishte edhe një erë tjetër të lehtë, që po ia

ndiente shijen thellë në grykë. Ishte era e qytetit, e mbrëmjes. Ngriti jakën e pardësysë dhe rrasi duart në xhepa. Nata ishte e errët, me një ndriçim të brendshëm. Si flokët e mësueses. Ndjeu mall për vajzën.

Në një barakë në cep të trotuarit piqeshin kikirikë. Nuk kishte ngrënë kikirkë mbasë prej njëzet vjetësh. Era e tyre si e kripur e bëri t'i vinin lot në sy prej një malli fëmijnie. Iu kujtua xha Beqiri, që i fuste kikirikët në kaushë të vegjël dhe ua jepte fëmijëve të dielen. E diela qe festë përfëmijët e mëhallës, me kikirikët dhe hurmat e Arabisë. Që kur vdiq xha Beqiri, humma u tha, s'u kujdes më njeri për të.

Tomori zbriti në rrugën e pjerrët, pas stadiumit, duke shtrënguar thembrat, që të mos rrëshqiste. Nuk i kishte thënë asaj mësueses që s'do ta bënte më rrugën e Peshkopisë. Mbështetja ajo e kish pritur të shtunën në mëngjes, duke e kërkuar me ata sytë gri të argjendtë, të humbur, me një të shtunë e të diel boshe përpara. Ndoshta kishte gjetur diçka tjetër të kthehej. Kur mendonte për Katerinën, i dukej sikur zgjaste dorën mbi diçka që s'ishte e tij. Po vajza rrinte me kokëfortësi në një qoshe të trurit dhe nganjëherë i shfaqej aq e gjallë, sa atij i nxehet gjoksi nga një gëzim i shkurtër.

Kur hyri në rrugicën e tij, mori frymë thellë. Muret e oborreve qenë afër njëri-tjetrit, po vetëm këtu ai merrte frymë lirshëm. Mund të hynë në çdo oborr, edhe në mes të natës, asnjeri nuk do të habitej. Mëhalla ishte një shtëpi e madhe, me çatitë mbështetur te njëra-tjetra dhe muret ishin të ndara, po me dyer që shihnin

nëpër oborre. Mëhalla kishte ndjenjën e lirisë dhe të miqësisë. Ku ndaheshin muret, hapeshin portat. Në buzë të rrugës kishin ndërtuar pallate gjashtëkatëshe në vend të shtëpive të vjetra të Dërhemëve. Tani Dërhemët, tre vëllezërit dhe plaku, kishin apartamente tri kate njëri mbi tjetrin dhe e shihnin mëhallën nga lart. Po plaku prapë zbriste ta pinte kafen në rrugicën e tij.

Tomori vështroi shtëpinë e vet të vjetër. Su-vaja kishte rënë copë dhe çatia pikonte në disa vende. Kishte vite që s'kish vënë dorë njeri në të.

Kur hyri në sallon, pa Gencin që qëndronte pa lëvizur, aty ku e kishte lënë, me sytë të hapur në boshllék, sikur jetonte një èndërr. Ai lëvizi me pahir. Në fytyrën e zbehtë, gati të shuar, s'kishte gjësim, as hidhërim.

Tomori qëndroi në prag, me duart në xhepa, sikur mendohej të kthehej e të ikte.

— Ku do shkosh? — tha Genci.

— Do të rri këtu, me ty.

— Çfarë u the atyre?

— U thashë se do ta mbajmë mirë vajzën, në goftë se do të na e japid.

Genci qeshi me cep të buzës.

— Pse, mund edhe të mos na e japid, ë?

— Po, mundet. I vëllai më tha ta lëmë të qetë. Paskan një hall.

— E di. Domethënë shpëtuam.

Tomori iu afrua dhe e vështroi gjatë, me sytë e picërruar, sikur po kërkonte të kuptonte diçka që nuk që ndalur ta shihte herë tjetër. Mbësë Genci s'e kishte marrë vesh mirë.

— Ajo vajza ka një hall, — tha prapë.

— E di. Ka dalë deficit dhe e kanë thirrur në hetuesi.

— Deficit?! — Ai mori frymë thellë dhe u ul. Nuk kish qenë ajo që pandehte. Mendoi sa pará kishte në arkën e vet.

— Ne mund ta ndihmojmë. Mbase nuk kanë pará t'i paguajnë. Sa ka dalë mangët, e di?

— Katër mijë. Ajo thotë se do t'i paguajë vetë.

— Më duken njerëz për të qenë, — tha Tomori ngadalë.

Ai u shtri i veshur. Do të gjente mënyrën të bënte diçka për të. Ndjeu të lirohej nga tensioni i asaj dite, ndërsa trupi po i rëndohej. Mëndimi i fundit qe ai i një dite të re. E mbërtheu gjumi.

* * *

Tomori qëndroi me Rasimin pas mbledhjes. E donte Rasimin, që fliste pa pushim dhe qeshte vetë me ato që thoshte. U ulën në një bar të vogël, pas sahatit, ku çiftet kishin zënë qoshet. Një vajzë e mbuluar me flokë ushqente djalin me pirunin e vet dhe kukurisej.

Tomori qëndroi me sytë nga turma e ngjeshur e njerëzve, që shëtiste me këmbëngulje. Pse silleshin ashtu në një pëllëmbë vend? Çupat e reja i knin me nxitim, sikur kishin lënë një punë në mes dhe mund të ktheheshin prapë, po më atë ngut, me vetullat të mbërthyera nga serioziteti.

Djemtë ecnin ngadalë, me sigurinë e atij që mund të zgjedhë.

— Dy kafe, usta. Të forta, — i foli Rasimi kamerierit.

Tomori fërkoi tëmthat me mollëzat e gishtërinjve, pastaj u mbështet në shpinën e karriges dhe ndezi cigaren.

— E njeh vëllanë tim? — tha ai, pa e vështruuar Rasimin.

— Gencin?

— Ehë.

— S'e kam parë që të vogël. Më dukej një fëmijë i dashur.

— ... Ka mbetur fëmijë.... i dashur.

Ai vështroi rrotull me mundim. Një re e holë tymi rrinte varur mbi tryezë. Banakieri i qeshi nga larg, duke i mëshuar dorezës së ekspresit.

— Është ngatërruar me një vajzë.

— Aha.

Ata qëndruan një copë herë të heshtur. Rruffitnin kafen ngadalë, secili me mendimet e veta, sikur s'kishin të bënin me njëri-tjetrin.

— Ai deshi ta linte vajzën, por e la ajo përpara, — tha Tomori me syfë në unazën e Rasismit. Që një unazë sermi. që e mbante në gishtin e vogël, me një shkronjë të gdhendur që s'ishte initiali i tij.

— Po...

— Është vajzë e çuditshme. E vogël, sa' të duket se do të thyhet po e preke. Por është e fortë si xhevahiri.

— Ku i gjen ato vajza!

— Isha në shtëpinë e saj të dielën, t'i kërkoja dorën tek i vëllai dhe eëma. Më dukej tërë kohëp

sikur rrija në hije. Nuk e dija fare si do ta ndrejqa punën me Gencin. Thashë ta mendoja më pas.

Tomori ndezi cigaren dhe i zgjati paketën Rasimit.

— S'më dalin nga mendja ata njerëz, — tha pas pak. — Ma morën vesh hallin dhe më erdhi turp. Më pritën sì mik dhe më thanë të mos e kërkonim më vajzën.

Rrotullonte në tavllë majën e ndezur të cigarettes, si të donte ta lëmonte.

— E di si janë ata njerëz? Dinë të heqin përtë tjerët pa zë dhe të lajnë fajet e tyre me fisnikëri.

Rasimi e vështronte dhe herë pas here tunde kokën lehtë, duke mbyllur sytë, që t'i thoshte se i dinte këta lloj njerëzish.

— Vajza ka dalë deficit katër mijë lekë. Është shitëse kinkalerie. — Tomori e pa shokun drejt, si të kërkonte të kapte në vështrimin e tij atë që s'arrinte ta kuptonte vëtë.

Rasimi u kthye në karrige dhe qëndroi anash, me bërrylin të mbështetur në tavolinë. Nuk u habit.

— Në kinkaleri s'ka pse të dalë deficit, se s'humbet gjë, — tha ai ngadalë.

— Ashtu them edhe unë. Më duket se ka një të fshehtë në këtë gjë. S'po e marr vesh punën mirë.

Ai heshti pak.

— Më vjen keq për vajzën, — tha. — Duket sikur janë mbledhur të tëra për të. Nuk di si ta ndihmoj.

— Do mendojmë ndonjë gjë, — tha Rasimi.

— Erdhi dje në shtëpi, kur nuk qe Genci aty. «S'më vjen keq për atë që më bëri mua, më tha, vetëm kam hall si do t'i them gjyshes. Nuk mund ta gënjej gjatë, mbasë edhe mund të vdesë. Si të presim vdekjen e saj? «Mos u mërzit, i thashë, unë do ta detyroj...» Ajo u bë flakë, iu mbushën sytë me lot dhe i dridhej trupi. «Nuk mund ta bësh atë gjë, sepse unë nuk dua.» I hipi një inat i papritur dhe vinte rrrotull nëpër dhomë sikur kërkonte të thyente diçka. «Nuk do ta bësh këtë, sepse unë nuk dua... më beson që nuk dua?» Durimi i saj kishte marrë flakë. Më shihte në sy dhe donte përgjigje. S'mund ta pyesja për paratë.

Tomori heshti pak dhe e ktheu kafen njëherësh.

— Më vjen keq për vajzën, — tha pastaj, — po puna është se tani e dua vërtet nuse përvellanë.

Rasimi nuk fliste, i përkulur përparrë që të dëgjonte mirë. Kishte puqur vetullat mbi ballë dhe mendonte për hallin e mikut.

— Mos u mërzit, — tha. — Genci do kthehet prapë tek ajo.

— Nuk ndreqen më. Ikim!

* * *

Tomori zgjohet gjithnjë në orën pesë, kurdo që të kish fjetur. Atë mëngjes i dukej sikur kishte dalë nga një gjumë i thellë, i errët, pa frymëmarrje. Po ndihej i çlodhur e i freskët. Nuk

kishte rrugë ato dy ditë, po do të shkonte t'i bën-te një kontroll kamionit. Kishte një zhurmë të mbytur, një gërvishjtë të rrallë, që e dëgjonte herë-herë përmes këngës së njohur të motorit.

U ngrit dhe vështroi profilin e bukur të vëllait mbi jastëk, si të atyre kokave të mermerta që kish parë dikur në Apoloni.

— Genci! — i foli ngadalë.

Ai lëvizi kokën.

— Genci, çohu! Do pish kafe?

— Do pi, — foli ai i përgjumur dhe u ngrit duke i mbajtur sytë me zor hapët.

— E mban mend Cenin, atë shoferin e vjetër që kishte dhjetë fëmijë?

— Ehë.

— I thashë të vijë te ti në spital. Prite nga ora tetë. Do të bëjë një kontroll të mëlcisë.

— Në spital?

— Po. Mbase e ke më mirë atje. Ta shohë edhe ndonjë i vjetër.

— Nuk jam më në spital! — Ai qe ngritur në këmbë. Po shtriqej dhe e tha këtë si gjënë më të natyrshme.

— Nuk je? Pse, ku je? — Tomori mbeti me xhezven në dorë, po nuk u kthyte ta shihte, sikur trembej.

— Më kanë transferuar.

— Ku? — Tomori nuk lëvizi, tanë dukej i përgatitur të dëgjonte çdo gjë dhe nuk do të habitej.

— Në një fshat të Korçës. Një orë në këmbë nga rruga.

— Që kur? S'ke thënë gjë.

— Ka nja katër muaj. S'të kam thënë, se ki-

sha shpresë ta rregulloja. Më ka dhënë fjalën njëri në seksion.

— Këto katër muaj ke ndenjur pa punë?

— Po.

— Po lekët e shtëpisë që bije çdo 15 ditë? Ai nuk foli.

— Me se je ushqyér? — tha Tomori dhe iu afroa duke e vështruar me kujdes, duke u munduar të kuptione ndonjë gjë nga ai që ishte vëllai i vet. Mbështetje s'e kish marrë vesh téré jetën.

— Domethënë ato paratë... paratë e asaj vajzës...

— ... Jo, ajo m'i dha vetë. Më ka thënë se i ka paratë e pajës.... unë do t'ia ktheja kur të filloja punë. «Nuk i dua», më tha.

— E di që e kanë thirrur në hetuesi?

— Jo.

Tha «jo», po dukej se gjenjente. Atëherë Tomori iu kthye në brinjë, që t'i gjente anën, dhe ngriti dorën ta qëllonte. Genci e vështronë me sytë e rrumbullakët si foshnjë dhe, kur i puliste kapakët, njëri i mbetej i hapët, i trembur, si të mos e ulte dot nga një ngërç. Kishte frikë, nuk i kishte duruar kurrë dhimbjet e mishit. Tani sytë e tij dukeshin të verdhë si të një njeriu që i ka ikur gjaku. Tomori qëndroi. Ndjeu zbrazëtirë përreth. E kishte parë atë sy të ngrirë të fiksuar në boshllék edhe një herë në vogëli, kur e kishte rrahur fort, për herë të parë. Fëmija fshinte me kurrizin e dorës gjakun që i shkonte curg nga hundët dhe nuk guxonë të ikte, vetëm puliste njërin sy. E kishte parë ashtu edhe kur iu vdiq

nëna. Ishte më keq se një britmë, një britmë pa zë, që nuk i jepte dot asnje ndihmë.

Tani nuk kthehej dot mbapsht. Në të errët ndiente që po e rrihte, se donte të dënonte vreten. E qëlloi në nofull, pastaj në gjoks dhe prapë në nofull me një inat të verbër, pa drejtëm.

Genci nuk kundërshtonte, vetëm mbrohej duke mbuluar ftyrën me grushte. Mbetej si një masë e quillët që nuk reagon, po në sytë e kaltër po i mblidhej avash zemërimi.

— Ajo më la vetë, — mundi të thoshte, — nuk e lashë unë.

Tomori qëndroi. Nuk do t'i shuhej zemërimi, edhe sikur ta rrihte gjatë, sepse nuk ndiente asnje dhimbje në grushtet e bëra gur. Shtrëngoi duart mbi gjoks dhe shkoi në dhomën tjetër, se nuk e duronte dot atë pamje.

Pas pak u kthyte prapë dhe foli duke shqitur gjuhën me zor:

— Do të shkojmë bashkë ta kërkojmë nuse.

Genci rrinte mbi shtrat. Dukej i qetë, sikur s'kish ndodhur gjë.

— Unë... unë nuk marr grua shitëse... dhe... dhe që të ketë të bëjë me hetuesinë.

— Do ta marrësh, po të dojë ajo. Dhe paratë do t'i paguajmë ne të dy.

Djali tundi kokën në shenjë mohimi.

— ... Dhe bëhu gati të shkosh atje ku të kanë çuar!....

Në zérin e tij nuk kishte më zëmërim, vetëm hidhërim.

* * *

Tina e ndoqi gjyshen pas. Kishte një javë që plaka e merrte me vete. Ato dolën nga qyteti me autobus dhe ngjitën një kodër të butë. Plakës i kishin ardhur këmbët dhe zuri të bënte prapë ilaçe me barërat e fushës dhe jaki për fëmijët e mëhallës kur u lëviznin kyçet nga vendi. Nuk shihte afër, po larg mund t'i dallonte gjérat qartë me dorën strehë mbi sy. Dilte mëngjeseve të mblidhët barërat në vesë, se atëherë e lëshonin atë erën që shëronte njeriun. Një ditë i kishin ardhur dy mjekë nga Instituti i Mjekësisë Popullore, po plaka mezi e kishte kuptuar se ç'kërkonin prej saj. «Ke ndonjë ciban, apo të ka dalë krahu vendit?» i kish thënë atij më të riut. Pastaj kishte thënë se, kur të plakej, zanatin do t'ia linte vetëm së mbesës, Tinës. Plaka qe afër të nëntëdhjetave. Mjekët kishin ikur duke qeshur.

— Ku do të shkojmë, néné? — pyeti Tina.

— Lart. — Plaka tregoi majën e kodrës me shkop.

Ajo ngjitej me majat e këpucëve, si alpiniste, me kockat të lidhura fort në nyja. S'kishte vuajtur kurrë nga reumatizmi. Plaka kërkonte duke zbuluar gjethet me një shkop të punuar. Pastai i priste barërat me një thikë të vogël me dorezë filishi të qëndisur me lule, aë e mbante në këllëf në kutinë e saj. Dukej se thika dhe shkopi bënin pjesë në artin e saj.

Tina e kishte gjëzim kur plaka e merrte me

vete fushave. Ajo i përgatiste ujë trëndafili të lante ftyrën, kamomil të zverdhte flokët dhe sapun me barëra që vajza ua njihte erën. «Çupat duhet të kenë erën e fushës», thoshte gjyshja.

— Kur do ta shoh atë djalin, — tha plaka papritur.

— ...Do ta shohësh... nëne, po s'është këtu... është larg, në një fshat... është doktor...

— Mbështetje do më shërojë sytë, kur të vijë.

— Do të t'i shërojë... do t'i them unë.

Plaka qëndroi dhe u mbush me frymë duke bërë uh, uh.

— U lodha, u plaka, më duket se më erdhi fundi.

Tina u tremb.

— Hajde kthehem, nëne, inbahu tek unë, ecën dot?

— Eci, pos!

— Ulu këtu njëherë. Çlodhu.

Plaka u ul duke marrë frymë, si një gjyryk që shfryn, duke shtypur gjoksin me dorë.

— Më duket se do vdes pa e parë atë djalin tënd.

— Jo, nëne, nuk do vdesësh. — Po në fund të shpirtit tha se ashtu që më mirë dhe u tremb. E donte gjyshen sa nënën, si nënën e nënës, si rrënjen e jetës. Në vegjeli rrinte pranë saj, në strehën në fund të oborrit dhe prisnin të piqej byreku në saç. E kishte në gojë shijen e hirit. Dhe misrat e pjekur në lëpushka. E shihte kur bënte zahire për dimër dhe nxirrte drekavë nga pak për të gjithë, secilit pjesën e tij, në një tas porcelani të hollë që e përmblidhte me duart

e mëdha. Bënte gjellë të mira, duke i trazuar avash, me zjarr të paktë, duke i shtuar erëza. Dhe mjaftonte të ngopeshin të gjithë, sadopak që të ishte.

Tina i mori dorën.

— U shlodhe, nënë? — Kishte frikë të rrinte vetëm me të në majë të kodrës.

— Ikim, o xhan. Do sos deri në shtëpi. Vëtëm një gjë kam pishman. S'e shërova dot plakun. Unë që shëroj të tjerët. Kemi bërë jetë bashkë. U bënë pesëmbëdhjetë vjet që jemi ndarë. S'u gjend një bar për atë të shkretë.

Tina e zuri nga krahun dhe e zbriti ngadalë drejt rrugës. Nuk e mbante mend gjyshin. E përfytyronte vetëm me gjysmë trupi dhe me mustaqe të mëdha, siç e kishte parë gjithnjë në fotografi. Thoshin që kishte qenë burrë i shkurtër. Tani nëna s'do të pushonte së foluri për të deri në të ngrysur.

* * *

Po atë mbrëmje Tomori u nis për në shtëpinë e Tinës me 4000 lekë në xhep dhe shpirtin e trazuar. Kishte vrarë mendjen gjatë ku do t'i gjente aq para, duke mallkuar veten që s'qe munduar të vinte një lek mënjanë. Pastaj kishte shkuar në shtëpinë e Rasimit. Ai me siguri i kish dhënë paratë e mbledhura për televizor. Tomori nuk e kish pyetur dhe Rasimi i kish thënë se nuk i duheshin.

Në shtëpinë e Tinës e priti Skënderi, vëllai trupmadh. Tina nuk dukej gjëkundi. Ai i vuri dorën në shpatull dhe deshi ta fuste brenda.

— Nuk do të hyj, — tha Tomori duke vështruar nëpërmjet drifores së verandës plakën që rrinte në qoshe të minderit. Herën e parë ajo i qe dukur e vogël, po plaka duhej të kish qenë trupmadhe, se duart e këmbët i kishte të fryra në kyçe. Ajo zgjatej, mundohej të shihte njëriun jashtë në të errët. Mbase e njobhu nga zëri se i ndriti fytyra e paktë.

— Desha të dilnim gjëkundi të pinim një gotë bashkë, — tha Tomori.

Skënderi e vështroi një çast sikur donte ta kundërshtonte, pastaj tha «mirë», mori pallton e madhe nga varësja dhe doli i pari nëpër rrugicën e mbuluar me hardhi.

Në klubin afér shtëpisë mezi gjetën një tryezë të lirë. Kamerieri, një djale i ri, me papilonin e zi shtrënguar në fyt, u solli kafe e fernet duke e rrrotulluar tabakanë në majë të gishtave, mbi kokat e njerëzve, si të luante një numër cirku.

Djali rrinte i mbështetur me njërin bërryl në gju, mendohej. Tomori i pa ballin e lartë, të lëmuar dhe flokët e zez kurorë. Ishte i ri, mbase në moshën e Gencit, por i kishte qëlluar të qe vëllai i madh.

Skënderi ngriti kokën dhe zuri të fliste nga dalë, duke i zgjedhur fjalët që duheshin, që të mos e lodhte mikun. I tregoi shkurt për Tinën dhe për hallin e saj. I tha se vajzën nuk do ta dënonin. E kishin çuar punëtore në magazinë dhe tani duhej vetëm të paguante deficitin. Kaq.

Tomori dëgjonte atë zë të plotë që dukej se dilte nga një grykë e ashpër dhe ndjeu vapë. Ai nuk do t'ia pranonte paratë.

Tani djali shihte anash, në një pikë, sikur kërkonte aty fjalët. Pastaj e vështroi Tomorin ngultas. Dukej se ajo që do të thoshte tani, kishte më shumë rëndësi për të. Po nuk foli.

Tomori e pa qartë ç'mendonte.

«Ajo është motra ime... sido që të ketë għubbar, është njelloy, si pērpara... mundet më e mirë, unë s'kam gjie për t'i falur... asnjeri s'ka gjie për t'i falur.»

Ai uli sytë. I kishte thënë të gjitha.

Tomori pinte fernet dhe mendohej. Djali qe mbështjellë me tymin e hollë të duhanit që dukej sikur i qe ngjitur pas rrobave.

— Gencin e kanë transferuar në një fshat të Korçës, — tha Tomori ngadalë.

Djali nuk i ngriti sytë. Vetëm nxori tym nga hundët.

— ... Nuk ka shkuar. Ka katér muaj pa rrogë... dhe unë nuk e di si ka jetuar.

Djali e vështroi drejt. Nuk ćuditej.

— ... Mbase... ai ia ka prishur paratë vajzës. me siguri... Tina duhet t'ju ketë thënë... —

Ata heshtën një copë herë.

— Mundet... Nuk ka rëndësi, — tha djali dhe ia bëri me dorë. — Mund edhe t'ia ketë prishur. Prapë fajin e kam unë.

Tomori po djersinte. Nxori nga xhepi zarfin me para dhe e vuri mbi tavolinë. Djali hapi gojën ta kundërshtonte, po Tomori zuri të fliste shpejt, që të mos i linte kohë.

Kishte thënë me vete se nuk do të fliste,

çfarëdo që t'i thoshin. Piste ta fyenin, ta quanin fajtor, po djali si kish hedhur asnje faj. E mbante çdo gjë mbi kurriz dhe Tomori e kishte ndier veten bosh. Tani zuri të fliste shpejt, duke i derdhur fjalët lumë, deshi të shkarkonte shpirtin:

— Kam sjellë paratë. Më takon mua t'i paguaj. Genci ia ka marrë borxh. E keqja eshtë se nuk e ndreq dot Gencin, edhe sikur të shitem i téri. Nejse, kjo eshtë diçka që duhet ta ndreq vetë, në e bëfsha dot. Më kanë rrëshqitur gjérat nëpër duar. E kuption? Jam afér dyzet, vjeç dhe s'di të të them se çfarë kam bërë. Vetem timonin, shko përpara, kthehu prapë, shko dhe kthehu, më duket se kam mbetur në vend. Po të m'i pranosh këto para, do të ta di pér nder téré jetën. Dua të bëj diçka po s'di nga t'ia nis. Tepër vonë pér të filluar diçka, tepër vonë pér çdo gjë. E di? Njëherë prisja trenin në stacion se më qe prishur makina në një qytet të vogël. Donte kohët të vinte, mbase dy orë. M'u dukën pa fund ato dy orë. Vetem unë dhe një çift ishim në stacion. Qëndrova në një bankë dhe mbase dremita, sigurisht dremita, se, kur u ngri-ta, treni kishte ikur. E kuption? Më duket se arrij gjithmonë vonë dhe tani s'mund të rend të arrij kohën që kam humbur.

Ai heshti menjëherë, si njësburim që shteron papritur. Dhe pasi foli, e ndjeu veten më keq.

Djali e vështronte me dhimbje. Hapi krahët anash si t'i thoshte që s'e ndihmonte dot.

— Do ma bësh këtë nder, t'i marrësh paratë. Do më lehtesoje shpirtin.

— Jo, — tha djali, — nuk të ndihmoj dot.

Ata pinë kafen në heshtje. Pastaj dolën dhe djali e përcolli deri në fund të rrugës.

Tomori u kthye ta shihte, po nuk ia dalloj sytë. Mbase mund ta bënte mik. Me siguri.

Ai shkoi duke hedhur këmbët bosh dhe për herë të parë e ndjeu veten një njeri pa të shkuar e pa të ardhme. Ishte nga ata njerëz që nuk dinë të rijetojnë të kaluarën dhe as të ëndërrojnë të ardhmen. Do të qe si të jetonte një jetë tjetër. I erdhi keq. Ai shtrëngoi zarfin e parave në xhep. Do t'ia çonte Rasimit që sonte.

Karvani i kamionëve që do të merrnin mollët nga Korça, u nis të premten. Tomori e kishte marrë Gencin me vete, por e kishte lënë në makinën e Fiqiriut.

Ata niseshin gjithnjë me një radhë, që e ruannin edhe kur kthehet. I pari Tomori, i stërvitur njëzet vjet për rrugë të largëta me dëborë. Pas tij vinte Rasimi, që ishte mësuar aq shumë me këtë pozicion të tij, sa do të gjente mënyrën të rrinte një shpatull më pas Tomorit, kudo që të ishin. Në mes rrinte Doria, shoferi më i ri, që e kish mbushur kabinën me fotografi artistësh, me opinga të blera tek arixhofkat e drita me ngjyra. I katërti Fiqiriu, kosovar i gjatë, i nga-dalshëm, me duhanin gjithnjë në anë të buzës. U thoshte «puna mbarë të gjithëve» me zë të

plotë e të trashë, sa njerëzve u vinte rëndë po të mos ishin duke punuar. I fundit vinte Lefteri, që i hidhej mendja degë më degë dhe i pushonte goja vetëm kur ishte në timon.

Atë mëngjes qenë nisur në orën katër. Në Tiranë nata kish qenë e ngrohtë, po në Korçë me siguri binte dëborë. Mbështetje kjo qe rruga e fundit e Korçës.

Tomori ecte me kujdes në asfaltin e lagur. Në shpirt ndiente një qetësi të ëmbël, siç i ndodhët të dielave në mëngjes. Në xhamin e hapur të kamionit vinte një këngë nga jashtë, mbështetje nga pylli anës rrugës. Ishte një këngë që e linte pas dhe e gjente prapë në një pyll tjetër. Ishin zërat e burimeve, që zbritnin nga mali duke u fërkuar nëpër gurë, fëshfërimat e gjethive, ca zëra të fshehtë, si të qeshura të mbytura, që zgjateshin përtej zhurmës së motorit.

Ishte i gjëzuar. Ktheu kokën dhe pa në kthesë, pas tij, kamionin e Fiqos. Kishte besim te kosovari. Dukej sikur nga ai burrë i fuqishëm vinte gjithnjë një valë nxehësie, si t'i digjej zemra nga një mall i largët dhe balli i lartë i fekste si nga një dritë e mbuluar. Fiqiri do të gjente diçka t'i thoshte Gencit. Mbështetje mund ta bënte mik, dhe ai miqtë i kish të paktë e të zgjedhur, sepse i maste me jetën.

Tomori rrahu cigaren që të ngjishte duhanin dhe e ndezi me çakmakun prej teneqeje. Flaka bojë qelli u lëpi pas cigares, pastaj u thith brenda asaj kutie të nxehë të vogël.

Po i ngjiteshin majës së kodrës, ku një pllajë e vogël, e qethur, rrumbullake, dukej si strumbullar i dheut.

Nga poshtë u dëgjua një bori e mprehtë e pandërprerë. Tomori pa në pasqyrë një makinë të vogël nga ato që i thoshin «breshkë». Dukej si një lodër fëmijësh që ecte me të kurdisur. I që qepur në bisht kamionit të Rasimit dhe dente ta parakalonte me çdo kusht. Ai nxori dorën dhe i bëri shenjë të kalonte.

«Breshka» kaloi me mundim distancën deri te Tomori dhe filloi t'i binte borisë prapë. Kur erdhi në krah të tij, një valë thirrjesh gjëzimi shpërtheu nëpër xhamin e hapur. Dukeshin një grup fëmijësh, që lozni në park pa e ndier kurrrë rrezikun afër. Makina rrëshqiti para tij si fugë, duke u rrotulluar nëpër kthesa, dhe u zhduk. I mbeti në sy një vajzë e vogël, që tundte të dy krahët me gjëzim në xhamin e pasmë.

Kur zbriti pjerrësinë e fundit, rrëshqiti një copë herë ngadalë buzë Ligenit të Pogradecit dhe ndjeu një prehje të thellë, që kishte të bënte me diçka të largët si mall, ndoshta me një èndërr, me një përfytyrim fëmijnie mbi krijimin e botës.

Në kthesë u duk ndërtesa njëkatëshe e klubit, me këmbët e holla në ujë. Do ta hanin drekën aty dhe pastaj do ta merrte Gencin në makinën e tij. Mbështetës kishte mërdhirë. Pa «breshkën», që rrinte në mes të sheshit me një përpjekje përtë zënë sa më shumë vend, dhe qeshi. Nëderë kishte kutitë e takstive, që e bën edhe më qesharake. Mbështetës s'kishte në botë taksi tjeter si ajo. Kushedi nga e kishin sajuarata të agjencisë.

Mbase kishin ecur një çerek ore kur u dëgjuua së largu boria e «breshkës». Duhej të ishte pas kamionit të Lefterit. Tomorit i lëvizi zemra. Fytyra e vajzës, aq e vogël sa mund ta përmblidhje me një dorë, dukej se vraponë pas tij me ethen e fëmijës që kërkon të kapë ëndrrën. Kur hanin drekë në klub, ajo qe shkëputur nga prindërit, i kish shkuar Tomorit pranë dhe i kishte thënë, duke treguar me gisht shoferin e taksisë: «Ky thotë se makina e tij është më e shpejta në botë.» «Nuk e besoj», kishte qeshur Tomori. Vajza kishte mbetur e mërzitur dhe tanë e nxiste shoferin e vjetër t'i kalonte makinat me radhë. Ata do t'i hapnin rrugë të gjithë, nuk do të luanin me atë fëmijë. I trembej vetëm Dories. Vajza i kishte sytë të rrumbullakët, si sytë e Gencit, dhe do t'i mbeteshin kështu edhe kur të rritej. Si të Gencit!

Vështroi profilin e humbur të Gencit. Po ata sy të hapur. Rrinte drejt, me duart të kapura përpara, sikur donte të arrinte diçka. «Po më çove atje, nuk do të kthehem më në shtëpi», i kishte thënë. Mbase tanë donte të arrinte sa më parë. Mbase shihte të njëjtën ëndërr me vajzën. Të ikte para të gjithëve.

— Ia kam frikën asaj taksisë, — tha Tomori. Qe hera e parë që i foli që nga mëngjesi.

— Edhe unë. Tomori ktheu kokën. Kishte frikë vërtet. Diçka kish ndodhur, diçka kish ndryshuar te djali. Tomori kuptoi se ai trembej ndoshta për herë të

parë në jetë për një njeri tjetër. I dukej se shumë gjëra po i zbulonte për herë të parë.

Vështroi rrugën e lagur nga një shi i imët. Po të shtrëngonte edhe pak të ftohtët, uji do të ngrinte dhe qe më keq se dëbora që mund të gjenin në Korçë.

— Ke ftohtë? — pyeti Tomori.

— Pak. Te këmbët.

Tani boria e «breshkës» gjëmonte fare pranë. Tomori ndjeu boshllëkun rreth tij. U shty në cep të rrugës t'i linte sa më shumë vend asaj furie të prishur mendsh dhe pa krahun e vogël të vajzës të tundej gjatë jashtë dritaresh.

«Breshka» rrëshqiste e hidhej nëpër kthesa, shkonte deri në búzë të honit, pastaj i turrej faqes së malit. Tomori shkeli gazin ta arrinte. Kish te qejf t'i hiqte një dru atij shoferit, që të mos i shkonte më në mend ta kapte timonin me dorë. I kishte thënë vajzës se makina e tyre nuk qe e shpejtë. Mbështetje kish bërë një gabim që qe vonë ta ndreqte. Nxitoi një copë herë pas tyre, po s'i arrinte dot. I bëhej se dëgjonte në erë gulçimën e shpejtë të «breshkës» dhe të qeshurat e vajzës. Vështroi pas. Ishte shkëputur shumë prej të tjerëve. Po e mbante në sy atë kthesën që dilte mbi një hundë mali dhe ndriste në diell si një plajë e bardhë e dukej e largët sikur aty të qe fundi i botës. Qe një kthesë e rrezikshme, gati rrethore, që duhej ta merrje ngadalë.

Tomori mbajti frymën me gjakun pezull, sikur mund t'i mbronte me merakun e tij, dhe i rrit fort. «Breshka» fluturoi nga dhjetë metra në kthesë, ra mbi një pjerrësi të butë u rrrokullis dy

herë dhe mbeti me rrrotat përpjetë në një shesh të vogël.

Tomori mbajti makinën në buzë të greminës dhe u hodh poshtë. Qëndroi një çast të shihte. Dera e pasme e «breshkës» u hap ngadalë dhe një gju i vockël rrëshqiti jashtë. Qe vajza. Tomori mori frymë thellë. Ajo u kthye, futi kokën në derën e hapur dhe po mundohej të tërhiqte diçka nga makina, mbase nënën. Një ulërimë e hollë, e mprehtë doli nga ajo gjë e vogël, e trembur. Pastaj vështroi rrrotull. Dukej e humbur.

Tomori u hodh poshtë. Pastaj u kthye të shih-te Gencin.

— Qëndro aty, mos lëviz! Është rrezik, rrëshqet nga akulli.

— Tomor!... prit... desha të shkoj unë...

Tomori e pa të vëllanë në sy. Genci kishte frikë, i dridhej trupi para humnerës dhe nuk i puliste sytë, sikur t'i kishin mbetur hapur përgjithmonë.

Ndjeu dhimbje në kurriz sikur i ranë me thika përgjatë shtyllës. Mund edhe të vdiste Genci. E përfytyroi kokën e tij të bukur të rrrokullisej nëpër gurë dhe iu zu frvma. Do të qe më mirë të vdiste ai vetë. Genci trembej si fëmijë, po i kërkonte leje të shkonte. Donte një provë për veten, që të mos humbiste Tomorin.

— Jo, — tha Tomori.

Djali u mundua të buzëqeshte. Donte t'i thoshte shumë gjëra njëherësh, pastaj u hodh e rrëshqiti nëpër gurë, me vratin e një kafshe të ndjekur, që të mos e arrinte Tomori. Po Tomori u rrrokullis para tij, duke u kapur në shkëmb

ku tē mundej, duke u munduar tē rrinte poshtë tij si mbështetje. Në atë zbritje tē shpejtë po gjente kohë tē bënte një zbulim tē ri, një shtresë më tē thellë tē tē vëllait, tē vërtetët e tij. Kjo kishte rëndësi tanë, edhe sikur tē vdiste.

Kur arriti te makina, futi kokën brenda dhe ndjeu frymëmarjet e rënduara tē tē dy burrave dhe rënkin e lehtë tē gruas.

— Genc, janë gjallë, — foli me zë tē ulët.

Genci kishte marrë në duar vajzën dhe e uli në një gur duke e përkëdhelur me fjalë tē buta. Pastaj u kthye me vrap tē nxirrin tre tē tjerët. I vunë në shesh dhe qëndruan në këmbë karshi njëri-tjetrit. Genci dridhej lehtë, duke parë diku në boshllék atë që mund tē kishte ndodhur. U kthye, e mori vajzën prapë në duar dhe e shtrëngoi fort, sikur donte tē pushonte dridhjet e trupit tē tij. Po sytë nuk i shqiste nga Tomori.

— Mos qaj, xhan, mami do bëhet mirë, edhe babi. — Vajza nuk qante.

Lart në rrugë u dëgjuat motori i Rasinit.

— ... Rasimi, — tha Tomori.

Pas tij ndaloi rresht autokolona e kamionëve tē gjelbër, që dukeshin sikur mezi mbaheshin në faqë tē malit.

Gruaja kishtë hapur sytë d'he përpigjet tē ngrihei.

— Aneta...

Vajza rrëshqiti nga krahët e Gencit dhe u ul në gjunjë, pranë nënës. I përkëdheli fytyrën me dorën e nxirë, pastaj iu afrua tē atit:

— Mami, babi...

— Aneta, xhan, ja mirë?...

— Po, mami... — Vajza u vinte rrotull tē

dyve. Në faqen e çjerrë i shkonte gjak dhe njërin krah e mbante ngjeshur pas trupit. Pastaj iu afrua Tomorit dhe i qëndroi përballë.

— Ne jua kaluam, ë, xhaxhi?

— Po, Aneta, ti ishe më e shpejtë.

Tomori u nis për në Korçë në fund të shkurtit. Kishte dy muaj pa e parë vëllanë. Genci kishte thënë se nuk do të kthehej më në shtëpi dhe Tomori qeshi kur kujtoi fytyrën e tij tek mundohej të dukej i vendosur. Ai me siguri e kishte pritur të shtunave.

Ndiente gëzimin në ajër, Mbase ishte ajo dita që paralajmëronte ndërrimin e stinëve. Ishin të bucura fshatrat e Korçës, të bardha, të freskëta, të dala nga dëbora. Shihte fshatra që hapeshin buzë rrugës me një përpjekje për tu lidhur me qytetin, fshatra të fshehura në mes të pemëve, që i ngjiteshin malit me kokëfortësi, me shtëpitë e vogla që spërkatnin majat si gurë të bardhë.

Qëndroi në një shesh të vogël në anë të fshatit. Një bredh i vogël, që prekte tokën lehtë, kishte një ngjyrë aq të gjelbër, sa të dukej i ndezur nga një dritë e bardhë. Tomori mori një halë dhe filloi ta përtypte, duke i thithur lëngun. Shija e athët iu hap në gjuhë dhe e gudulisi në rrëzë të veshit. Ishte shija e lëngut të dheut.

Nja dy vajza të vogla i erdhën rrotull, kamionit.

— Ku e ka shtépinë doktori? — tha Tomori. Vajzat bënë sikur s'dëgjuan dhe ikën duke shtyrë njëra-tjetrën.

— E gjen lart, te çezma. — Një plak, që ngjitej duke mbajtur trupin drejt, tregoi me bastun lart në kodër, një ndërtësë të gjatë, që s'ngjante si shtëpi. — Ju çojmë ne, — tha plaku dhe shkoi përpara, pa kthyer kokën, duke rrotulluar shkopin nëpër gishtërinj.

Një rrugë e ngushtë, e përpjetë, gjarpëronte vjedhur në kodër. Nga poshtë dukej sikur s'e ngjitje dot, por ishte e habitshme sa ëmbël ia kishin dhënë pjerrësinë, që njeriu të ecte gjithnjë njëlloj, me hap të shpejtë, me frymëmarrje të rregullt. Dukej rrugë e vjetër, e hapur nga mushka, me instinctin e kafshës së ngarkuar.

Në dy krahët shtriheshin plantacionet e mollëve. Këtu mund të haje pemë në degë, duke i pastruar me mëngë, pa ua fshirë atë shtresën e hollë mbi lëkurë që ishte kripa e shiut dhe e diellit.

— O doktor, të kërkojnë — foli plaku dhe u zhduk në rrugicat me mollë, si ta kishte përpire dheu.

Genci rrinte në derën e shtëpisë dhe mundohej ta rrudhete fytyrën sa më shumë. Zbriti një shkallë, pastaj qëndroi. Pas tij, kishte nxjerrë kokën një plakë e vogël.

Tomori iu afroa me hapa të mëdhenj, dhe e mbështolli të vëllanë në krahë, pastaj i tha me një frymë se atë natë do të flinte aty dhe të nesërmen do të niseshin në mëngjes herët. Do të ngarkonte patate e do të shkonin bashkë në Tiranë. Plaka e vogël që zhdukur.

Ata qëndronin në dy anët e vatrës dhe pinin raki në heshtje. E zonja e shtëpisë hyri dy-tri herë, solli rrobat për mikun, pulë të pjekur dhe misra të zier. E vështronte Tomorin tinëz, donte të fliste, por ikte duke fshirë duart me përparrëse. Pastaj qëndroi në derë dhe foli me forcë:
— Qysh e harruat këtë djalë kështu? Dy muaj s'u kujtua njeri për të!

— Nuk e harruam, nënë, — tha Tomori dhe qeshi.

— Për mua mirë. U bëra me doktor në shtëpi. Po ju qysh e lëshuat kështu këtë goxha djalë? Mos janë më të mirë ata në kryeqytet? I morën shpirtin djalit fshatarët. Jallah, pse nuk sëmureshin kur qe ai tjetri, ndihmësi, si i thonë? Tani mori dhenë sëmundja. Një çikë u pret barku na fasulet, hop në derë të doktorit në mes të natës. Dhe ky në këmbë. Ta merr mendja të ketë të sëmurë këtu? Hanë mollë e dardha sa u zihen zët.

Tomori qeshte.

— Ja kështu, — tha plaka dhe doli.

Ata pinë një copë herë në heshtje.

— Mërzitesh këtu? — tha Tomori.

Genci nuk u përgjigj menjëherë.

— Ke hequr keq këta dy muaj. Ka qenë ftohtë.

— Më ka marrë malli për Tiranën.

— Mbështetë mund të marrësh leje për një javë. Edhe unë kam ca ditë pushime. Të irregullojmë pak shtëpinë.

Nuk largohem dot aq shumë, kam zor të kthehem mbrapsht. — tha Genci dhe qeshi. — Këtu më duan çdo ditë.

Ai ktheu gotën me fund, fërkoi ballin me dorë sikur do të shtronte mendimet, pastaj foli duke e parë në sy:

— Kanë besim tek unë, E kuption? Kanë besim tek unë, nuk mund t'i lë. Ti s'ke pasur ndonjëherë besim tek unë. Asnjeri më parë.

— Unë kam besim te ti, — tha Tomori rëndë. Genci e pa drejt, me ata sytë e rrumbullakët si të foshnjës.

— Kjo vlen për njeriun, — tha.

Ata hynë ngadalë më Tiranë. Pas asaj rrugë të vështirë, tani shkitnin në asfaltin e lëmuar si në vaj, me motorin të shuar. Qe një rrugë që s'i shihej fundi, me neonte në të dy krahët, që hapeshin e mbylleshin pas tyre.

Përpara, në buzë të trotuarit, shkonte një çift. Djali i gjatë i kishte shkuar dorën në mes vajzës, që dukej krejt e vogël, dhe e mbante fort. Vajza nuk cikte në tokë. Era ia mbështillte fundin e gjerë pas trupit, ia ngjiste pas këmbëve, pastaj ia frynte si balonë. Vaiza mundohej ta mbante me duar dhe mblidhë flokët me krahët e hollë. Dukej sikur kërcente një balet klasik me një muzikë që e shtynte përpara dhe e tërhoqte pas si era. Mbështilla më e erës.

Genci uli xhamin dhe u zgjat të shihte jashtë.

Genci uli xhamin dhe u zgjat të shihte jashtë.

* * *

Ata qëndruan te karburanti.

— Zbrite pasagjerin, — tha shitësja.

Genci zbriti, ndjeu erën ta pështillte si vor-bull dhe shkoi bashkë me të më tej. U mundua ta ndizte cigaren duke futur kokën nën xhup. Vështroi të vëllanë në dritat e distributorit dhe i erdhi të thërriste nga një gulg në gjoks. Për një çast mendoi se mund ta kishte humbur.

Tomori hoqi shkarkuesin nga serbatori, fshiu duart me leckat e mbledhura shuk dhe i bëri shenjë të hipte. Rrëshqitën ngadalë në unazë. Dukej që shiu sapo kishte pushuar, se gjërat ishin të afërtë, të lara, të gjalla. Avullonin ujin.

— Tomor...

— Cfarë?

— Cfarë njeriu jam unë?

Nuk folën një copë herë. Tomori u kthyesh të shihte profilin e tij të bukur si të mermertë dhe mendoi ato dy kokat e vogla pranë njëra-tjetrës, që e kishin mahnitur dikur në Apoloni. Kishin mbase dy mijë vjet fëmijë.

— Ti do të duash një vajzë, që nuk do të jetë Tina.

— Nuk besoj se do të ndodhë... — tha Genci ngadalë duke vështruar natën në thellësi.

— Do të ndodhë...